the contemporary linguistic, psychological and didactic thought and research. Since the first class, Albanian language included integratively the rubrics: Reading-writing (*këndim-shkrim*), Learning-writing (*mësim-shkrim*) and Learning by heart (*përmendësh*). Learners were expected to acquire both linguistic and communicative skills. For this reason, even in the following classes, the sections of Albanian language class: Grammar, Learning-writing, Learning about life, Writing and orthography (*gramatika, mësim-shkrimi, mësim jete, shkrimi dhe ortografia*), were not viewed as separated parts but integrated ones. During this period, Shashaj (9) also stated that there was a debate among pedagogic staff regarding use of reading passages in 2nd-5th classes of elementary school. The conceptualization and practice of grammar knowledge were done gradually, with concentric and linear extension of linguistic material and oriented to the development of communication skills. Grammar was an integrative part of other sections of the lesson in higher classes too: Reading, Spelling and writing; the latter was seen as an opportunity not only to language development, but also to learners’ mental cognitive, moral and ethical one. Referring to the pedagogic press of the time, “the purpose of grammar is to enter the spirit of the native language, thus the learner should not be confined to the examples and rules of the book; the book should serve as a counsellor”; while “the teacher should be concerned to promote the learners’ interest in the words spoken at home and in words that people use in different situations in order to enter the spirit of the language and understand Albanian word and sentence constructions” (9).

What is more, referring to Paralloi (7) a particular importance was given to active and creative learning.

The period: from the gain of liberty till 1970

After the 2nd World War, there were published didactic books for Albanian language teaching. The presentation of new linguistic knowledge was linear beginning with phonetics and morphology, and syntax following it. In the

didactic grammar book, it was noted "To speak and write language well, it is needed to learn phonetics, morphology..., so grammar has an important place and role in language learning and teaching" (9:19). Like in traditional grammar teaching, it was believed that "...grammar teaching helps the development of thinking skills" (9). But practically, grammar mastering was seen as a reproduction of concepts and examples and realization of mechanic exercises. According to Joro (3:123), "there are still teachers that do not pay attention to orthography and speaking skills of their learners. This is because of the fact that the study of grammatical knowledge is greatly supported in the actual school programs and textbooks, leaving little space to the development of orthography and speaking skills". In this way, grammar teaching and learning was almost transformed as an end in itself, being very little oriented toward language functions and use. This orientation was reflected even in learners' deficient discourse skills including spoken and written language. For this reason, Joro (3:123) stated the need for the establishment of useful Albanian teaching materials and the inclusion of press materials and literary works to help students in the acquisition of linguistic rules.

The researcher Kostallari (5) expressed his concern about the high percentage of learners' orthographic mistakes. Considering unification of orthography as an important aspect in the structural unification of literary language, Kostallari noted the necessity of orthography acquisition in strong relation to phonetic, grammar and word-formation aspect of Albanian language. Orthography, "This outer face of the language reflects.... a complex deep inner process of unification and embeddedness of phonetic, grammar, word-formation and lexical structure of standard national language" (5:7).

Kastrati raised another issue related to, as the author stated, "not well acquisition of grammatical material" (4:239): "The grammar books, published after the liberation, do not make the same division of verbs according to their conjugation". Some textbooks of elementary

school had verbs classified in two conjugation types, some of low-secondary school in three, while some of a higher school level in four.

The Period after 1970s

After the Congress of Orthography (1972), a great importance was given to the integration of grammar knowledge with orthographic and punctuation knowledge. Language learning and teaching was conceptualized on three rubrics: Words and expressions, Grammar and Orthography. But the rubric Words and expressions was not integrated with the other rubrics; as a result learners had difficulties in communication (9:24). To overcome these difficulties, it was needed improved teaching strategies and materials. For this purpose, as Shashaj noted (9), Albanian researchers based their work on contemporary theoretical and empirical developments in language acquisition and other sciences (linguistics, psychology and sociolinguistics) and on the experience of foreign developed countries in teaching their native language. The speech act theory and the distinction between communicative and linguistic competence have greatly affected the teaching of native and foreign languages (2:326-329). The main principal of the improved programs and textbooks of Albanian was: "from language functions and speech acts to linguistic knowledge" (9:28). They aimed the development of both learners' linguistic competence and communicative one. It was expressed even in the program of Ministry of Education: ...to enable learners to read fluently and with the proper intonation; to comprehend what they read...; to master the basic and active lexical items of the standard language ... to master the structural patterns of the standard Albanian language and use them appropriately in spoken and written communicative situations (9:28).

To reach this aim, each lesson included four sections: Speaking, Grammar, Orthography and punctuation and Writing. Linguistic knowledge had an intuitivo-practical nature, i.e. presenting concepts without definitions and theoretical explanations, but through examples. Students

were asked to notice the target linguistic item in a certain communicative situation. Then they were encouraged to use it in writing. In this inductive way, from function/meaning to form, differently from the deductive traditional method (from form to meaning), the rubrics Speaking and Writing aimed not only the development of communication skills but also the development and integration of linguistic knowledge.

Referring to the content of the language course, grammatical issues were revised from one class to the upper ones, but being extended, as new related information was given. For example negative sentence was treated in the 2nd class and revised in the 5th. In the latter class, learners were introduced with two types of negative sentences: complete and partial. In the 7th class, they made a distinction between simple and compound complete negative sentences.

After about ten years, it was noted that the existing programs and textbooks had problems (besides the advantages): there was not reached a whole harmony between linguistic knowledge and speech act; in many lessons, the topic and the communicative situation in Speaking did not relate to the linguistic knowledge introduced in Grammar or Orthography (9:36). Moreover, the sociolinguistic aspect of language use in written and oral communication was not taken into consideration. The separation of Albanian language from literature as school subjects makes difficult the use of language based on communicative situations. For this reason it was seen necessary the compiling of a new Albanian language program and textbook containing linguistic information of all the aspects in harmony: phonetics, morphology, syntax, word-formation, orthography, pronunciation and lexicology.

The reform in the education system in the last years substituted the system 4+4+3 with 5+4+3 which required the development of new Albanian language programs and coursebooks. As a result, the linguistic content is structured in four sections in the textbook: Listening and speaking, Reading, Writing and Knowledge about our language. The linguistic items are selected not as

an end in itself, but for the sake of the development of the learners' awareness and competence of real-life communication skills. The language introduced in the coursebook and practiced in the classroom is authentic. It is harmonized with communication skills (9:118). The Albanian language program and coursebooks encourage teachers to treat the grammatical issues inductively: learners are encouraged to notice the target grammatical point (treated in the section Knowledge about our language) in an authentic text. Deductive treatment of grammar is also advised but in higher classes (when learners' metalanguage is considerably developed).

Besides these advantages in Albanian language teaching materials and strategies, researchers have noted that there are still problems: the integration of language teaching and literature to one subject (9).

Conclusion

The teaching and learning of Albanian grammar and language have had ups and downs regarding the efficiency in its use for communicative purposes: during 1920-1940, it was oriented towards the development of communicative skills; after 2nd World War, grammar teaching became almost an end in itself what was reflected on learners' deficiencies in communication skills; after 1970s, it is given greater importance to the integration of linguistic knowledge with communication skills. Thus, grammar has always been an important aspect in Albanian language teaching and learning.

Meantime, a real challenge for Albanian language teachers remains the integration of grammar teaching with communication skills. Teachers need to be eclectic, selecting the appropriate instructional strategy in order to address the needs of their learners and attempting to create the best possible conditions where accuracy and fluency of language use can be developed simultaneously and supplementary.

Bibliography

1. Achard M (2008), Teaching construal: Cognitive Pedagogical Grammar. In, P. Robinson & N. C. Ellis (Eds.), *Handbook of Cognitive Linguistics and Second Language Acquisition* (432-455). Taylor & Francis.
2. Howatt P. R, Widdowson H. G (2004), *A History of English Language Teaching*, Second ed. Oxford University Press.
3. Joro J (1975), Gjuha dhe aktualiteti në shkollë. Konferenca III Kombëtare e Studimeve pedagogjike, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë.
4. Kastrati J (1988), Probleme të normës gramatikore në gramatikat e pasçlirimit. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë. Materiale të konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8dhjetor, 1984. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë.
5. Kostallari A (1973), Gjuha e sotme shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj, Akademia e Shkencave të RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
6. Myzyri H (1978), Shkollat e para kombëtare shipe, Shtëpia Botuese '8 Nëntori'.
7. Paralloi A (1995), Kontributi i Shkollës Ushtrimore në mendimin pedagogjiko-didaktik shqip, Normalja në traditë, Elbasan.
8. Richards JC, Renandya WA (2002), *Methodology in language teaching: An anthology of current practice*, Cambridge University Press.
9. Shashaj A (2007), *Metodikë e Mësimit të Gjuhës Amtare*, Tiranë: ADA..

FRAZELOGJI TERMINOLOGJIKE JURIDIKE E KRAHASUAR: RASTI I FRENJISHTES DHE I SHQIPES

BADE BAJRAMI

Dega Gjuhë dhe Letërsi Frënge, Universiteti I Prishtinës,
bbajrami07@yahoo.fr

PËRMBLEDHJE

Përkthimi i specializuar vë në pah se arrijmë mjaft shpejt të dallojmë termat dhe barasvlerësit e tyre, por çështja qëndron ndryshe me përvetësimin e frazeologjisë. Vështirësia e një gjuhe të specializuar, siç është gjuha juridike, nuk është vetëm çështje terminologjike por përtej saj, kemi të bëjmë edhe me çifte fjalësh, bashkime fjalësh, madje fjalish. Objekti i këtij studimi do të jetë një qasje e frazeologjizmave që dalin në gjuhën juridike me një frekuencë të dallueshme dhe u sjellin kokëçarje përkthyesve për nga specifikat e tyre në këto dy gjuhë. Meqenëse frazeologjia është një fenomen sintaktiko-semantike, do të shqyrtojmë kombinimet e këtyre leksemave me një qasje dygjuhësore që ka për synim problemet e përkthimit. Ky shqyrtim krahasues do të bëhet duke u nisur nga skema aktanciale e frazeologjisë juridike frënge me barasvlerësit e tyre në gjuhën shqipe duke u mbështetur në disa terma kyç.

Fjalë kyçe: përkthim, terminologji, frazeologji, gjuhë e specializuar, gjuhë juridike

ABSTRACT

Specialized translation notes that we arrive quickly to distinguish terms and their equivalents, but the case is different with the acquisition of legal phraseology. The difficulty of a specialized language is not simply a matter of terminology but also beyond couples of words, combinations of words, even sentences. With this study we will approach phraseological units in legal language with a distinct frequency and bring headache for translators from their specifications in these two languages. Given that phraseology is a syntax and semantic phenomenon, we will analyze combinations of these lexemes with a bilingual approach aimed at the problems of translation. This comparative study will be made by starting from the French actantial scheme of legal phraseology with their equivalents in Albanian leaning on some terms.

HYRJE

Në disa fusha të përkthimit të specializuar, siç janë shkencat, teknologjia ose ekonomia, zhvillimi i botës bashkëkohore kah globalizimi ka afruar realitetet dhe fjalët. Një term teknik ose shkencor ka zakonisht një referent të njëjtë universal prandaj dhe një barasvlerës të saktë në një gjuhë të caktuar. Për përkthyesin, detyra është relativisht e lehtë meqenëse është fjala të zotërohet terminologjia. Por bota juridike është e ndryshme.

Frazeologjia në gjuhën e përgjithshme dhe në gjuhën e specializuar është objekt i një vëmendje të veçantë që disa vite. Megjithatë, në nivelin dygjuhësor punimet janë më të vonshme;

pikërisht ky aspekt i krahasuar (frëngjisht-shqip) është në qendër të preokupimeve tona.

Frazeologjia juridike

Të përcaktosh frazeologjinë terminologjike do të thotë gjithashtu të përcaktosh këtë kombinim leksemash të quajtur edhe njësi frazeologjike, kolokacion ose kookurent. Për të vendosur dallime në mes të strukturave frazeologjike, duhet t'u referohemi disa kriterëve të ndryshme: kriteret semantike, sintaksore, leksikologjike, terminologjike, statistike, etj. Kompleksiteti dhe llojllojshmëria e kriterëve të pranuar kanë shkaktuar krijimin e një morie termash për të emërtuar, në mënyrë të përafërt, një koncept të

ngjashëm, siç janë kookurencat, kolokacionet, frazemat, frazeologjizmat, lokucionet, idiomatizmat, shprehjet e ngurosura, etj.

Studimi i frazeologjisë së gjuhëve të specializuara mundëson identifikimin dhe përcaktimin konceptual të termave, pasi kontekstualizimi i tyre mund të lehtësojë precizitetin e tyre semantik. Përvetësimi i frazeologjizmave juridikë është i vështirë sepse ata gjenden në rrafshin e sintaksës, të segmenteve të fjalisë, dhe jo në atë, më themelor, të vetë termave. Njohja e tyre është megjithatë e domosdoshme dhe ajo mund të përvetësohet vetëm me leximin e rregullt të teksteve juridike të ndryshme dhe të një studimi të thelluar të mekanizmave të gjuhës juridike. Meqenëse është fjala për frazeologjizma, dy raste mund të paraqiten:

Përdorimi i frazeologjizmit mund të mos jetë i domosdoshëm, edhe pse ai ndihmon në evidencen e kredibilitetit juridik të tekstit: p.sh. nëse në gjuhën shqipe kemi « *në mungesë të* » si barasvlerës do të mund të pranohej: «*En l'absence de*» si dhe «*à défaut de*», edhe pse ky i fundit duket më "juridik". Po kështu «*afin de*» do të mund të përdoret, edhe pse më së shpeshti parapëlqehet «*aux fins de*», konsideruar si më juridike. Në raste të tjera, përdorimi i frazeologjizmit juridik mund të jetë i domosdoshëm duke qenë dhe e vetmja zgjedhje e mundshme: *rendre un jugement : shpall një vendim*. Po ashtu nëse kemi «*vrasje me paramendim*», për termin *vrasje* frëngjishtja ka në dispozicion «*assassinat*» dhe «*meurtre*», mirëpo vetëm «*meurtre prémédité*» do të jetë adekuate.

Llojet e studimeve të frazeologjisë juridike të krahasuar

Studimi i parë mund të jetë një qasje distribucionale që ka të bëjë me nxjerrjen e kombinimeve të zakonshme më të shpeshta të një termi me elemente tjera gjuhësore ashtu si dhe kufizimi i tyre në planin paradigmatic. Ajo mundëson të vihet në pah zgjedhja e secilës gjuhë në planin e strukturave frazeologjike, ku elementi qendror është folja ose emri. Kështu në tekstet e drejtësisë lidhur me kontrata

ndërkombëtare në gjuhën frënge, përdoret *régler un différend*, kurse barasvlerësi shqip do të ishte *zgjidh një mosmarrëveshje*. Po ashtu mund të zbulohen dallime nga njëra gjuhë te tjetra: *conclure un contrat* i përgjigjet në shqip *lidh një kontratë* dhe jo **përfundoj nje kontratë*, kurse antonimi do të ishte *résilier un contrat : prish, anuloj, ndërpres një kontratë*.

Analiza kontrastive që është një analizë e thelluar që mundëson të zbulohen dallime në nivelin e tipit të diskursit. Ajo mundëson të tregohen dallimet lidhur me reksionin e foljes ose sintagmat parafjalore. Këto të fundit janë vështirësia më e madhe e gjuhëve të specializuara. Kështu frazeologjizmi *intenter un procès à quelqu'un* ka për barasvlerës shqip *ngre padi kundër dikujt, ngre një çështje në gjyq*. Një shembull tjetër i analizës kontrastive ka të bëjë me studimin e dallimeve lidhur me derivacionin leksikor të termave, gjë që shpie te të dhëna të rendit konceptual. Kjo analizë mundëson të tregohen dallimet dhe zbrazëtitë leksikore në mes këtyre dy gjuhëve. Për shembull, shqip kemi *kontratë shitjeje* kurse fr. *contrat d'achat* por edhe *contrat d'acquisition*, që formojnë emra vepruesi, *acheteur* dhe *acquéreur* (blerësi).

Lloji i tretë i studimeve, i bazuar mbi një qasje transformacionale, garanton një sukses të padiskutueshëm në studimet frazeologjike dygjuhësore. Aty mund të analizojmë fenomene siç janë emërzimi i foljeve ose i mbiemrave ashtu si dhe mbiemërzimin. Këto studime mundësojnë të konstatohen çrregullsitë relevante në gjuhët e krahasuara. Frëngjisht përdoret *certifier/ attester /authentifier/ légaliser un document*, kurse shqip barasvlerësi është *vërtetoj, legalizoj një dokument*. Emërzimet e mundshme të shprehjeve foljore janë *certification/ authentification/ légalisation d'un document*. Emërzimi i shprehjes **attestation d'un document* nuk është i pranueshëm; shqip kemi *vërtetimi, legalizimi i dokumentit*. Sa i përket mbiemërzimit frëngjisht kemi në dispozicion format: *un document certifié/ authentifié/ légalisé*, por jo **attesté*. Pra përkthyesi nuk duhet të bjerë në grackë (duke u nisur nga analogjitë në gjuhën

amtare) se mund të përdorë në togfjalëshin frazeologjik frëng emrin ose mbiemrin.

Pasojat e ekuivalencës së termave juridikë dhe zgjedhjet e tyre

Në gjuhën juridike, shumica e termave kompleksë nuk janë të vështirë në dekodim, por kur duhen përkthyer, dalin probleme lidhur me zgjedhjen e termit të saktë. Si të përkthehet nga një sistem juridik në tjetrin, kur konceptet e njëjta juridike nuk ekzistojnë, ose kur një koncept ekziston, por nuk përkon saktësisht me një koncept në gjuhën tjetër? Kur kemi të bëjmë me përkthim juridik, përkthyesi ballafaqohet me koncepte të mirëfillta për një kulturë juridike dhe gjuhës së saj. Si të kënaqemi me një përkthim të fjalëpërfjalëshëm? P.sh, kjo shpie të përkthehet një «*kërkesë Gjykatës së Lartë për të rishqyrtuar një vendim*» me *demande de révision de décision au tribunal de cassation*, kurse ekziston frëngjisht frazeologjizmi *faire un pourvoi, un recours en cassation*.

Një pyetje shtrohet pandërprerë: si të respektohet përmbajtja origjinale e secilit sistem të krahasuar dhe të kërkohet njëkohësisht simetria në mes të sistemeve që krahasojmë? Aty paraqiten tre raste, mund të kemi ekuivalencë të plotë, të pjesshme dhe mungesë ekuivalence. Kur një koncepti të dhënë në një sistem i përgjigjet një tjetër barasvlerës në sistemin tjetër, atëherë kemi ekuivalencë të përkryer. P.sh. *droit judiciaire* : e drejta procedurale, *mandat d'arrêt / fletëarrest*, etj.

Probleme dalin në raste ekuivalence të pjesshme ose në mungesë të saj. Në të vërtetë, në etapën e vënies në ekuivalencë, vërejmë shpesh se sistemet nuk përputhen. Përkufizimet e termave të çiftëzuar nuk paraqesin të njëjtin numër të tipareve semantike kur ekuivalenca është e pjesshme. Konceptet mbulohen pjesërisht. Për ta sqaruar këtë, të shqyrtojmë dy njësi frazeologjike frënge që në shikim të parë duken sinonime: *détention criminelle* dhe *réclusion criminelle*, të cilave shumica e përkthyesve u kishin dhënë barasvlerësin *burgosje për vepër penale*, por e para përdoret për burgosje të një të dënuari për krim politik dhe me një trajtim të ndryshëm nga

ai i të burgosurve të tjerë, kurse e dyta, për burgosje tjera për vepër penale.

Rasti i fundit është ai i mungesës së ekuivalencës të termave nga një sistem te tjetri për njërën nga këto dy arsye vijuese: ose ka mungesë të konceptit ose mungesë të emërtimit. Mund ta ilustrojmë këtë me një shembull: *casier judiciaire*, certifikatë që nuk jemi (ose jemi) nën hetime. Këtu koncepti ekziston në të dy sistemet, por jo emërtimi, pasi e përkthejmë me një perifrastë. Mund të konstatojmë se përkthime të tjera janë të mundshme, por duhet pranuar se frazeologjizmat kanë përparësi të dyfishtë: u shmangen perifrastave të gjata – përparësi e koncizitetit, dhe tregojnë një gjuhë më të elaboruar në përputhje me rigorozitetin e teksteve juridike.

Studim i krahasuar i skemës aktanciale të frazeologjisë

Kemi shqyrtuar frazeologjizma që dalin në gjuhën juridike me një frekuencë të dallueshme dhe u shtrojnë probleme përkthyesve për nga specifikat e tyre. Si ilustrim po paraqesim në vijim vetëm dy strukturat morfosintaksore më të shpeshta të njësisve frazeologjike, duke ditur se ekzistojnë edhe të tjera.

- Sintagma emërore : **emër + parafjalë + emër:**

Acte de condamnation : aktdënim; *acte de temoignage* : aktdëshmi; *acte d'accusation* : aktakuzë; *projet de loi* : projektligj; *injonction de payer* : urdhërpagesë; *garde à vue* : paraburgim; *en vertu de l'article* : në bazë të nenit; *peine de mort* : dënim me vdekje; *mise en examen* : vënie nën hetim; *blanchiment d'argent* : pastrim (ose larje) parash; *entrée en vigueur* : hyrje në fuqi; *ordre du jour* : rend dite, etj.

Nga këta shembuj, konstatojmë se barasvlerësit e tyre paraqiten në gjuhën shqipe qoftë me të njëjtën skemë aktanciale, qoftë me një fjalë të përbërë (kompozitë). Nuk është e çuditshme kjo kompozitë, sepse shqipja është gjuhë më sintetike se frëngjishtja, që është më analitike.

Kjo skemë tregon gjithashtu se ekziston një problem në zgjedhjen e parafjalës kur përkthejmë nga një gjuhë te tjetra. Mund të

shtrohet çështja e konstantes semantike të parafjalëve siç janë «sur» dhe «de»: parafjala «sur» nuk shpreh gjithmonë vendin dhe «de» nuk dëshmon gjithnjë për një raport përkatësie. Kjo skemë paraqet gjithashtu çështje të ndryshme si ajo e përdorimit të nyjave (të trajtës së shquar e të pashquar) dhe të mungesës së tyre

Duhet shtuar se çështja e polisemisë së gjuhës juridike është një nga aspektet më të vështira për t'u përvetësuar. Gjuha e drejtësisë është njëra nga gjuhët e specializuara më polisemike. Përkthyesi i nënshtrohet vështirësisë të dijë të dallojë domethënien e saktë në kontekstin e përdorimit në gjuhën shqipe për të gjetur barasvlerësin e përshtatshëm në gjuhën frënge. Termi juridik “*vendim*” mund të përkthehet me terma të ndryshëm si *décision*, *arrêté*, *décret*, *ugement*, *sentence*, *ordonnance* etj. Analiza semantike vë në dritë se këta terma kanë një emërues, një semë të përbashkët që është *vendimi*, mirëpo konteksti do të na tregojë se me cilin prej tyre kemi të bëjmë në rastin e dhënë. Nëse vendimi lëshohet nga një gjykatë e lartë, nga kryetari i shtetit apo nga ministri, nga një gjykatë e shkallës së parë, do të kemi *arrêt*, *arrêté*, *décret*, *sentence*, *jugement* etj.

- Sintagma **emër + mbiemër**.

Do të ndalemi te kjo skemë e cila është shumë e pranishme në gjuhën juridike. Vërejmë se shumica e mbiemrave janë marrëdhëniorë. Ata kanë veçorinë semantike të vënë lidhje në mes të dy emrave: ai që është bazë dhe ai nga i cili varet sintaktikisht; prandaj kanë veçorinë semantike të vënë lidhje në mes dy kuptimeve. Barasvlera është e mundshme me një plotës të emrit parafjalor të një termi brenda sintagmës emërore: *purge hypothécaire* = *purge des hypothèques* / *zyra e hipotekave*; *accord interinstitutionnel* / *marrëveshje ndërinstitutionale*; *erreur judiciaire* / *lajthim juridik*; *loi organique* / *ligj organik*; *loi constitutionnelle* / *ligj kushtetues*; *réclusion perpétuelle* / *burgim i përjetshëm*, etj.

Përkthimi nga frëngjishtja në shqipe jep zgjidhjen në mes të disa strukturave të mundshme:

- mbiemër i formuar me derivacion si në frëngjishte: *droit judiciaire ou droit procédural* : e

drejta procedurale; *loi constitutionnelle* / *ligji kushtetues*, etj

- me një përcaktues : *libération conditionnelle* / *lirim me kusht*; *purge hypothécaire* / *zyra e hipotekave*; *loi financière* / *ligji i financave* etj.

- me një mbiemër të përbërë; *un jugement prend force exécutoire* / *vendimi është i plotfuqishëm*

Këta shembuj tregojnë mundësitë e ndryshme të përkthimit të tyre në gjuhën shqipe, gjë që duhet të na bëjë vigjilentë të mos i përkthejmë në mënyrë të automatizuar, si p.sh. *libération conditionnelle* me **lirim kushtor* (në vend të *lirim me kusht*), edhe pse struktura *emër mbiemër* është model mjaft i shpeshtë i bashkimit.

Analiza e skemës aktanciale ka mundësuar të tregohen dallime në sintagmat parafjalore. Ky studim mundëson përveç kësaj të dallohen frazeologjizmat juridikë të këtyre dy gjuhëve. Në gjuhën juridike shumica e termave kompleksë përdoren me një kuptim të fjalëpërfjalshëm, mirëpo në përkthim, problemet dalin lidhur me gjetjen e termit adekuat.

Përfundim

Me njësinë terminologjike merren parasysh po ashtu edhe njësi më komplekse, njësitë frazeologjike. Ky studim ka mundësuar të vlerësohet dobia e terminologjisë së krahasuar në zgjidhjen e vështirësive të përkthimit. Vendosja e një ekuivalence korrekte varet nga analiza e fushës konceptuale në secilën gjuhë, sipas metodave të terminologjisë njëgjuhësore. Pastaj, përkimet konceptuale potenciale merren parasysh në një perspektivë krahasuese. I takon atëherë përkthyesit të bëjë zgjedhjen që imponohet.

BIBLIOGRAFIA

BAJRAMI, B.(2010) «Prurjet frënge në terminologjinë administrativo juridike shqipe», *Seminari XIX ndërkombëtar për gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë.

BOCQUET, C. (1996), «Traduction spécialisée : choix théorique et choix pragmatique», dans *L'exemple de la traduction juridique dans l'aire francophone*, Genève, Parallèles, n° 18, p. 67-76.

CLAS, A. (1994) : «Collocations et langues de spécialité», in *Meta* 39-4, p. 576-580.
HARVEY, M. (2002), «Traduire l'intraduisible. Stratégies d'équivalence dans la traduction juridique», *Les Cahiers de l'ILCE*, vol.3, pp. 39-49.

MOUNIN, Georges (1963) : *Les problèmes théoriques de la traduction*, coll. «Tel», Paris, Gallimard.

REY, A., *La Terminologie, noms et notions*, «Que sais-je?», n° 1780, Paris, PUF, 1992.

THOMAJ, J.(1981), *Çështje të frazeologjisë në gjuhën shqipe*, Tiranë..

PERSONAZHI SATIRIK DHE QESHARAK NË ROMANIN “KARRIERA E ZOTIT MAKSUT” TË FJALËT E LIGJËRIMIT POPULLOR SI BURIM PËR TERMINOLOGJINË DIALECTS AS A SOURCE FOR THE TERMINOLOGY

Emil LAFE
AKADEMIA SHQIPTARE E SHKENCAVE DHE E ARTEVE
e-mail: emilafe@yahoo.com

Përmbledhje

Është e njohur se leksiku terminologjik i çdo gjuhe mbështetet gjerësisht në fjalët e gjuhës së përgjithshme popullore. Përveç fjalëve me shtrirje në mbarë gjuhën ose në pjesën më të madhe të arealit të një gjuhe, terminologjia pasurohet edhe me fjalë dialektore, që përdoren në treva pak a shumë të ngushta, por që gjykohen si të përshtatshme për t'u ngritur në terma. Kjo ndodh kur fjala dialektore (kryesisht emra) jo vetëm mbulon semantikën e konceptit përkatës në sistemin e dhënë terminologjik, por edhe është fjalë e vjetër e shqipes me aftësi fjalëformuese (p.sh. *zhardhok* – *zhardhokor*; *i mysët* “konveks” – *mysëti*; *i lugët* – *lugëti* “konkavitet”), *deltinë* – *deltinor*, *rreshpe* – *rreshpor* etj. Një numër i mirë fjalorësh krahinorë të botuar kohët e fundit përmbajnë me dhjetëra fjalë që mund të shfrytëzohen për qëllime terminologjike.

Fjalë çelës: *terminologji, terminologjizim, dialektizëm, semantikë, fjalëformim*

Summary

The terminological lexicon of each language finds its broad support in the generic lexicon of the popular speech. Also, except those words which occur in the whole linguistic areal or in a broad part of it, the terminology is enriched by dialectal words used in narrow areas, if they are deemed to be fit for the terminological use. This occurs when the dialectal word (mainly nouns) not only covers the semantic of a concept in the terminological system, but it is also an old/archaic word of the Albanian, fit for the word-formation (such as *zhardhok* – *zhardhokor*; *i mysët* “konveks” – *mysëti*; *i lugët* – *lugëti* “konkavitet”), *deltinë* – *deltinor*, *rreshpe* – *rreshpor* etj. A good number of dialectal dictionaries that have appeared recently contain tens of words which can be used for terminological purposes.

Key-words: *terminology, terminologyzation, dialectism, semantics, word-formation*

Është e njohur se leksiku terminologjik i çdo gjuhe mbështetet gjerësisht në fjalët e gjuhës së përgjithshme popullore. Kështu edhe në gjuhën shqipe fjalët të tilla si *bërthamë*, *bimë*, *bosht*, *brez*, *deltinë*, *grimcë*, *lodhje*, *lyshtër*, *rreshpe*, *rrënjë*, *shtrat*, *shtresë*, *vatër* etj., krahas kuptimit të parë konkret kanë marrë kuptime të reja si terma në fusha të ndryshme të dijes. Por përveç fjalëve me shtrirje në mbarë gjuhën ose në pjesën më të madhe të hapësirës gjeografike të një gjuhe, terminologjia pasurohet edhe me fjalë të ligjëritimit popullore, që përdoren në treva pak a shumë të ngushta, por që gjykohen si të

përshtatshme për t'u ngritur (ose për t'u fisnikëruar) në terma. Kjo ndodh kur fjala dialektore a krahinore (kryesisht emra) jo vetëm mbulon semantikën e konceptit përkatës në sistemin e dhënë terminologjik, por edhe është fjalë e vjetër e shqipes.

Një ndër të parët që ka ndjekur me vetëdije këtë rrugë, është Naum Veqilharxhi. Te “Ëvetari” i vitit 1945 ai shkruan: “e di mirë që *kalasë* i thoshin *murnime* dhe *forcomje*”; në një vend tjetër ai sqaron se fjalën *gërbjë* me kuptimin e fjalëve të huaja ‘kullë’ (nga turqishtja) dhe ‘pìrg’ (nga greqishtja) e ka gjetur “*mbë një vënt të shkruar*”.

Këto tri fjalë, që i përkasin terminologjisë së fortifikimeve, sot janë arkaizma, nuk kanë zënë vend as në fjalorët shpjegues, por mund të kishin pasur një fat më të mirë, po të kishin tërhequr me kohë vëmendjen e lëvruësve e të studiuesve të shqipes. Por edhe sot mund të shërbejnë për të dalluar emërtimet *kështjellë* – *kala*¹ (p.sh. e Shkodrës, e Elbasanit, e Beratit, e Gjirokastrës) nga emërtimi për një fortifikim me përmasa më të vogla, si p.sh. ajo që quhet kështjella a kalaja e Rodonit e të tjera të ngjashme a më të vogla. Ky shembull nga N. Veqilharxhi dëshmon se lëvruësit e gjuhës shqipe i kanë vlerësuar gjithnjë *fjalët plaka e të harruara* dhe fjalët dialektore.

02. Që në fillimet e veprimtarisë së gjuhësisë sonë për rregullimin e terminologjisë fjalët e leksikut të përgjithshëm dhe fjalët dialektore janë vështruar si burim i dorës së parë. Në kriteret shkencore të kësaj veprimtarie, të shpallura në parathënien e fjalorit të termave të botanikës, është përcaktuar si kriter kryesor: “të shfrytëzohen sa më shumë mundësitë mëdha që ka gjuha jonë për fjalë terma dhe prirja që ka marrë vetiu zhvillimi i gjuhës letrare në kohën tonë. Për këtë është dashur në disa raste që kuptimi i fjalëve të fondit të gjuhës sonë të zgjerohet, duke u shtrirë përtej sferës së ngushtë të jetës praktike dhe zejtare gjer te konceptet e përpikta dhe abstrakte të shkencës.” (Terminologjia e botanikës 1963: 7). Nga fusha e botanikës shërbejnë si shembuj fjalët-terma *bërthamë*, *burbuqe*, *kësulë* (e rrënjës), *kikël* (apex), *pjalm* (polen), *zhardhok*, *artisje* (transplantim i bimëve), që shënojnë objekte ose veprime konkrete, por edhe ndonjë term *ardhangie* (frëngjisht *turgescence*, “gjendje e fryrë e qelizave dhe e indeve të organizmave të gjallë”), e krijuar nga fjala popullore *ardha* që ka kuptimin “fiton njomështi; mbushet, ngjallet (për bimët)”, dhe te ky shembull kemi rastin kur fjala ka marrë një kuptim abstrakt.

Kjo nuk është ndonjë gjë e re për teorinë e përgjithshme të ndërtimit të terminologjisë, pasi edhe gjuhë të tjera kanë ndjekur këtë rrugë për të ndërtuar sistemet terminologjike. Mjafton të

përmendim p.sh. termin *chip* të anglishtes nga fusha e elektronikës, po kështu termin e mekanikës *candela* në italishte. Shumëkush mund të kujtojë se këto janë fjalë-terma të mirëfilltë, të njëkuptimshëm, por në të vërtetë janë fjalë të leksikut të përgjithshëm në ato gjuhë dhe kuptimi terminologjik i tyre është i prejardhur, pra kemi të bëjmë me një zgjerim kuptimi. Ndërkaq mjaft gjuhë europiane (ndër to gjermanishtja, italishtja, rusishtja, greqishtja) e kanë pranuar fjalën *chip* si term të elektronikës, pa e zëvendësuar me barasvlerësin e saj (në gjuhën shqipe do të ishte “ashkël” ose “cifël”). Për fjalën *kandele* është me interes të vërejmë se ajo përdoret kudo në Shqipëri si term i teknikës, por nuk është përfshirë në asnjë nga fjalorët shpjegues të shqipes. Te “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980) kuptimi i këtij termi shpjegohet te fjala *qiri* (kuptimi 3), por vetëm tek Arbëreshët mund ta dëgjosh këtë përdorim²; te “Fjalori i gjuhës shqipe” (2006) ky kuptim i fjalës *qiri* është hequr (mendoj me të drejtë), por nuk është shtuar fjala *kandele*. Nga ana tjetër, si term për njësinë matëse të forcës së dritës në gjuhën shqipe është pranuar tashmë fjala *qiri*, kurse në gjermanishtje fjala *Candela* (nga latinishtja), ndërsa si term teknik gjermanishtja ka sajuar një fjalë të vetën: *Zündkerze* (“qiri ndezës”).

Herë-herë ngritja e një fjale popullore në term ndjek një gjedhe të huaj si p.sh. *rrymë* me kuptimin rrymë elektrike, letrare, politike etj., por herë-herë mund të jetë një rast krejt i veçantë i shqipes, si p.sh. termi *lëndë landë* me kuptim të parë “dru si material ndërtimi”, që ka marrë një varg kuptimesh të tjera të fushës diturore, si “materie, substancë, përmbajtje, objekt, tërësi njohurish të një fushe të caktuar etj.”

03. Fjalët e gurrës popullore e dialektore përgjithësisht përdoren si terma për të shënuar edhe sende, veti a veprime konkrete, prandaj ato mund të hyjnë në punë më fort në fusha të tilla të dijës si botanika, zoologjia, bujqësia, biologjia, mjekësia, gjeografia, gjeologjia, teknika etj., me degët e tyre të ndryshme. Fjalët dialektore janë

Kam pasur rastin të vërej se, kur flasin shqip (arbërisht), Arbëreshët i përkthejnë edhe termat teknikë të italishtes në dialektin e tyre.

të përshtatshme për t'u ngritur në terma sidomos kur shfaqin edhe aftësi fjalëformuese, d.m.th. kur prej tyre formohen sidomos mbiemra, që janë aq të nevojshëm në terminologji, p.sh. *bërthamë - bërthamor, bimë - bimor, bishtajë - bishtajor, bosht - boshtor dhe boshtak, brez - brezor, deltinë - deltinor, lyshtër - lyshtëror, rreshpe - rreshpor, rrënjë - rrënjor, shtresë - shtresor, zhardhok - zhardhokor* etj., ose kur nga mbiemri formohet emri përkatës abstrakt, si i *mysët* "konveks" - *mysëti*; i *lugët - lugëti* "konkavitet".

Për vlerën e fjalëve të gjuhës popullore për terminologjinë dhe leksikon dituror në përgjithësi sjell një varg shembujsh prof. Eqrem Çabej në shkrimin e tij të njohur "Për pastërtinë e gjuhës" (Çabej 1/1981, 1: 36-47; Thomai 9/1989, 4: 21-29; 2001: 323; Shehu 31/2013, 2: 79-86), ku shkruan ndër të tjera se anët e Beratit e të Frashërit (sipas Kristoforidhit) zgavrës së një druri të madh i thonë *zgërbonjë*; Dangëllia një ene bakri me veshë i thotë *veshore*; Labova e Rrëzës së Tepelenës, kur bie borë e imët, thotë *mizon*; Myzeqeja grykës së lumit që derdhet në det i thotë *gojkë*; ana e Shpatit modelit i thotë *gjedhe*; në të folmen e Tiranës ndiheshin dhe ndihen fjalë si *kryemot* për natën e ditën e vitit të ri dhe *hulli* për "brazdë"; në anët e Krujës dëgjohet *anësujë* për "ishull"³; Mirdita vendosjes së një grupi etnik të vendosur në një vend të ri i thotë *ngulim*; Shkodra tekstileve u thotë *veglorë*, fjalë që lidhet me *vegël*, që përdor Korça për vegjët; anët e Veriut fundërisë që mbetet nga të shkrirët e një lënde i thonë *bram*, zgjyrës *bramc farke*, shtrirjes së një lugine i thotë *lugajë*, një fushe vogëlake *vuth*, një galerie a tuneli *zafelle*, tumave të lashta (arkeologji) *kodërvarre*, një grumbullimi lulesh në trajtë të një kalliri të varur *vastak*; në Dibër një helmi të madh të shpirtit i thonë *djegë* (Çabej 1/1981, 1: 42).

Duke sjellë këtë shembull, E. Çabej e gjen të nevojshme të sqarojë: "Me këtë nuk themi se do të zëvendësojmë patjetër ishull-in dhe do ta heqim krejt nga përdorimi, porse japim shembullin për të treguar se edhe në fushën gjeografike gjuha e popullit ka formuar leksema si kjo, e cila mund të hyjë në përdorim në stile të veçanta të gjuhës letrare." (Çabej 1/1981, 1: 42).

04. Në kohën kur nisi dhe u zhvillua puna intensive për hartimin e fjalorëve terminologjikë, d.m.th. në vitet '50-'70, leksiku i gjuhës shqipe përfaqësohej nga "Fjalori i gjuhës shqipe" (1954) me rreth 23 mijë fjalë, nga një varg fjalorësh gjuhë e huaj - shqip dhe shqip - gjuhë e huaj, të cilët krahas fjalëve të përgjithshme të mbarë gjuhës, përmbanin edhe fjalë krahinore a dialektore, në mënyrë të veçantë fjalori i K. Kristofordhit (1904) dhe fjalori i Shoqërisë "Bashkimi" (1908). Në vitin 1941 në serinë "Visaret e Kombit" ishin botuar edhe dy fjalorë krahinorë me titullin "Fjalorth i ri": i Nikollë Gazullit me fjalë të mbledhura në krahinat e Veriut dhe i Pano Tases me fjalë të mbledhura në krahinat e Jugut. Në të përkohshme të ndryshme gjatë Rilindjes, po sidomos në vitet '20-'30, qenë botuar lista fjalësh të mbledhura nga arsimtarë e dashamirë të gjuhës shqipe në krahina të ndryshme. Një pjesë e mirë e gjurmuesve të fjalës shqipe kanë qenë mësues të formuar në Normalen e Elbasanit dhe janë këshilluar e nxitur për këtë veprim sidomos nga A. Xhuvani, duke vijuar në traditën e Kristoforidhit, i ishte vetë një mbledhës si zellshëm i fjalëve nga goja e popullit. Gjuhëtarët, që morën pjesë në komisionin e terminologjisë në vitet e para të punës së tij si Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Selman Riza, Mahir Domi, Androkli Kostallari, Lirak Dodbiba kanë qenë njohës të mirë të leksikut popullor dhe gjurmues të fjalës shqipe në fjalorët dhe botimet e ndryshme periodike. Prirja e tyre për të vlerësuar fjalën shqipe popullore dhe për ta futur atë në terminologji u ndoq edhe në veprimtarinë e mëtejshme të sektorit të terminologjisë.

Gjatë gjysmës së dytë të shek. XX dhe në këto vite të shekulli të ri mbledhja dhe botimi i fjalëve nga goja e popullit, ose e fjalëve krahinore a dialektore, ka shënuar arritje të rëndësishme. Duhet përmendur në radhë të parë ekspeditat e përvitshme dhe ngritja e një rrjeti bashkëpunëtorësh në rrethe nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Sektori i leksikologjisë e leksikografisë) dhe mbi këtë përvojë organizmi i aksionit kombëtar të mbledhjes së fjalës shqipe në dy faza në vitet '80 të shek. XX (Udhëzues 1989: 107). Frytet e kësaj veprimtarie ruhen si

dorëshkrime në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe në Kartotekën e Leksikut të Shqipes të shpërndara në shkronjat përkatëse. Një pjesë e fjalëve të mbledhura në popull janë botuar edhe në revistat “Studime filologjike” e “Gjuha jonë”, po ashtu në Kosovë në revistat “Gjurmime albanologjike” e “Gjuha shqipe”. Krahas kësaj dialektologët që kanë përshkruar të folmet e shqipes (në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni) kanë përfshirë rregullisht në punimet e tyre edhe fjalorthë dialektorë me fjalë tipike e karakteristike të asaj së folmeje, që kanë marrë nganjëherë përmasat e një fjalori të vërtetë krahinor. Materiale të tilla janë botuar në serinë “Dialektologjia shqiptare” me nxitjen dhe kujdesin e prof. Mahir Domit, si p.sh. fjalori i së folmes së Çamërisë nga Qemal Haxhihasani, rreth 90 faqe (Dialektologjia II, 1974: 26-114); po ky autor ka botuar edhe një fjalor të gjerë nga e folmja e Tiranës (Haxhihasani 2005: 258-427); nga Pjetër Elezi pjesa e parë (shkronjat A-B) e një fjaloi të përgjithshëm dialektor Në kuadrin e hulumtimit të së folmes së qytetit të Gjirokastrës janë bërë përpjekje të frytshme edhe për mbledhjen e pasurisë leksikore të saj nga Hasan Zazani, Muzafer Haxhiu dhe tani së fundi nga Mimoza Karagjozi-Kore (Zazani 1999: 246; Haxhiu 2010: 167; Karagjozi 2014: 308); Natasha Sotiri ka botuar një fjalorth të pasur të së folmes së Qeparoit (Sotiri 2001: 290, /Fjalorth, f. 143-248/).

Siç u përmend, një mbledhës si zellshëm i fjalëve shqipe nga goja e popullit dhe nga burime të tjera ka qenë Aleksandër Xhuvani. Fjalori i tij dorëshkrim u botua pjesë-pjesë nën kujdesin e prof. Mahir Domit edhe prof. Qemal Haxhihasanit në revistën “Studime filologjike” në vitet ’70-’80 të shekullit të kaluar dhe që parashikuar të dilte si vëllim i tretë i “Veprave” të tij. Ndërkaq që nga fundi i viteve ’70 e në vijim janë botuar një varg fjalorësh krahinorë, që po i renditim sipas vitit të botimit: “Fjalorth i fjalëve të rralla” nga Abdulla Zymberi (Prishtinë, 1979), “Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore” nga Sulejman Drini, Ibrahim Goçi, Mehmet Halimi, Skënder Gashi. Instituti Albanologjik i Prishtinës, (Prishtinë, 1982), “Fjalë popullore nga Myzeqeja” nga Jani

Nushi (Tiranë, 1991), “Fjalor i të folmeve shqiptare në Mal të Zi” nga Mehmet Ahmetaj (Prishtinë 1996), “Fjalor i shqipes truallsore të Maqedoni” nga Qemal Murati (Tetovë 1998), “Fjalor me shprehje dhe fjalë të rralla (Shprehje popullore frazeologjike nga Tropoja)” nga Petrit Zeneli (Tiranë, 1999), “Faqe nga visari leksikor i Mirditës” (Mirdita, 2002), “Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë” nga Qemal Murati (Shkup, 2003), “Visare gjuhësore-kulturore nga Malësia e Gjakovës. Vëllimi i dytë” nga Avdyl Sula (Tiranë, 2003), “Fjalor i shqipes së Plavës dhe Gucisë” nga Pavli Haxhillazi dhe Sulejman B. Ahmeti (Tiranë, 2004), “Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe” nga Benedikt Dema (Tiranë, 2005), “Fjalorth krahinor (i gjuhës shqipe)” nga Miço Samara (Tiranë, 2005), “Fjalor dialektor me fjalë e shprehje nga Jugu i Shqipërisë” nga Pano Tase (Tiranë, 2006), “Fjalë e shprehje nga krahina e Hasit” nga Shefqet Hoxha (Tiranë, 2007), “Fjalor me fjalë e shprehje nga leksiku bimor dhe shtazor i Skraparit” nga Haredin Xhaferi (Tiranë, 2007), “Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Prilepit, Krushevës dhe Velesit” (Shkup, 2007), “E folmja e Përmetit. Fjalor krahinor i Përmetit. Fjalor i emërtimeve trashëguese të bimësisë” nga Nexhip Mërkuri (Vlorë, 2009), “Fjalor fjalësh dhe shprehjesh popullore” nga Avdyl Sula (Tiranë, 2009), “Vëzhgime gjuhësore dhe etnografike. Monografi” nga Petrit Zeneli (Tiranë, 2010), “Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit” nga Ali Jashari (Korçë, 2013). Ka edhe disa fjalorë të tjerë me emërtime popullore ose tradicionale që u përkasin fushave të veçanta tematike (Memisha 2001: 245; Pepa 2002: 208, 222; Ulqinaku 2011: 136). Të pasur me fjalë të ligjërimeve popullore janë edhe fjalorët dygjuhësh të botuar në gjysmën e parë të shek. XX (Bibliografi 2005: 329-364) si dhe “Fjalor i gjuhës shqipe” i Mehmet Elezit (Elezi 2006: 1664). Nga treguesi i shembujve në më monografinë e J. Thomait për leksikon dialektor e krahinor del se në atë vepër janë trajtuar e shpjeguar rreth 8700 fjalë (Çabej 1/1981, 1: 42).

Në këtë trajtesë, për të mos u hapur shumë, nuk kam përfshirë visarin leksikor të diasporës

(arbëreshe, arvanitase etj.), por edhe në të folmet mund të gjenden fjalë të përshtatshme për të pasuruar leksikon terminologjik ose leksikon dituror në përgjithësi. E. Çabej përmend p.sh. se në Arbënesh të Dalmacisë për “shpina e dorës” thonë *përmidora* e për “krijoj” me një fjalë vendi *lentoj* (nga *lej*), prej nga mund të formohet edhe *lentim*; në Greqi për “gardh” thonë *thurimë*, fjalë që mund të përdoret edhe me një kuptim të figurshëm, si p.sh. në gërshetimin e veprimit të një drame (Çabej 1/1981, 1: 42-43).

Nga sa u parashtrua më lart dhe nga një vështrim i përgjithshëm (jo i thelluar) i fjalorëve dhe ndihmesave të tjera leksikografike për fjalën shqipe me burim nga ligjërimi popullor, kam arritur në përfundimin se është e nevojshme të ndërtohet një projekt, që mund të quhej “Vlerësimi i fjalës dialektore e popullore si burim për terminologjinë dhe leksikon letrar”. Ky projekt mund të ndërmerrej në bashkëpunim nga Instituti Alb-Shkenca dhe Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare e sapoformuar, duke ftuar edhe studentë për të shkruar tezën e masterit shkencor për një ose më shumë nga fjalorët. Lënda leksikore e një e një fjalori mund të paraqitet sipas tabelës 1 (shih më poshtë).

Në shtyllën e parë në fund të punës do të shënohet numri rendor i fjalës dhe kështu del edhe numri i saktë i fjalëve për çdo fjalor. Tabelës mund t’i shtohen edhe shtylla të tjera, p.sh. për etimologjinë e fjalëve (ato që nuk janë në FGJSSh), sepse në fjalorët krahinorë ka mjaft huazime krahinore nga gjuhët sllave e nga greqishtja ose turqizma arkaike, dhe autorët, duke mos i njohur, i paraqesin si fjalë që mund të pasurojnë fjalorin e shqipes së sotme. Natyrisht përcaktimi i burimit kërkon bashkëpunimin e specialistëve të gjuhëve përkatëse dhe sigurisht do të jetë me dobi edhe për ta.

Pasi të jetë klasifikuar lënda në këtë mënyrë, në përfundim kemi mundësi të përpilojmë fjalorë të posaçëm tematikë, duke bashkuar lëndën e të gjithë fjalorëve e të burimeve të tjera për një fushë të caktuar, si bie fjala emërtimet popullore gjeografike, p.sh. në fjalorin e A. Sulës të tilla janë: *gërguell* “gropë në lumë a në përrua”, *gërgulë* “gur shumë i madh dhe me strehë”,

gorbush “trevë e madhe e rrethuar me male”, *kepnajë* “vend me kepa, vend i thepisur”, *kershinë* “vend shkëmbor, gurishtë”, *kershullajë* “vend me gurë a shkëmbinj të mëdhenj” *kodërlec*, *kodrec* “kodër e vogël”, etj. Po kështu edhe për fusha të tjera tematike, si: veglat e punës në bujqësi, shtëpia dhe orenditë e saj, njësitë popullore të masave etj. Një punë shumë të lavdërueshme për mbledhjen e leksikut e popullor e të frazeologjisë së vreshtarisë e të verëtarisë (duke përfshirë edhe të folmet e diasporës arbëreshe e arvanitase) ka bërë prej vitesh prof. Andrea Shundi (Enciklopedi 2012: 869).

Klasifikimi i mësipërm jep mundësi për të ndërmarrë studime të thelluara e të plota për leksikon popullor të shqipes sipas fushave tematike dhe për të parë se: a) cilat fjalë janë sinonime të reja të fjalëve tashmë të regjistruara në fjalorët shpjegues dhe b) cilat fjalë nuk kanë ndonjë sinonim të njohur. Pikërisht fjalët e këtij grupi (b) vijnë më fort në vështrim për të pasuruar fjalorin e gjuhës shqipe, kur nuk janë huazime krahinore.

Përveç kësaj me këtë mënyrë mund të hetohet edhe gjeografia e përhapjes së fjalëve, duke ndërtuar edhe atlase për fjalët e një fushe tematike. Shtrirja gjeografike e fjalëve përbën edhe një kriter për vlerësimin e tyre, në kuptimin që fjalët me shtrirje më të gjerë kanë më shumë gjasa për t’u marrë nga gjuha letrare. Mendoj se kjo do të jetë një punë me dobi të shumëfishtë. Njëpërmjet saj fjalët që mund të thuhet se “fleenë” në fjalorët e sipërpërmendur, do të zgjohen e do të “shoqërohen” dhe do të rivlerësohen, në kuptimin që prej tyre do të përzgjidhen ato që janë më të nevojshme e të përshtatshme për leksikon dituror e për gjuhën e shkrimit. Nga ana tjetër, kush të merret me këtë punë, do të njohë qindra fjalë që nuk i ka ditur dhe do të mësojë ta shohë fjalën nga të gjitha faqet e larmishme që paraqet kjo shenjë gjuhësore, si unitet i një kompleksi tingullor me një a disa kuptime. Studimet për leksikon janë gjithnjë tërheqëse, konkrete, të frytshme, prandaj kam besim se një nismë e tillë do të përkrahet.

Tabela 1

Fjalë nga shkronja M e fjalorit të Avdyl Sulës

Fjala sipas normës letrare	Fjala sipas Fjalorit	Pj. e ligj.	Kuptimi (kur është e nevojshme)	Vendi ku thuhet (me shkurtime)	Fusha tematike	Është në FGjSSH FGjSh	Vetëm frazeologji
mace	=	<i>ef</i>			02	+	+
maçarung/ë,-a	=	<i>ef</i>	dru, shkop me gungë	Ks, Tro, Pu, Le	01		
maçorr,-i	=				02	+	+
maçungan,-e	=	<i>mb</i>	shtatlidhur	Tro, Pu	10		
maçungë,-a	=	<i>ef</i>	dru, shkop me gungë		01		
madh (i,e)	=	<i>mb</i>			09	+	+
magj/e,-ja	=	<i>f</i>			03	+	+
magjebosh	=	<i>mb</i>		Ks, Tro, Pu	09		
magjemykyr	magjemykun	<i>mb</i>		Ks, Tro, Pu, Le	09		
magjetor,-i	=	<i>m</i>		Ks, Tro, Pu	12		
magjishëm	=	<i>ndajf</i>			09		
mahnitshëm	=	<i>ndajf</i>		Ks, Tro, Pu, Le	09		
mahunë,-a	=	<i>ef</i>	bishtajë	Ks, Tro, Pu, Le	04		
maj	mâj	<i>kal.</i>		Ks, Tro, Pu, Le, Mr, rr. i Tr.	04		
majcak,-e	mâjcek	<i>mb</i>		Pu, MM	04		
majëcung,-ë	=	<i>mb</i>		Ks, Tro, Pu	09		
majëshyt,-ë	=	<i>mb</i>		Ks, Tro, Pu, Le	09		
majëtrashë	=	<i>mb</i>		Ks, Tro, Le	09		
majhosh,-e	=	<i>mb</i>			09	+	+
majnush/ë,-a	=	<i>f</i>	enjë	Ks, Pu			
majok/e,-ja	=	<i>f</i>	enjë		04		
majs,-i	mâjs,-i	<i>m</i>	mëndarak		04		
majt/ë (e)	=	<i>mb</i>	enjë	Ks, Tro	04		
majt/ohem	=	<i>vetv</i>	më shteron qumshti	Ks, Tro, Pu			
maknor/e,-ja	=	<i>f</i>				+	+
mal,-i	=	<i>m</i>				+	+

Tabela 2: Fushat tematike

01	Bota bimore (emërtime të bimëve, drurëve, të pjesëve të tyre, të sëmundjeve etj.).
02	Bota shtazore (emërtime të gjallesave: kafshë, shpendë, peshq, kandra të organeve e pjesëve të trupit të tyre, të sëmundjeve etj.).
03	Shtëpia: pjesët, shtojcat e jashtme dhe orenditë e saj (përfshirë shtresat e mbulesat).
04	Ekonomia bujqësore, pemëtaria e kopshtaria (mjetet e punës, proceset e punës, llojet e tokës bujqësore, sëmundjet e kulturave bujqësore, veti të tyre).
05	Ekonomia blegtorale (mbarështimi, ushqimi e strehimi i kafshëve shtëpiake, sëmundjet e tyre, pajimet e kafshëve; llojet e kafshëve shtëpiake sipas tipareve të ndryshme fizike (lloji i ngjyrës, forma e brirëve, madhësia etj.).
06	Gjeografia, hidrografia, klima, astronomia popullore (emërtime të terrenit, të rrjedhave ujore, të dukurive të natyrës, të gjendjeve të klimës, të erërave, të yjësive etj.).
07	Ushqimi i njeriut, lëndët ushqimore, llojet e gatesave e të pijeve.
08	Veshmbathja, lëndët dhe mjetet e përdorura, proceset e punës.
09	Jeta sociale, gjendja ekonomike, psikologjike dhe shëndeti i njeriut (lindja, vdekja, fejesa, martesja, tiparet fizike e morale, veprimet etj.), mjekësia popullore.
10	Njeriu sipas tipareve fizike (ngjyra, forma dhe madhësia e pjesëve dhe organeve të trupit).
11	Vreshtaria, prodhimi i verës, ullishtaria, prodhimi i vajit (llojet e rrushit e të hardhëve, proceset e punës në vresht, në ullishte, llojet e ullinjve, proceset dhe mjetet e punës për prodhimin e verës e të vajit të ullirit).
12	Zejtari (mjetet dhe proceset e punës të muratorit, zdrukthëtarit, farkëtarit, argjendarit, poçarit, rrobaqepësit, këpuçarit etj.); njeriu sipas mjeshtërisë (emërtimet e mjeshtërive).
13	Fjalë (me kuptim konkret e abstrakt) të sferës fetare e të besëtytnive.
14	Fjalë të sferës ushtarake e të luftës (emërtime armësh, pjesë të tyre, fortifikime, veprime).
15	Njësi popullore të masave të gjatësisë, peshës, vëllimit, sipërfaqes së tokës etj.
16	Të ndryshme (fjalë që nuk hyjnë në asnjë nga 15 pikat e mësipërme). Këto do të klasifikohen më tej në fusha të veçanta tematike.

Dallimi fjalë dialektore a dialektizëm dhe fjalë krahinore a krahinorizëm nuk është me rëndësi praktike për temën e këtij shkrimi. Për këtë çështje të diskutuar veçanërisht nga leksikografët tanë shih sidomos kreun e parë “Rreth koncepteve e termave “dialektizëm” e “krahinorizëm” në monografinë e Jani Thomait: Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme (2001).

Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980) fjalët kështjellë, kala dhe fortesë janë dhënë si sinonime; fjala forcë, që e jep “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954) me kuptimin “fortesë”, nuk është përfshirë te fjalorët e mëpasshëm.

Këtë fjalë e jep Kristoforidhi me kuptimin “fortohet”, e kundërta e sqaqet.

Kam pasur rastin të vërej se, kur flasin shqip (arbërisht), Arbëreshët i përkthejnë edhe termat teknikë të italishtes në dialektin e tyre.

Duke sjellë këtë shembull, E. Çabej e gjen të nevojshme të sqarojë: “Me këtë nuk themi se do të zëvendësojmë patjetër ishull-in dhe do ta heqim krejt nga përdorimi, porse japim shembullin për të treguar se edhe në fushën gjeografike gjuha e popullit ka formuar leksema si kjo, e cila mund të hyjë në përdorim në stile të veçanta të gjuhës letrare.” (Çabej 1/1981, 1: 42). Kjo fjalë mund të përdoret për pëlhurat e endura në vegjë, duke i dalluar nga tekstilet e tjera industriale.

Kjo fjalë është përfshirë në fjalorin e terminologjisë së botanikës për frëngj. corymbe, rus. щиток.

Komisioni i terminologjisë u formua me themelimin e Institutit të Historisë e të Gjuhësisë dhe të sektorit të terminologjisë më 1955, në kuadrin e Institutit të Shkencave.

Elezi, Pjetër (1982), Kontribute për fjalorin dialektor I. *Dialektologjia shqiptare IV*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, f. 345-370. Mjerisht nuk ka vijuar botimi i këtij fjalori me vlerë.

Përmban qindra fjalë të trevave verilindore të shqipes (Shqipëri – Kosovë) me klasifikime sipas fushave tematike

Bibliografia:

AKADEMIA e Shkencave e RPSH - Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1989), *UDHËZUES për mbledhjen e fjalëve dhe të shprehjeve të gjuhës shqipe (Për fazën e dytë të aksionit kombëtar)*. Tiranë.

BIBLIOGRAFI e leksikografisë shqipe, *Leksikografia shqipe Trashëgimi dhe perspektivë* (2005), Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Tiranë.

ÇABEJ, Eqrem (1/1981), Për pastërtinë e gjuhës. *Gjuha jonë*, nr. 1, Tiranë.

DIALEKTOLOGJIA shqiptare II, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë - Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1974), *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë* (II). Tiranë.

ELEZI, Mehmet (2006), *Fjalor i gjuhës shqipe*. Enti botues “Gjergj Fishta”, Tiranë.

ELEZI, Pjetër (1982), *Kontribute për fjalorin dialektor I. Dialektologjia shqiptare IV*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë.

ENCIKLOPEDI për vreshtarinë dhe verëtarinë (2012). Shtëpia botuese “Vllamas”, Tiranë.

FJALORI i gjuhës së sotme shqipe (1980), Tiranë.

FJALORI i gjuhës shqipe (1954), Tiranë.

HAXHIHASANI, Qemal (2005), Fjalor nga e folmja e Tiranës (qytet dhe fshat). *Dialektologjia shqiptare VII*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

KARAGJOZI KORE, Mimoza (2014), *Gjirokastra vështrim historik, gjuhësor, etnologjik*. Monografi. Botimet Dudaj, Tiranë.

MEMISHA, Valter (2001), *Emërtime për kafshë dhe shpendë në zonën e Labërisë*. Shtëpia botuese “ABC”, Gjirokastrë.

PEPA, Simon (2002), *Tradita bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor*. I) (Në viset veriore të Shqipërisë, në përqsje dhe me të folme të tjera të shqipes), II) Fjalor bujqësor në viset veriore të Shqipërisë, në përqsje dhe me të folme të tjera të shqipes). “Camaj-Pipa”, Shkodër.

SOTIRI, Natasha (2001), *E folmja dhe toponimia e Qeparoit*. “Konica”, Tiranë.

SHEHU, Hajri (31/2013), *Për një fjalor të përgjithshëm dialektor të gjuhës shqipe*. Gjuha shqipe, 2, Prishtinë.

THOMAI, Jani (2001), *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë;

THOMAI, Jani (9/1989), Rreth leksikut dialektor e krahinor. Gjuha jonë, 4, Tiranë;

ULQINAKU, Hajro (2011), *Glosar (Fjalorth i detarisë i të folmes së Ulqinit)*, botim II, i plotësuar. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Asociacioni Ulqini, Ulqin.

UNIVERSITETI Shtetëror i Tiranës - Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë (1963), *Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore 1 Terminologjia e botanikës (shqip – rusisht – frëngjisht)*, Tiranë.

XHAXHIU, Muzafer (2010), *Fjalor i të folmes së Gjirokastrës*. Tiranë.

ZAZANI, Hasan (1999), *E folme e qytetit të Gjirokastrës*. Studim dialektologjik. Fjalorth dhe shprehje popullore. Gjirokastrë.

SHQYRTIME ONOMASTIKE DHE SOCIO-ETNOLINGUISTIKE NË TË FOLMEN E MATI ONOMASTICS AND SOCIO-ETNOLINGUISTIC REVIEWS IN THE DIALECT OF MATI

SOCIAL MEMORY ACCORDING TO A FOLK SONG KUJTESA SOCIALE SIPAS NJË KËNGE POPULLORE

ARBNORA DUSHI
Instituti Albanologjik – Prishtinë
arbnoradushi@hotmail.com

Abstrakt

We build concept of social memory by exploring the relationship of social identity and historical memory. In this context, we will address to the Albanian folk songs about Magyar Pascha, these Albanian historical folk songs with the historical theme from nineteenth century. In our paper, we will try to explain why is need that such a historical fact happened more than one hundred e thirty years ago, to continue to produce social memory? What marks that memory in context of meeting the spiritual and cultural needs? Why Pascha was known as Magyar (Hungarian)? What is the role of social memory in context of knowing the reality, respectively knowing our self?

Keywords: folklore, social memory, folk song, Magyar Pascha.

Përmbledhje

Kujtesa sociale, ky koncept që e fitojmë duke e hulumtuar lidhjen e identitetit social me kujtesën historike, na mundëson që duke e gjurmuar kujtesën kolektive të zbërthejmë nevojat tona aktuale. Në këtë kontekst, nëpërmjet këtij punimi do të trajtojmë ciklin e këngëve për Maxhar Pashën, këngë popullore shqiptare me tematikë historike nga shekulli i nëntëmbëdhjetë. Në punimin tonë ndër të tjera do mundohemi të zbërthejmë se pse vazhdon të prodhojë kujtesë sociale një ngjarje që ka ndodhur më shumë se 130 vite më parë? Çka shënon kjo kujtesë në kontekst të përmbushjes së nevojave shpirtërore dhe kulturore? Pse pashai është quajtur Maxhar (Hungarez) Pasha? Cili është roli i kësaj kujtese sociale në kontekst të zbërthimit të aktualitetit, respektivisht të njohjes së vetvetes?

Fjalët çelës: folklori, kënga popullore, kujtesa sociale, Maxhar Pasha.

Hyrja

Për Maxhar Pashën dhe kombinimin e çuditshëm të emrin të tij, edhe hungarez edhe pasha, kam dëgjuar së pari nga gjyshi im kur më mbante përdore si të vogël dhe shëtisnim bashkë rrugëve të qytetit të Gjakovës. Më bënte përshtypje një varr i vetëm, me gurin e madh të varrit, me maje të rumbullakët dhe i rrethuar me hekura, që ishte mjaft i dallueshëm në parkun e vogël, posh-

të rrugës përkaj lumit Krena. Gjyshi më thoshte se ai ishte varri i Maxhar Pashës, i cili në kohën e Turqisë u kishte bërë keq shqiptarëve dhe ata e kishin vvarë. Madje më thoshte që aty e kishte vetëm trupin, sepse kokën ia kishin marrë me vete turqit. Një kureshtje e këtyllë konsiston në socializimin njohës dhe emocional që krijojmë me mjedisin fizik që në fëmijëri, e cila pastaj vazhdon të na përcjellë gjithë jetën (Heimo 2006: 50).

Kjo kureshtje m'u rrit edhe më shumë, më vonë, kur dëgjova që këndoheshin këngë për Maxhar Pashën, madje më tepër kur fare rastësisht i gjeta në internet (you tube) të regjistruara disa sosh, që këndoheshin nga këngëtarë të ndryshëm në periudha të ndryshme kohore.



Foto 1. Varri i Maxhar Pashës. (Foto: A.Dushi, prill 2014)

Kush ishte Maxhar Pasha?

Kush ishte Maxhar Pasha? Cila ishte origjina dhe emri i tij i vërtetë? Sipas historisë faktike, Mehmet Ali Pasha (titullin pasha e mori më vonë), ishte emri që e mori pas konvertimit në fenë islame, gjermani i lindur (1827) në Bradenburg të Prusisë, Ludwig Karl Friedrich Detroit, i njohur edhe si Karl Detroi, i cili rridhte nga një familje Huguenotësh francezë. Si i ri ai kishte shërbyer në ushtrinë e Perandorisë Osmane, duke arritur kështu shpejt të marrë gradën e pashait, si edhe atë të mareshalit (Muşir). Meqenëse ishte njohës i mirë i çështjeve të Ballkanit, ai u caktua të marrë pjesë edhe në Kongresin e Berlinit (13 qershor – 13 korrik 1978), në të cilin u thelluan vendimet e Traktatit të Shën Stefanit (3 mars 1878), vendimet këto që iu dhanë mundësinë e pavarësisimit nga Perandoria Osmane popujve, si serbët, grekët, bullgarët, malandezët etj., por që shqiptarët, ky popull jo i vogël në Ballkan, u injoruan duke mos u konsideruar faktor. Në këtë kontekst, me pavarësimin e Malit të Zi (sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit), u mor vendim që shqiptarëve t'u merren Plava e Gucia, dy qytete të banuara me shumicë shqiptare dhe

t'i jepen Malit të Zi. Për zbatimin e këtij vendimi, Perandoria ishte nën presionin e Fuqive të Mëdha, të cilat kërkonin me çdo kusht që ai të zbatohet. Kështu sulltani e caktoi Mehmet Ali Pashën të shkojë në Gjakovë, në këtë qytet të zonës veriore shqiptare dhe të qetësojë shqiptarët për vendimet e këtij Kongresi. Ardhja e tij i revoltoi edhe më tepër shqiptarët e mllefosur, aq më tepër që ai bashkëpunonte me Knjaz Nikollën e Malit të Zi, dhe kështu prijësit e shqiptarëve u organizuan që ta pengojnë ardhjen e tij në Gjakovë. Me këtë rast, u organizuan edhe shumë grupe luftëtarësh malësorë të armatosur nga Gjakova, Gashi, Krasniqja, Bytyçi, Hasi e nga Peja me qëllim që të kontrollonin rrugën nga do të vinte mareshali turk. Gjithashtu revoltën e mbështetën edhe krerët e Lidhjes, mirëpo në mesin e tyre ishin edhe përfaqësuesit e krahut të moderuar, të cilët mendonin se kjo situatë mund të zgjidhej edhe me dialog. Madje njëri ndër ta, Abdullah Pashë Dreni, edhe i ofroi konak Pashës, bashkë me truprojet e tij. Revolta e shqiptarëve arriti kulmin. Ata e rrethuan kullën e Abdullah Pashë Drenit, ku ishte i strehuar Pasha dhe për tri ditë luftime të armatosura arritën ta fitojnë betejën. Thuhet se u vranë 280 veta dhe 300 u plagosën. Ndër të vrarët mbeti edhe vetë Mehmet Ali Pashë Maxhari dhe Abdullah Pashë Dreni (që ishte një zyrtar shqiptar, anëtar i Lidhjes, por përfaqësues i krahut sulltanist në këtë organizatë) (Rizvanolli, 1991, 1992; 2005).

Këngët, vendet e kujtesës, memorialet

Kjo ngjarje e ndodhur 135 vjet më parë, vazhdon të jetë e pranishme në kujtesën e popullit nëpërmjet rrëfimit, tek të moshuarit, por edhe nëpërmjet këngës, e cila vazhdon të bëjë jetë aktive në folklor. Kënga e përmendur më sipër e shpreh qartë revoltën e shqiptarëve. Është një këngë kushtrimi, e cila synon të japë mesazhin për unitetin, por edhe vendosmërinë për të mbrojtur tokat deri në flim të jetës. Kjo këngë me tipare heroike, nëpërmjet një teksti të ngjeshur, por të shkurtër, e paraqet kontekstin historik të ngjarjes në të cilën ndodheshin shqiptarët. E kënduar me violinë që, në një ekzekutim përdoret si lahutë, kënga fiton

melodinë e këngëve të kreshnikëve dhe merr përmasat e një krijimi epik. Veçoritë e saj plotësohen edhe më tepër kur shihet se ajo këndohet para një audience krejtësisht mashkullore që pijnë alkool, natën, para zjarrit dhe shoqërohet me duartrokitjet e tyre. Përveç veçorive epike, tingujt e violinës (në këtë rast të konvertuar në tinguj lahute, sipas interpretimit muzikor të mësipërm), i japin edhe pak melodi vajtuese, e cila mund të nënkuptohet edhe si shprehje e melankolisë për statusin e ulët të shqiptarëve, realisht aspiratave të papërmbushura të tyre kombëtare. Pra, nevoja për të kënduar (lexo: vajtuar) edhe sot pas më shumë se një shekulli, një ngjarje të tillë ku tokat e tyre i morën fqinjët, është treguesi më i mirë për këtë gjendje.

Një këngë e tillë, me tekst të njejtë, gjendet në Youtube e kënduar dhe nga këngëtarë të tjerë, që e këndojnë me çifteli, por gjendet e kënduar edhe nga grupe të tjera dhe e shoqëruar me instrumenta të tjerë si harmonikë, mandolinë e orkestër të tërë. E këndonte rapsodi i njohur shqiptar Bajrush Doda, e recitonte me melodi Met Godeni, me violinë që i binte dhe tingëllonte si lahutë e këndonte Shemsedin Krasniqi, me çifteli e instrumenta të tjerë e këndonin vëllezërit Gashi, vëllezërit Mehmeti, madje e këndonte edhe këngëtari i muzikës argëtuese Sinan Vllasaliu në një version të moderuar. Këngët e këtilla këndoheshin edhe në ahengje e në raste gëzimesh, në takime kolektive burrash, përcilleshin me instrumenta popullore e me entuziazëm i këndonte e tërë oda.

Nevoja për thirrjen e kujtesës për një ngjarje të ndodhur shekuj më parë, ku u prek tërësia territoriale dhe u dëmtua hapësira gjeografike shqiptare, nevojë kjo për të ngjallur emocionin historik, është tregues se ajo vazhdon të jetë brenda nesh përherë e pafjetur. Madje kjo ndoshta, mund të konsiderohet një trashëgimi paramoderne, apo etnohistori, siç e quan Anthony D. Smith (Smith 1995 /2008: 64). Një Këngë e tillë vazhdon të prodhohet, nëse jo si tekst përshkrues i ngjarjes, ajo vazhdon të prodhohet si kontekst, të prodhohet si performansë dhe të prodhohet si interpretim. Prania e të gjitha grupmoshave në audience, ku asnjëri nuk mbetet i pa ndikuar nga emo-

cioni që prodhon kënga, e shpreh vazhdimësinë e idesë, të konceptit për vetëdijen e ruajtjes së tërësisë territoriale kombëtare, vazhdimësinë e këtij koncepti nëpër breza. E përcjell tek ata porosinë: “nuk i japim tokat tona, për pa u la në gjak Valbona”. Pra nuk lejojmë të na preket tërësia territoriale pa u la në gjak lumi Valbona, një metaforë e fuqishme kjo, mesazhi i së cilës porositë se për ruajtjen e tokave të atdheut nuk duhet kursyer as jeta.

Ashtu sikur kënga që është transmetuar në vazhdimësi, krahas me ruajtjen e varrit, është ruajtur edhe kulla (foto 2.), ku ishte zhvilluar beteja. Kjo ndërtesë, në qendër të qytetit të Gjakovës, sot në listën e monumenteve të kulturës së Kosovës, i ka rezistuar kohës. Ndonëse është e identifikuar si “Kulla e Abdullah Pashë Drenit”, sipas mbishkrimit të vendosur në murin e përparëm të saj, ajo sot është në funksion të objektit të Arkivit të qytetit. Kulla si e tillë vazhdon të njihet si kulla e Abdullah Pashë Drenit dhe të “dëshmojë” historikisht për ngjarjen, por në fakt, për betejën dhe aktin e vrasjes së Magjar Pashës nuk ekziston asnjë shënim, apo mbishkrim në mure të kullës. Ashtu e heshtur, pa ndonjë të dhënë të shkruar, përveç se në kujtimet e banorëve, ajo vazhdon të shërbejë si një mjet mnemonik, si objekt që na e ngjallë kujtesën për ngjarjen në fjalë. Madje ndonjëherë më shumë se vetë datat, ajo i ndihmon rrëfimtari të rikthejë kujtesën për ngjarjen. Një kalim i rastit kah rruga përskaaj saj, i ngjallë kureshtjen cilitdo kalimtar, për këtë objekt madhështor, i ngjallë atij interesimin të dijë më tepër për misterin që lidhet me të.



Foto 2. Shtëpia (kulla) ku u zhvillua beteja dhe vrasja e Maxhar Pashës. (Foto: A. Dushi, prill 2014)

Rreth kujtesës sociale që e prodhoi ngjarja

Kujtesa për ngjarjen historike dhe vrasjen e Maxhar Pashës sot ka arritur tek ne nëpërmjet tri mjeteve mnemonike: këngëve popullore, rrëfimeve gojore dhe objekteve memoriale (varrit dhe kullës ku u zhvillua beteja). Këto tri mjete janë burime të fuqishme për të dëshmuar se ngjarja e tillë vazhdon të prodhojë kujtesë sociale dhe ende të mos ketë marrë tërësisht statusin e historisë së përfunduar. “Historia fillon vetëm atëherë kur tradita nuk është më aktive dhe kujtesa sociale është shuar”, thotë sociologu francez Maurice Halbwachs, nga i cili gjeneron mendimi se përderisa këngët për Maxhar Pashën vazhdojnë të jenë pjesë e momenteve tona dhe të ndërtojnë kujtesën tonë sociale, atëherë ato ende nuk e kanë fituar statusin e të qenit vetëm fakt historik. Ato vazhdojnë të jenë pjesë e rrjedhës së përditshmërisë sonë, që d.m.th. tema, respektivisht koncepti që sjellin, vazhdon të jetë aktual dhe i pranishëm në mendësinë tonë. Sipas Halbwachs ekziston një dallim i qartë në mes historisë dhe kujtesës (memorjes), sepse përderisa historia merret me të kaluarën, memorja, që është e varur nga strukturat shoqërore është e orientuar drejt nevojave dhe interesave të grupit në të tashmen.

Prandaj, rikujtimi që i bën ajo ngjarjeve nga e kaluara, është i varur nga konceptet kolektive të kohës dhe të hapësirës, si edhe nga mënyra shoqërore e të menduarit dhe të përjetuarit, rrjedhimisht nga kuadri social, çka bën që edhe vetë memorja e individit të jetë e varur nga elementet kolektive, pra të jetë një *memorje kolektive* (Halbwachs 1992). Ngjashëm shprehet edhe Lyn Abrams, i cili thotë se memorja nuk është thjesht një thirrje, një rikujtesë e ngjarjeve dhe përvojave të kaluara në një mënyrë të pastër. Më tepër është një proces i të kujtuarit, një thirrje e imazheve, ngjarjeve, përvojave dhe emocioneve nga e kaluara jonë, për t’i renditur dhe vendosur brenda një ngjarje a rrëfimi në të tashmen dhe për t’i treguar në mënyrën që është formësuar, ose edhe vetëm pjesërisht, nga konteksti jonë kulturor e social. Pra më tepër është për të tashmen se sa për të kaluarën (Abrams 2010: 79). Folkloristët thonë se rrëfimet nga historia kanë dëshmuar se disa veçori të një ngjarjeje historike mund të mbesin në traditën gojore për një kohë të gjatë, madje edhe shekuj (Heimo 2006: 52). Atëherë, shtrohet pyetja cila ngjarje bartet, pra cila e fiton statusin e kujtesës sociale? Në këtë rast pse mu kjo ngjarje është transmetuar? Pse nuk është shuar si shumë të tjera? Këta autorë thonë se kujtesa bëhet sociale vetëm nëse është e aftë të transmetohet, të bartet, e për t’u bërë e tillë ajo duhet së pari të jetë e artikuluar, që i bie se kujtesa duhet të jetë kujtesë e artikuluar. Artikulimi nuk e nënkupton gjithmonë artikulimin në të shprehur, por më tepër në veprime e sjellje sesa në të folur. Madje thënë më saktë, ajo që më së shumti mbetet në kujtesë dhe e fiton statusin e bartjes janë konceptet; ato janë imazhet e mbetura në kujtesë të cilat pastaj ndërveprojnë me koncepte të tjera. Pra konceptet janë ato që i japin kujtesës forcën e transmetimit (Heimo 2006: 49). Atëherë konceptet qenkan ato që barten në histori, ato që na ndihmojnë ta mbajmë të gjallë kujtesën historike, jo imazhet, jo tekstet a fotografitë.

Përfundim

Konceptet nga historia, kur ndërveprojnë me koncepte të tjera nga aktualiteti, me të cilat gje-

jnë përputhje, ndikojnë që ato të ruhen dhe të barten.

Kur jemi në këtë pikë, dhe i referohemi she-mbullit tonë me këngët e Maxhar Pashës, e shohim se nuk është ngjarja e vitit 1878, pra vrasja e Maxharit as edhe heroizmi i shqiptarëve, ajo që e ka bërë këtë ngjarje të vijë dhe të vazhdojë të këndohet deri një ditët tona. Është koncepti i ruajtjes dhe unifikimit të tokave etnike, ai që e ka sjellë atë deri sot. Pra është ideja e tërësisë etnike të shqiptarëve, e të qenit të shqiptarëve në një shtet etnik, ideja e ruajtjes së tërësisë territoriale të tokave etnike, ajo që e ka krijuar këtë kujtesë sociale. Një koncept i tillë është bartur deri sot, sepse ka ndërvepruar me konceptin tjetër, atë të problemit shqiptar të pazgjidhur në Ballkan, pra të copëzimit të tokave shqiptare që vazhduan të mbeten nën administrimin e fqinjëve. Këto toka rreth e rreth shtetit të Shqipërisë, vazhdojnë të jenë nën pronësinë e shteteve të tjera dhe shqiptarët vazhdojnë të kenë aspirata për t'i kthyer ato. Rrjedhimisht, janë aspiratat e papërbushura të shqiptarëve ato që vazhdojnë ta mbajnë gjallë temën e këngëve për vrasjen e Maxhar Pashës, të otomanit që kontriboi në copëzimin e tokave shqiptare dhe prandaj vrasja e tij vazhdon të këndo-

het e të konsiderohet moment heroik i historisë së shqiptarëve.

Bibliografia

ABRAMS, Lyn (2010), *Oral History Theory*. London & New York: Routledge.

HALBWACHS, Maurice (1992), *On Collective Memory*, trans.&ed. by Lewis A. Coser. Chicago: The University of Chicago Press.

HEIMO, Anne (2006), *Places Lost, Memories Regained, Narrating Doing Experiencing: Nordic Folkloristic Perspectives*, *Studia Fennica Folkloristica* 16. Helsinki: Finnish Literature Society.

RIZVANOLLI, Masar (2005), Mehmet Ali Pasha dhe shqiptarët, Vjetar XXXIII-XXXIV. Prishtinë: Arkivi i Kosovës.

RIZVANOLLI, Masar (1991), Vrasja e Ali Pashë Maxharit sipas burimeve britanike, *Gjurmime Albanologjike*, seria e shkencave historike 21. Prishtinë: Instituti Albanologjik.

RIZVANOLLI, Masar (1994), Dështimi i misionit të Ali Pashës, *Buletin i Fakultetit Filozofik XXII/1992*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

SMITH, Anthony (1995), *Nations and Nationalism in a Global Era*. Cambridge: Polity Press.

BEOGRAD AGREEMENT BETWEEN AHMET ZOGU AND GREECE, 1924 MARRËVESHJA E BEOGRADIT MES AHMET ZOGUT DHE GREQISË, 1924

ARDIT BIDO

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Histori Filologjisë, Tirana, Albania
Email: arditbido@hotmail.com

PËRMBLEDHJE

Kumtesa trajton një marrëveshje të pretenduar në dokumente të Ministrisë greke të Jashtme, të arritur ndërmjet Ahmet Zogut dhe shtetit grek, gjatë qëndrimit të tij në Beograd në gjysmën e dytë të vitit 1924. Marrëveshja me pesë pika, që raportohet nga dokumentet diplomatike greke, e kryer me ndërmjetësimin e deputetit Mihal Kaso, kishte si qëllim mbështetjen e trupave të drejtuar nga Myfit Libohova dhe Koço Kota, të cilat hynë nga kufiri shqiptaro-grek gjatë kundërofensivës së Ahmet Zogut në fundvitin 1924. Marrëveshja përmban lëshime në fushën kishare dhe arsimore nga ana e Zogut, në momentin që do të vinte në pushtet. Punimi diskuton, gjithashtu, besueshmërinë e raportimeve diplomatike greke të kohës, duke përshkruar presionin që diplomatët grekë në Tiranë ushtronin ndaj Presidentit Zog gjatë vitit 1925 për realizimin e këtyre premtimeve, zvarritjen nga ana e Zogut, sikurse edhe përfshirjen e aktorëve politikë dhe shoqërorë shqiptarë për të përmbushur detyrimet e pretenduara ndaj Greqisë.

Fjalët çelës: Zogu, Greqi, Marrëveshje sekrete, Triumfi i Legalitetit

SUMMARY

This paper treats an alleged agreement, found in the documents of Greek Ministry of Foreign Affairs, between Ahmet Zogu and the Greece, during his stay in Belgrade, in the second half of 1924. The agreement of five points, realized via the mediation of MP Mihal Kaso, was made in order Greece to facilitate the troops of Myfit Libohova and Koço Kotta, to enter the Greek-Albanian border during Ahmet Zogu's counter-offensive in the end of 1924. The agreement contains concessions on religious and educational areas from Zogu, when he would get back in power. The paper also treats the credibility of those diplomatic reports, by describing the pressure made to President Zogu throughout 1925 by Greek Diplomats in Tirana for the realization of the agreement, the delay from Zogu, as well as the involvement of Albanian political and social actors in order to fulfill the alleged obligations towards Greece.

Keywords: Zogu, Greece, Secret agreement, Triumph of Legality

Qeveria me kryeministër Fan Nolin mori drejtimin e Shqipërisë në qershor 1924. Shumica parlamentare dhe qeveria e Iljaz Vrionit u detyruan të braktisin vendin për në Jugosllavi, të dëbuar nga një lëvizjeje e armatosur e drejtuar nga segmente të ushtrisë dhe opozitës. Edhe pse Vrioni ishte kryeministër, drejtuesi i pakundërshtueshëm i shumicës, tashmë të dëbuar, ishte Ahmet Zogu. Ai nisi nga Beogradi përpjekjet për t'u rikthyer në Shqipëri, duke hedhur qeverinë e Nolit. Për të arritur këtë qëllim, Zogut i

nevojitej të binte në ujdi me vendet fqinje, prej nga do të hynte në territorin shqiptar. Në gusht, Zogu arriti një marrëveshje me qeverinë Jugosllave, me 11 pika, e përqendruar mbi cedime territoriale dhe sovraniteti. Kjo marrëveshje është trajtuar vazhdimisht nga historiografia shqiptare, sidomos gjatë viteve të fundit, duke u cilësuar, ndër të tjera, si arsyeja pse Zogu mori ndihmë dhe u lejua të hynte në territorin shqiptar nga kufiri jugosllav (Krisafi 2014: 122; Mehmetaj 2004: 207).

Ajo çka historiografia shqiptare nuk ka shqyrtuar është si u mundësua hyrja e trupave zogiste nga kufiri shqiptaro-grek, të drejtuara nga Myfit Libohova dhe Koço Kotta. Në këtë punim sjellim për herë të parë në historiografinë shqiptare marrëveshjen e pretenduar mes Ahmet Zogut dhe shtetit grek të shtatorit 1924 të arritur në Beograd. Marrëveshja është rikonstruktuar falë dy dokumenteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë të botuara në një koleksion dokumentesh nga historiani grek Vasilios Kondis.

Marrëveshja

Ndërlidhës mes Ahmet Zogut dhe shtetit grek ishte deputeti Mihal Kaso. Ai mbante lidhjet mes enturazhit të Zogut dhe ambasadës greke në Beograd. Kaso ishte deputet i Gjirokastrës, shqiptar ortodoks, filogrek dhe mbështetës i padiskutueshëm i Zogut, me të cilin kishte kaluar kufirin për në Jugosllavi, kur qeveria e Nolit kishte ardhur në pushtet.

Pas disa bisedimesh, Kaso u udhëzua në fillim të shtatorit t'i prezantonte Ahmet Zogut kushtet që Greqia i vendoste për ta ndihmuar që të rikthehej në pushtet, duke lejuar trupat e drejtuara nga Libohova të hynin nga kufiri shqiptarogrek. Më 3 shtator, Kaso u takua me Zogun dhe i paraqiti pesë kërkesat e ambasadës.

Telegrami që përmban kushtet greke, nuk është i plotë në Arkivat e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë. Ai përmban vetëm se "Z. Kaso u takua me Zogun. I deklaroi kushtet e ndihmës së Greqisë /.../ zgjerimin mbi Epirin e Veriut, mosndërhyrjen në çështjet kishtarë të ortodoksëve, shkolla të lira tonat në Epirin e Veriut dhe mësimin e greqishtes në shkollat shqipe nëse kërkohet nga komunitetet. Zogu i pranoi kushtet duke i gjetur ato të pranueshme dhe llogjike, por pres ta takoj personalisht Zogun" (Kondis 1995: 160).

Hapësira e padeskriptuar, e fshehur nën tre pikat (...) në dokument, përmban thelbin e kushteve. Në këtë aspekt, rindërtimi i kërkesave greke për mbështetje ndaj Zogut, është bërë fal takimit të shtatorit 1925, ndërmjet ambasadorit grek në Durrës, Panurjas me Presidentin Ahmet Zogu. Panurjas i renditi Presidentit zotimet e këtij të

fundit në Beograd dhe Zogu i pranoi ato dhe dha përgjigjet përkatëse (Kondis 1995: 233).

Kushti i parë i ndihmës greke ishte që "të krishterët që jetojnë në Shqipëri të kenë të drejta të barabarta dhe të mos trysnohen" (Kondis 1995, 160). Me anë të kësaj kërkesë, pala greke dëshironte të merrte edhe nën patronazh ortodoksët në Shqipëri, sikurse kishte bërë Perandoria Ruse gjatë periudhës Otomane. Greqia do ta kërkonte haptazi më vonë këtë rol të privilegjuar, duke u bazuar pikërisht në premtimin e parë të Zogut në Beograd (Frashëri 19/4/1926).

Premtimi i dytë përcaktonte se Zogu do të tërhiqej nga çështja e Kishës Ortodokse Shqiptare, e cila ishte shpallur autoqefale përpara dy vitesh. Çështja kishtarë për Zogun ishte njëkohësisht edhe politike. Në krye të lëvizjes kishtarë shqiptare ishte Mitropoliti Theofan, kryeministri që e kishte hedhur nga posti. Prandaj, ai u pranoi përfaqësuesve grekë "gabimin e kryer për shpalljen e kotë të Autoqefalisë të Kishës Shqiptare", duke nënkuptuar autoqefalinë e Kishës nën drejtimin e Nolit. Zogu deklaroi se ai do të këmbëngulte për autoqefalinë, porse kjo në marrëveshje me patriarkanën. Si do që të ishte zgjidhja, ai mori përsipër që "të krishterët [do] të zhvillojnë fenë e tyre në cilën gjuhë të duan pa pasur dhunë qeveritare". Ky premtim rilegalizonte përdorimin e gjuhës greke në kishat shqiptare (Kondis 1995: 233).

Premtimi i tretë ishte lejimi i çeljes së shkollave private greke në Shqipëri, pa ndërhyrje qeveritare. Diçka e ngjashme ishte e pranuar në fakt që prej deklaratës për Mbrojtjen e Minoriteteve, të dorëzuar në Lidhjen e Kombeve nga Fan Noli prej vitit 1921 (Kondis 1995: 233).

Premtimi i katërt ndaj Greqisë ishte një lëshim i konsiderueshëm. Zogu u zotua të lejonte mësimin e gjuhës greke në shkollat e komuniteteve ortodokse shqiptare, nëse ato do ta pranonin diçka të tillë. Kjo, i hapte rrugë rikthimit në sistemin otoman, ku krahas gjuhës zyrtare, shqipes, në fshatrat dhe qytetet ortodokse, greqishtja do të rigjente vend në shkollim (Kondis 1995: 233). Vlen të theksohet, se ortodoksët

shqiptarë ishin 20 për qind, ndërsa pakica greke vetëm 1.5 për qind e popullësisë (Selenica 1928). Premtimi i pestë dhe i fundit kishte të bënte me privilegjet e Himarës. Greqia kërkoi që Himarës t'i njiheshin venomet që kishte gjatë Perandorisë Otomane, të riafirmuara në marrëveshjen e vitit 1920 me Jorgo Kolekën dhe të hedhura poshtë nga qeveria e Fan Nolit. Zogu i cilësoi të pranueshme dhe logjike kërkesat, duke autorizuar Mihal Kason që t'ia përcillte pranimin e tij ambasadës (Kondis 1995: 160).

Sipas dokumenteve greke këto ishin pesë pikat që përbënin Marrëveshjen e Beogradit. Dakordësimi ishte verbal dhe nuk u përvijua me një nënshkrim. Pas saj, qeveria greke lejoi që trupat e Libohovës dhe Kottës të hynin nga kufiri shqiptarogrek, gjatë kundërofensivës së Ahmet Zogut në Krishtlindjen e vitit 1924.

Shmangia e zbatimit

Pasi erdhi në krye të vendit dhe sidomos prej muajit shkurt, kur pushteti u konsolidua me shndërrimin e Shqipërisë në Republikë, pala greke nisi trysninë për zbatimin e Marrëveshjes së Beogradit. Në fillim të shkurtit 1925, ambasadori grek Panurjas u takua me Presidentin e Republikës Ahmet Zogu mbi zbatimin e marrëveshjes. Sipas ministrit grek, Presidenti i deklaroi se çështja kishtare dhe ajo e shkollave do të zgjidhej në çdo mënyrë të ligjshme dhe nëse do të kishte kundërshtime do përdorej dhunë. Panurjas raportonte: banorët duhet ta kërkonin vetë mësimin e greqishtes në shkollat e fshatrave ortodokse shqiptare “për nevojat fetare të ortodoksëve”, në mënyrë që të shmangej acarimi i nacionalistëve dhe myslimanëve. Panurjas takoi edhe deputetët e Gjirokastrës me të cilët ra dakord që të hartonin një raport, për të kërkuar çeljen e klasave në greqisht në shkollat e fshatrave ortodokse shqipfolëse (Kondis 1995: 195).

Ambasada greke ndihmohej edhe nga tre deputetë që vinin nga radhët e minoritetit grekë Lezo, Papadhopulli dhe Haxhogllu. Madje, atyre iu shtua edhe një deputet shqiptar, Ilia Muzina. Grupi i deputetëve kishte marrë përsipër realizimin e detyrimeve të marra në Beograd,

kryesisht çështjen kishtare dhe çështjen e gjuhës greke në shkollat e ortodoksëve shqiptarë. Ata e takuan Presidentin e saposhpallur. “Programi im është shkatërrimi i regjimit të tanishëm kishtar dhe shkollor dhe kthimi i të vjetrit” – u deklaroi Zogu, i thanë ata Panurjas. Ambasadori grek i udhëzoi të ktheheshin në zonat e tyre dhe të mblidhnin popullin për të dërguar telegrame ndaj qeverisë për mbledhjen e një kongresi ortodoksësh për zgjidhjen e çështjes kishtare, si edhe kërkesa për gjuhën greke në shkollat shqiptare (Kondis 1995: 208).

Kërkesa zyrtare për mësimin “e gjuhës fetare” në shkollat e shqiptarëve ortodoksë u depozitua më 4 prill 1925 në Ministrinë e Drejtësisë e nënshkruar krahas deputetëve, edhe nga 120 pleqësi të fshatrave të krishtera të qarkut (Liria, 7/4/1925: 1).

Reagimi i elitës ortodokse ishte i menjëhershëm dhe agresiv. “Koha” e drejtuar nga veterani i lëvizjes kishtare shqiptare, Mihal Grameno e cilësuan diçka të tillë si antikombëtare. Edhe deputetë të Parlamentit kundërshtuan ashpër ndaj një mundësie të tillë (Koha, 25/4/1925, 2).

Paralelisht, Zogu konsolidoi aleancat e nevojshme për t'i bërë ballë trysnisë greke. Në këtë drejtim, ndihmoi mbledhja e të gjithë drejtuesve të lëvizjes kishtare, akoma dhe ata që Athina mendonte se i kishte nën kontroll, nën mbështetjen e tij. Mitropolit i Korçës Jerotheu u dakordësua me Zogun që të kërkonin njohjen e kishës nga Patriarkana, kur të zgjidhej Patriarku i ri, teksa drejtimi i kishës ishte vakant (Liria, 24/3/1925, 1). Në fund të marsit, mitropoliti tjetër Kristofori u bashkua me qëndrimin e Zogut (Liria, 3/4/1925, 1). Në fund, Presidenti do të afrohej edhe me mbështetësit më të flaktë të Fan Nolit, kreun e Këshillit Kishtar, që provizorisht drejtonte kishën, Atë Vasil Marku. Takimi mes tyre më 23 maj dhe jehona e tij dhanë një sinjal të fortë se Zogu mbështeste Kishën Shqiptare dhe nuk do të tërhiqej nga autoqefalia (Koha, 30/5/1925, 1).

Rrethanat do ta ndihmonin edhe më tej Zogun, teksa zgjedhja e Patriarkut të ri Ekumenik vonoi deri në mes të muajit korrik. Në gusht, qeveria testoi nëse Patriarkana do të njihte autoqefalinë,

nëse nisej një delegacion, për të marrë përgjigje të paqartë se Patriarkana do të vendoste “në limitet e kanoneve të shenjta dhe rregullave kishtare” (Leskoviku, 15/8/1925).

Kështu, Zogu ia kishte dalë të shtynte për nëntë muaj zbatimin e premtimeve të Beogradit. Ai kishte arritur të ndryshonte klimën e muajve të parë që kishte ndrydhur kërkesat e nacionalistëve shqiptarë dhe kishte vënë në veprim kërkesat grekomane. Në fund të gushtit 1925, ambasadori Panurjas u takua me Ahmet Zogun për të vendosur pikat mbi “i” në të gjitha premtimet e Beogradit. Zogu i tha se çështja kishtare do të ndryshonte shpejt, duke e lënë atë nën drejtimin e Jerotheut, të cilin e quajti “vegël të grekëve”, edhe pse me të ia kishte dalë të shmangte presi-onin e Athinës (Kondis 1995: 233).

Ahmet Zogu iu shmang çështjes së shkollave duke thënë se këtë ua kishte lënë në dorë deputetëve Bamiha dhe Kaso (Kondis 1995: 233). Mirëpo, në realitet, Inspektori i Arsimit të Gjirokastrës, Jani Minga kishte refuzuar çfarëdo tentative të deputetëve për të çelur shkolla greke (Meta 2008: 88). Presidenti iu shpreh ambasadorit grek në pozitë të vështirë për shkak të çështjeve të Vermoshit dhe Shën Naumit, të cilat e kishin bërë të dukej keq në sytë e opinionit publik. Për këtë arsye, ai kërkoi edhe më shumë kohë dhe fleksibilitet në drejtim të detyrimeve të marra në Beograd (Kondis 1995: 233).

Mirëpo, koha e fituar, duket se ishte e mjaftueshme, teksa prej pak ditësh në Greqi sundonte një filoshqiptar, gjenerali arbëror Theodoros Pangalos. Ai do të ndryshonte kursin e marrëdhënieve shqiptarogreke, duke hequr dorë nga marrëveshja e pazbatuar e Beogradit, mëtimet mbi “Vorio Epirin” e greqizimin e gjithë ortodoksëve shqiptarë dhe duke njohur minoritetin shqiptar në Greqi. Pas pak ditësh, në Shqipëri do të dërgohej, konsulli i ri, Kolonel Kondulis, i cili njihej si proshqiptar (Koha, 26/9/1925, 2).

Përfundime

Për të mundësuar hyrjen e trupave të tij nga kufiri shqiptargrek dhe mospërfitimim e Athinës nga destabilizimi i Shqipërisë, Ahmet Zogu arriti në një marrëveshje prej pesë pikash me Greqinë,

në shtator 1924, gjatë qëndrimit në Beograd. Marrëveshja parashihte mosndërhyrjen e Zogut në çështjen kishtare, shkolla private greke për minoritetin, mësimin e greqishtes në shkollat e shqiptarëve ortodoksë dhe venome për Himarën. Trysnia greke nga janari deri në shtator 1925 e vendosi shpesh herë Ahmet Zogun me shpatulla pas muri. Përdorimi i disa deputetëve të Gjirokastrës dhe i disa gazetave, e vendosën në pozitë të vështirë përpara kërkesës greke për zbatimin e Marrëveshjes së Beogradit. Mitropolit Jerotheut u bë katalizator zbutjeje, pasi pas takimit me të, u kristalizua qëndrimi i përbashkët për mospranim të asnjë përfundimi tjetër përveç Autoqefalisë së Kishës Ortodokse, duke përdorur si pretekst problemet që kishte Patriarkana. Ky qëndrim gjeti në unison edhe Hirësi Kristoforin edhe Atë Vasil Markun. Njëherazi, nëpërmjet strukturave shtetërore, ai pamundësoi çeljen e shkollave greke deri në muajin gusht 1925. Ndryshimi i balancave solli një situatë të re, ku pala shqiptare rifitoi terrenin e humbur.

Bibliografia:

- (1925), Audiencë, Liria, 3 prill;
 (1925), Kryetari i Kishës Autoqefale, i Përndershmi Atë Vasil Marko u prit me nderime të posaçme në sallën e Kryetarit të Republikës, Koha, 30 maj;
 (1925), Liria, 24 mars;
 (1925), Shkurt, Koha, 26 shtator;
 DILO, V, (1925), Një nevojë e ngutshme, Liria, 7 prill;
 FRASHËRI M. (19/4/1926), Letër drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Viti 1926, Dosja 239, faqe 20, Arkiva e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë.
 KONDIS V, (1995), Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και ελληνοαλβανικές σχέσεις, έγγραφα από το ιστορικό αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών, τομος 3, 1922-1929 [Helenizmi i Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet grekoshqiptare: dokumente nga arkiva historike e Ministrisë së Jashtme, Vëllimi 3, 1922-1929]. Estia, Athinë;
 KRISAFI K, (2014), Për tokën dhe detin e Shqipërisë. UET Press, Tiranë;

LESKOVIKU N. (15/8/1925), Letër drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Viti 1925, Dosja 261, faqe 4, Arkiva e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

Mehmetaj F, (2004), Veprimtaria kriminale e “Dorës së Zezë” serbe në trojet shqiptare. Anatema, Prishtinë;

META B, (2008). Përpyqjet për konsolidimin e institucioneve kombëtare (1925-1935). Studime Historike 3-4;

SELENICA T, (1928), Shqipëria më 1927, Tiranë.

DISA ÇËSHTJE TË FONETIKËS AKUSTIKE DHE TË FONOLOGJISË, TË PARA SË BASHKU SOME ISSUES OF PHONETICS AND PHONOLOGY TO SEEING BOTH

ASEDA BEHARI

Qendra anglo-shqipare "Fenix",

Tiranë, Shqipëri

Email: aseda.behari@yahoo.it

Përmbledhje

Në këtë punim do të trajtohen këto çështje: tiparet fonetike dhe tiparet fonologjike: natyra e secilit grup dhe ndryshimet mes tyre; fonemat e bërthamës së sistemit konsonantik të së folmes sime; paraqitja e këtij sistemi në formë prizmi; gabimet e autorëve për fonemat skajore; ndryshimet mes sistemit të greqishtes së vjetër dhe atij të gjuhës mëmë indoevropiane; tiparet fonologjike të Trubeckoit dhe tiparet binare të Comski-Halles: dallimet midis tyre dhe tiparet më ekonomike; pse tipari [+- e përparme] që mungon te Bevingtoni është i domosdoshëm për të karakterizuar sistemin vokalik dhe konsonantik të shqipes? Pse për dallimin e anësoreve /l/ dhe /ll/ tipari [+- e prapme] është i domosdoshëm, kurse tipari [+- e larte] jo?

Fjalët çelës: fonetikë, fonologji, fonemë, Bevington, Halle

Abstract

This paper will address the following issues: Features phonetic and phonological features: the nature of each group and their differences; phonemes the core of the system konsonantik my Dialect; introduction of this system in the form of prisms; phonemes authors mistakes sides; differences between the old Greek system and the Indo-European parent language; Trubeckoit and phonological features of binary features of Chomsky - Halle's: their differences and economic features; Although feature [+ - front] missing the Bevingtoni is necessary to characterize the system vokalik and Albanian konsonantik ? Why the difference of lateral / l / and / ll / feature [+ - back] is necessary , and feature [+ - high] not ?

Key words: phonetics, phonology, Bevington, Halle, fonem.

Hyrja

Në këtë punim do t'u japim përgjigje të hollësishme pyetjeve që lidhen me tiparet fonetike dhe tiparet fonologjike, duke shpjeguar natyrën e secilit grup dhe ndryshimet mes tyre; dallimet mes autorëve në klasifikimet nyjetimore të bashkëtingëlloreve; gabimet e autorëve në klasifikimin e fonemave skajore; tiparet fonologjike të Trubeckoit dhe tiparet binare të Comski-Halles, duke shpjeguar dallimet mes tyre dhe cilat tipare janë më ekonomike; pse tipari [± e përparme] që mungon te Bevingtoni është i domosdoshëm për të karakterizuar sistemin vokalik dhe konsonantik të shqipes, si dhe pse për dallimin e anësoreve /l/ dhe /ll/ tipari [± e

prapme] është i domosdoshëm, kurse tipari [± e lartë] jo etj.

Tiparet *fonetike* janë tipare që lidhen me autonominë dhe fiziologjinë e aparatit të të folurit, duke dalluar pjesët e këtij aparati që duhen për të prodhuar tingujt, si: mushkrittë, faringu, tehzat e zërit, uvula etj. *Së dyti*, tiparet fonetike lidhen me aparatën e perceptimit të tingujve, që nga veshi e deri te sistemi nervor qendror. Tiparet fonetike janë tipare të *planit të shprehjes* në gjuhë, që do të thotë janë tipare të perceptueshme lehtë nga shqisat tona.

Ndër tiparet fonetike, hyjnë edhe ato tipare që kanë të bëjnë me cilësitë akustike të tingujve, si: lartësia, fortësia, që i studion fonetika akustike, e

cila është një degë e fonetikës. Fonetika përdor induksionin si mënyrë të arsytimit dhe të argumentimit të fakteve fonetike. Ndër tiparet fonetike janë: vendi i formimit, mënyra e formimit etj.

Fonologjia, në ndryshim nga fonetika, është një shkencë më abstrakte. Tiparet fonologjike janë tipare që kanë të bëjnë me ndarjen e tingujve në klasa e nënklasa duke u mbështetur në tiparet dalluese. Në përcaktimin e tipareve fonologjike është i nevojshëm një *absrtaksion* i një shkalle më të lartë. Fonologjia përdor deduksionin si një mënyrë të arsytimit dhe të argumentimit të fakteve fonologjike. Ndër tiparet fonologjike janë: ndarja e tingujve në zanore/bashkëtingëllore, të tingulltë, të zëshëm etj.

Dallimet mes autorëve në klasifikimet nyjëtimore të bashkëtingëlloreve

Me klasifikimin e bashkëtingëlloreve të shqipes, i pari që është marrë është S. Frashëri. Pastaj janë marrë Lowman, por pa na dhënë ndonjë skemë klasifikimi të fonemave tona, K. Cipoja, A. Dodi, J. Gjinari, B. Beci etj.

Por, sigurisht, në klasifikimet që i kanë bërë bashkëtingëlloreve të shqipes këta autorë ka dallime. Duke vërejtur këto klasifikime në literaturën e shfrytëzuar, mbërrijmë në përfundimin se:

Së pari, Lowman dhe Beci ndjekin vetëm kriterin e vendit të formimit;

Së dyti, Cipoja i jep rëndësi kryesore vendit të formimit, kurse organin aktiv e quan ndihmës;

Së treti, Gjinari dhe Dodi i japin rëndësi kryesore organit aktiv, duke marrë si dytësor atë të vendit të formimit;

Së katërti, të gjithë autorët njohin klasifikimin e dybuzoreve (Beci i quan thjesht buzore); buzore-dhëmboret, ndër dhëmboret, alveolaret (Cipoja i quan thjesht dentale), alveolaret, alveopalatalet, pastaj qiellzoret (Dodi dhe Gjinari i quajnë mesgjuhore); velaret (Beci i quan grykore, kurse Dodi dhe Gjinari i quajnë paragjuhore. Vendet e nyjëtimit të Lowman janë të njëjta me ato të Cipos, me dallimin e vetëm që Lowman flet për alveoqiellzore dhe qiellzore-alveolare, njeh edhe klasën e laringaleve, që te Cipo mungon. B. Beci

dhe A. Dodi e njohin glotën si vend formimi, kurse Gjinari njeh si klasë faringalet, por jo glotalet.

Përsa u përket tingujve të tjerë, nga sa vërehet në klasifikime, ka dallime të shumta, të cilat do t'i bëjmë objekt studimi të një punimi të mëvonshëm.

Tiparet fonologjike të Trubeckoit dhe tiparet binare të Comski-Halles: dallimet midis tyre dhe tiparet më ekonomike

Trubeckoi, i cili njihet si babai i fonologjisë, nxori tiparet fonologjike për të klasifikuar sistemet fonemore të gjuhëve të ndryshme të botës. Sistemi i tipareve të propozuara nga ai është një sistem i cili nuk mund të përshkruajë të gjitha sistemet fonemore të gjuhëve të botës, por është edhe një sistem jo shumë ekonomik.

Çomski-Halle, në ndryshim nga sistemi i Trubeckoit, propozuan një sistem tiparesh të bazuar në kundërveniet dyshe. Ky sistem ka disa përparësi:

Së pari, përmban tipare akustike që mungojnë te Trubeckoi.

Së dyti, është një sistem më i pasur në tipare, sepse ka 24 çifte, që e bën të vlefshëm për të gjitha gjuhët.

Së treti, është më ekonomik, sepse për të bërë dallimin midis një kundërvënije nevojiten më pak tipare. P.sh: për dallimin e kundërvënies /i/-/y/ te Trubeckoi duhen katër tipare (e përparme, e mbyllur, buzore, jobuzore) /i/- e përparme, e mbyllur, jobuzore; /y/- e përparme, e mbyllur, buzore. Ndërsa te Çomski duhen tri tipare (± e prapme, ± e larte, ± buzore): /i/ ± e larte, - e prapme, - buzore; /y/- + e larte, -e prapme, +buzore.

Pse tipari [± e përparme] që mungon te Bevingtoni është i domosdoshëm për të karakterizuar sistemin vokalik dhe konsonantik të shqipes?

Tipari [± e përparme] që mungon te sistemi i tipareve të Bevingtonit është i domosdoshëm për karakterizimin e sistemit vokalik dhe konsonantik të shqipes, sepse ky sistem ka fonema të radhës së përzierë, të cilat nuk janë as të

përparme dhe as të prapme. Të tilla janë fonemat: /e/, /l/, /r/, /rr/, /sh/, /zh/, /c/, /xh/, /q/, /gj/, /nj/ dhe /j/, të cilat cilësohen [- të përparme dhe – të prapme]. Bevingtoni, zanoren /ë/ e cileson [+ të prapme], kurse bashkëtingëlloret [- të prapme], por duke e cilësuar /ë/-në të prapme ai gabon, pasi ajo është e radhës së përzierë, ndërsa duke i cilësuar bashkëtingëlloret e mësipërme [- të prapme] ai nuk i përcakton ato nëse janë të radhës së përzierë apo të përparme.

Pse për dallimin e anësoreve /l/ dhe /ll/ tipari [± e prapme] është i domosdoshëm, kurse tipari [± e lartë] jo?

Tipari [± e prapme] është i domosdoshëm për të karakterizuar anësoret /l/ dhe /ll/ pasi dallimi midis këtyre fonemave qëndron në velarizimin që pëson fonema /ll/. Në nyjetimin e fonemës /ll/ vërehet një ngritje e pjesës së prapme të gjuhës drejt qiellzës së butë. Ky lloj nyjetimi quhet velarizim. Meqenëse kjo fonemë nyjtohet në këtë mënyrë, atëherë tipari [± e prapme] është tipari i domosdoshëm për të bërë dallimin midis këtyre dy fonemave.

Ndërsa tipari [± e lartë] nuk është i domosdoshëm për vetë faktin se ne mund të nyjetojmë një /ll/ dhëmbore, alveo-dhëmbore dhe alveolare, po ashtu edhe një /l/ në variant dhëmbor dhe një /l/ në variant alveolar. Duke qenë se ky tipar nuk e bën si duhet dallimin midis dy tingujve anësorë të shqipes /l/ dhe /ll/, nuk është i domosdoshëm.

Fonemat e bërthamës së sistemit konsonantik të së folmes sime

Fonemat e bërthamës së sistemit konsonantik të së folmes sime që i përket Toskërishtes Veriore, përputhen me atë të shqipes standarde, por duke e krahasuar këtë sistem me atë të gjuhës mëmë indoeuropiane:

h h h h
b d g gw
b d g gw
p t k kw

vërejmë se sistemi i gjuhës mëmë, në *radhë të parë* ka më pak fonema konsonantike nga ai i së folmes sime. *Së dyti*, seria e parë e gjuhës mëmë është ajo e mbylltoreve të zëshme të frymëtuara,

ndërsa në të folmen time është seria e mbylltoreve të zëshme jo të frymëtuara. Sistemi konsonantik i gjuhës mëmë ka tri radhë dhe tri seri fonologjike, kurse sistemi i të folmes sime ka gjashtë radhë dhe pesë seri fonologjike.

Po ta krahasojmë sitemin e gjuhës mëmë indoeuropiane me sistemin e greqishtes së vjetër:

p t k
p t k
b d g

do të vërejmë disa ndryshime: nëse seria e parë të gjuha mëmë indoeuropiane është seria e mbylltoreve të zëshme të frymëtuara, të greqishtja e vjetër është seria e mbylltoreve të pazëshme të frymëtuara.

Një tjetër ndryshim është të radhët fonologjike. Në qoftë se greqishtja e vjetër ka tri radhë fonologjike, gjuha mëmë ka katër radhë fonologjike, një më tepër.

Duket në fakt sikur kemi një ndërrim të serive fonologjike. Kështu seria e tretë fonologjike e gjuhës mëmë është seria e dytë e greqishtes së vjetër.

Përfundime

Tiparet *fonetike* janë tipare që lidhen me autonominë dhe fiziologjinë e aparatit të të folurit.

Me klasifikimin e bashkëtingëlloreve të shqipes janë marrë disa autorë, por në klasifikimet e tyre ka dallime. Këto dallime burojnë nga kriteret e klasifikimeve, që disa marrin një kriter e disa dy, duke u dhënë rëndësi të ndryshme, kriterëve të ndryshme.

Përsa u përket fonemave skajore, që nuk përfshihen në bërthamën e sistemit konsonantik, autorët nuk ndajnë mendime të njëjta. Kjo për shkak se u japin rëndësi edhe tipareve që nuk janë të rëndësishme për të bërë klasifikimin.

Tipari [± e prapme] është i domosdoshëm për të karakterizuar anësoret /l/ dhe /ll/, pasi dallimi midis këtyre fonemave qëndron në velarizimin që pëson fonema /ll/.

Tipari [± e përparme] që mungon te sistemi i tipareve të Bevingtonit është i domosdoshëm për karakterizimin e sistemit vokalik dhe konsonantik të shqipes, sepse ky sistem ka fonema të

radhës së përzierë të cilat nuk janë as të përparme dhe as të prapme.

Sistemi i gjuhës mëmë ka më pak fonema konsonantike nga ai i së folmes sime. Seria e parë e gjuhës mëmë është ajo e mbylltoreve të zëshme të frymëtuara, ndërsa në të folmen time është seria e mbylltoreve të zëshme jo të frymtuara. Sistemi konsonantik i gjuhës mëmë ka tri radhë dhe tri seri fonologjike, kurse sistemi i të folmes sime ka gjashtë radhë dhe pesë seri fonologjike.

Duke krahasuar sistemin e gjuhës mëmë indoevropiane me sistemin e greqishtes së vjetër vërehet se: nëse seria e parë të gjuha mëmë indoevropiane është seria e mbylltoreve të zëshme të frymëtuara, të greqishtja e vjetër është seria e mbylltoreve të pazëshme të frymëtuara. Një tjetër ndryshim është të radhët fonologjike. Në qoftë se greqishtja e vjetër ka tri radhë fonologjike, gjuha mëmë ka katër radhë fonologjike, një më tepër. Kemi një ndërrim të serive fonologjike. Kështu seria e tretë fonologjike e gjuhës mëmë është seria e dytë e greqishtes së vjetër.

Bibliografia

BECI, B. (1982), Mbi disa veçori fonetike të të folmeve të gjuhës shqipe në përfaqje me gjuhën letrare, *Studime Filologjike*, nr. 4.

BECI, B. (1985), Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike, *Studime Filologjike*, Tiranë, nr. 1.

CIPO, K. (), *Gramatika shqipe*, Tiranë.

DODI, A. (1992), Shqipja standarde në aspektin fonologjik, *Gjuha jonë*, Tiranë, nr. 1-2.

DODI, A. (2005), *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*.

FRASHËRI, S. (1988), Shkronjëto e gjuhës shqipe, *Vepra II*, Tiranë.

GJINARI J. (1989), *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë.

ISMAJLI, R. (1973), Fonemat marginale të sistemit bashkëtingëllor të shqipes, *Përparimi*, Prishtinë, nr. 5.

ISMAJLI, R. (1983), Ndërlidhëri kundërvëniesh të sistemit bashkëtingëllor të shqipes, *Përparimi*, Prishtinë, nr. 1.

LOWMAN, G. S. (1932), The phonetics of Albanian, *Language*, vol. VIII.

MEMUSHAJ, R. (2006), Fonetikë e shqipes standarde (Maket), Tiranë.

MEMUSHAJ, R. (2006), *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë.

MEMUSHAJ, R. (përgatiti), *Fonetikë*, Dispencë e lëndës.

MEMUSHAJ, R. (përgatiti), *Fonologji*, Dispencë e lëndës.

GJAKOVA DHE SHKODRA NË KONFERENCËN E AMBASADORËVE NË LONDËR, 1913 GJAKOVA AND SHKODRA AMBASSADORS CONFERENCE IN LONDON, 1913

SHEFQET DINAJ

Student i doktoraturës në Q.S.A Tiranë

Email: shefqetdinaj@gmail.com

Përmbledhje

Artikulli im është fokusuar në zhvillimin e negociatave diplomatike të Fuqive të Mëdha në nivel ambasadorësh, e pikërisht në "Gjakova dhe Shkodra në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, 1913". Në artikull shpaloset këmbëngulësia e Rusisë që Shkodra ose Gjakova t'u jepej sllavëve. Përkundër saj, Ambasadori anglez Eduard Grej doli hapur kundër lakmisë sllave. Britania dhe Gjermania mbanin qëndrim indiferent për fatet e trojeve të Shqipërisë Veriore. Austria ishte plotësisht e bindur se Shkodra duhet t'i takoj Shqipërisë, por duke dëshiruar që mos të vjen deri te dështimi i Konferencës së Ambasadorëve për shkak të kundërshtisë së fortë ruse dhe indiferencës së Britanisë dhe Gjermanisë, u detyrua të bëjë mjaft lëshime derisa më në fund Rusia ra dakord që Shkodra të përfshihej në Shqipëri. Austria mendonte se edhe qyteti i Gjakovës duhet t'i takoj Shqipërisë, Rusia kërkonte që Gjakova t'i takoj Serbisë. Për javë të tëra paqja e Evropës varej nga fati i Gjakovës. Për tematikën që unë trajtoj, sillen prurjet e deritanishme të literaturës historike, si dhe burimet e botuara si: "British Documents on the origins of the war (1898-1914), vol.IX part II, d. nr. 403, "Raportet e Mensdorff-it, dt. 17.12 e 18.12.1912, OUA përkatësisht nr. 4944", Emile Salai,- Les documents secrets publiques par les Bolshheviks", Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912-1913 (Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë- Tiranë) etj.

Fjalë çelës: Shkodra, Gjakova, Konferenca e Ambasadorëve, Britania, Rusia

Summary

My article is focused on the development of diplomatic negotiations of the Great Powers at the ambassadorial level, namely in "Gjakova and Shkodra Ambassadors Conference in London, 1913". The article disclosed that Shkodra Russian assertiveness or Gjakova be given Slavs. Despite its British Ambassador Edward Grey Slav came out against greed. Britain and Germany wore indifferent to the fate of the territories of Northern Albania. Austria was fully convinced that Shkodra, Albania must meet, but not wishing to come to the failure of the Conference of Ambassadors of controversy because of strong Russian and indifference of Britain and Germany, was forced to make concessions until quite more Russia finally agreed to be included in Shkodra Albania. Austria argued that the city of Gjakova must meet Albania, Russia demanded that Djakovica to meet Serbia. For weeks, the peace of Europe depended on the fate of Gjakova. For topics that I deal with, current flows behave historical literature, as well as published sources: "British Documents on the Origins of the War (1898-1914), vol.IX Part II, d. nr. 403, "it reports Mensdorff-dated. 18/12/1912 17:12's, respectively Ouâ no. 4944 ", Emile Salai - Les secrets lic par les documents Bolshheviks", British Documents on the Albanian question in the Conference of Ambassadors in London from 1912 to 1913 (Albanological Studies Center, Institute of Tirana history teaching, etc.).

Key words: Shkodra, Gjakova, the Conference of Ambassadors, Britain, Russia

Misioni i parë diplomatik i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës ishte kërkesa e dërguar Portës së Lar-të, Fuqive të Mëdha dhe shteteve fqj-një ballkanikë për njohjen e pavarë-sisë së

Shqipërisë. Atëkohë Lufta e Pa-rë Ballkanike kishte vetëm një muaj që kishte filluar dhe Ballkani ishte për-f-shirë nga flakët, kësioj qeveritë e shte-teve anëtare të Koncertit

Evro-pian e panë opurtune të heshtnin për mo-mentin. Ndërsa qeveria turke e prekur drejtpërdrejt nga kërkesa shqi-p-tare, e kundërshtoi shkëputjen e te-rr-i-toreve shqiptare nga Perandoria Oto--mane” (Puto 2008: 38)

Fuqitë e Mëdha dhe Shqipëria

Kur më 3 dhjetor 1912, në kon-fe-re-ncën e mbledhur në Pallatin Saint Ja-mes [Shën Xhejms], u nënshkrua armë-pushimi ndërmjet Turqisë dhe shte-teve ballkanike [Bullgarisë, Gre-qi-së, Serbisë, Malit të Zi], Fuqitë e Më-dha vendosen të mblidhen në nivel amba-sadorësh dhe të rregullojnë çë-sh-tjet e pazgjdhura të Ballkanit, ku kryçështja do të ishte Shqipëria. Siç dihet, punimet e Konferencës ndërko-m-bëtare të Londrës i drejtoi ministri i Jashtëm i vendit mikpritës, pra i Bri-ta-nisë së Madhe, Edward Grey [Eduard Grei]. Diskutimet për Shqipërinë u fo-ku-suan në tri çështje: statusin ndërko-m-bëtar të Shqipërisë, organizimin e mbrendshëm të shtetit të ri shqiptar, dhe vendosjen e kufijve të Shqi-pë-ri-së” (Vickerc 2008: 115).

Ndërsa Konferenca e Ambasado-rë-ve në Londër vazhdonte punimet, më 30 maj 1913 shtetet ballkanike përfunduan me Turqinë Traktatin e Paqes. Sipas këtij traktati, “kufijt e Shqipërisë, si dhe çdo çështje tjetër që kishte të bënte me Shqipërinë, li-hej në dorë të Fuqive të Më-dha”, (sipas traktatit të Paqes të nënshkruar midis Turqisë dhe vendeve ballkanike, Turqia hiqte dorë nga territoret në perëndim të vijës Enos (në detin Egje). Midia [në detin e Zi], çështja e kufijve të Shqipërisë, si dhe çdo çësh-t-je tjetër që kishte të bënte me Shqi-pë-rinë, lihej në dorë të Fuqive të Mëdha.” (Schevil 2002: 286). Megji-tha-të në Konferencën e Londrës u pa qartë se klientelizmi ballkanik kishte depërtuar në shtetet anëtarë të “Kon-ce-rtit Evropian”, duke i bërë ata jo aq të njësuar e të harmonizuar në ven-di-met e tyre. Mirëpo, parimi i kom-p-ro-misit që rregullonte marrëdhëniet bre--nda Koncertit Evropian, ndihmoi të kapërcehej ngërçi. Në saje të impo-nimeve dhe lëshimeve reciproke ndë-r-mjet Austro-

Hungarisë dhe Italisë, nga një anë dhe Ruisë, nga ana tje-tër, ku sipas rastit u përfshinë dhe Fra-nca, Anglia e Gjermania u arrit që Shqipëria të njihej si një shtet Sovran [nënkuptohej pavarësia]” (Historia 2007: 217). Më 29 korrik 1913, Konferenca e Ambasadorëve e Londrës mori vendim, sipas të cilit Shqi-pë-ria njihej si “Principatë auto-nome, so-v-rane dhe e trashëgueshme, asnja-në-se nën kontrollin e garancinë” e Fu-qive të Mëdha.

Qëndrimet dhe vendimet e Kon-fe-re-n-cës së Londrës lidhur me Gjakovën e Shkodrën Për efekt të kohës së kufizuar dhe në respekt të objektivit kryesor të kumtesës time, unë do të fokusohem në qëndrimet e vendimet e konfe-re-n-cës së Londrës lidhur me Gjakovën e Shkodrën. Që në mbledhjen e parë të Konferencës së Ambasadorëve, me 17 dhjetor 1912, u vendos që Shqipëria autonome do të kufizohet në veri me Malin e Zi dhe në jug me Greqinë. Se-r-bia u përjashtua nga mundësia që të ketë dalje në Detin Adriatik. Edhe ide-ja që Serbia të kishte mundësi për një dalje tregtare në det nëpërmjet një skele shqiptare “të lirë dhe të neut-ra-li-zuar” mbeti vetëm në letër për shkak të pamundësisë praktike të saj. (Puto 2008: 48-49).

Në ditët e mëpasme të konfe-re-n-cës u paraqitën dy projekte për Shqipërinë, nga Austrohungaria dhe nga Rusia. Projekti që ambasadori aus-tro-hungarez në Londër, Albert Me-nsdorf, paraqiti në konferencë pë-r-fshinte një pjesë të mirë të trojeve shqiptare në Veri, ndër të cilat edhe Pe-jën, Gjakovën, Prizrenin, Dibrën, Oh-rin etj.” (Historia 2007: 22)

Ndërsa projekti që paraqiti amba-sa-dori rus në Londër, Alexander Ben-c-ke-ndorf, parashikonte një copëtim të madh të tokave shqiptare. Sipas tij vi-ja kufitare në Veri dhe në lindje të Shqipërisë do të ishte lumi i Drinit dhe Drini i Zi.” (Historia 2007: 23). Sigu-risht ky projekt ishte në mbështetje të platforms serbe.

Çështja e kufijve kishte nxjerrë kë--shtu në plan të parë përcaktimin e kri-tereve që do të shërbenin si bazë për një zgjidhje të drejtë të çështjes. Gja-të tre muajve të parë të vitit 1913,

di-skutimet u përqendruan në kufijtë ve-rilindorë të Shqipërisë. Si zëdhënës të qeverive të tyre, ambasadorët ki-shin këndvështrime me njëri tjetrin, gjë që e tensionoi situatën në kon-ferencë.

Ambasadori i Austro-Hungarisë, Me-nsdorff paraqiti pikëpamjen e qe-ve-risë së tij se “asnjë territor i banuar kre-jtësisht nga shqiptarët nuk duhej të shpëtohet nga Shqipëria e ardh-sh-me autonome” (Raportet: 1912, nr. 4944). Sipas kësaj shihet qartë se Vje-na ishte gati të bënte lëshime të te-rrri-to-reve shqiptare aty ku kishte ndonjë grup etnik të kombësive tjera.

Por ambasadori i Rosisë, Bencke-n-dorf, nuk u kënaq me kaq. Ai mbë-sh-te-tej në fitoren e Aleatëve Ballkanikë ndaj Perandorisë Osmane, prandaj kë-r-konte maksimumin për shtetet sllave të jugut. Ambasadori rus përpjeq ta kufizonte sa më shumë rolin ndër-m-je-tës të Konferencës së Ambasadorëve në procesin e caktimit të kufijve ndër-r-m-jet Shqipërisë dhe shteteve fqinje. Pra-ndaj ambasadori austro-hungarez Me-nsdorff deklaroi në konferencë se, që-ndrimi i Rosisë ishte një “ndërhyrje në bisedimet që po zhvilloheshin mi-dis Malit të Zi dhe Turqisë” për kufirin verior (Raportet 1912, nr. 4944). Gji-tha-shtu ambasadori austro-hungarez kun-dërshtoi dhe deklaratat e qeverisë serbe se rëndësia e “Gjakovës është ese-nciale si kufi strategjik për Ser-bi-në” (British 1898-1914, 554). Ai kërkoi që ushtria serbe duhej të largohej me-një-herë nga Gjakova dhe Shkodra, sep-se me operacionet e saj në Shqi-pë-rinë e Veriut, Serbia “po sfidonte vu-llnetin e Fuqive të Mëdha” (British: 564).

Sipas kryeministrit serb, Pashiq, Se-rbia ka për detyrë ta mbrojë Malin e Zi (British: 681-682), dhe se ope-ra-ci-o-net ushtarake të Serbisë ndaj Shko-d-rës janë pjesë e luftës kundër Turqisë (Br-itish: 573). Por pavarësisht nga kë-to mesazhe, në mars të vitit 1913, statistikat e paraqitura në konferencë për masakrat e ushtrisë serbe e ma-la-ze-ze mbi popullsinë civile shqiptare, flisnin jo për çlirim të Shkodrës, por për pushtim të saj. Për rrjedhojë, në pjesën e dytë të marsit, Fuqitë e Më-dha gjithnjë e më

shumë bënin pre-sion mbi Serbinë e Malin e Zi, duke u bërë të ditur atyre se Shkodra në as-një mënyrë nuk mund t'i jepej Malit të Zi. Në këto rrethana Serbia për-pi-qej që të zgjidhte sa më parë çështjen e Gjakovës dhe të rrethinës së saj. Pa-shi-qi gjithnjë e më shpesh theksonte se zvaritja e problemit të Gjakovës e ko-mplikonte çështjen e Shkodrës” (Bajraktari 1878-1912: 301) Më në fund Beogradi e kuptoi se du-het të respektohet vendimi i Fuqive të mëdha që Shkodra t'i mbetet Shqi-pë-risë. Lidhur me këtë, Petri I Kara-gjo-rgjevic, mbreti i Serbisë, i shkrua-n-te mbreti Nikolla të Malit të Zi se tanimë “ne duhet t'i nënshtrohemi kë-r-kesës së Fuqive të Mëdha dhe të ngre-më duart lart rreth mbrojtjes së Shko-drës, ashtu siç kemi qenë të de-ty-ruar të heqim dorë nga dalja në Detin Adriatik” (Sekuliq 1980: 199).

Në vijim, Kral Nikolla, i pikëlluar, i dërgoi Carit të Rosisë një mesazh pe-r-so-nal ku i thoshte: “Zemra e madhe slla-ve e madhnis Tuej do të jetë kre-nue me triumfet e ushtarve të mij, por duket se Madhnija e juej duhet të ma-rri vendime, të cilat janë kundër in-te-resave ma të shenjta të vendit tem. Madhnija e juaj ka nënshkrue një ma-rrë-veshje qi len Shkodrën brenda ku-fi-j-ve të Shqipnis” (Solaj, 69).

Ministri i Jashtëm anglez Eduard Grej doli hapur kundër lakmisë sllave, kur Rusia nguli këmbë që Shkodra ose Gjakova t'i jepeshin Serbisë. E atë-ko-hë, Gjakova ishte një qytet me dy-tre mijë shtëpi dhe nuk kishte më tepër se njëqind familje serbe dhe asnjë fshat serb përreth (Durham 1990, 319). Po ndërsa për Shkodrën u arrit që të bindej qeveria serbe të tërhiqte tru-pat ushtarake, çështja e Gjakovës për javë të tëra, mbeti pezull në ta-vo-li-nat e diplomatëve të lartë të Kon-fe-re-ncës së Londrës, duke rrezikuar pa-qen e Evropës (Kontos 1981: 5).

Ndërkohë, qeveria bitanike dhe ajo gjermane nuk patën të njëjtin mi-rë-kuptim dhe interesim për fatet e tro-jeve të Shqipërisë veriore. Kjo më së miri kuptohet nga letra e zëvendës se-kretarit të përhershëm të shtetit për punë të Jashtme Sir Artur Niko-l-son [Arthur Nicolson], dërguar amba-sa-dorit britanik në Shën Peterburg, në të

cilën ai shkruan: "Jam plotësisht da-kord me ju kur thoni se çështja e Shkodrës do të bëhet problematike. Po të flasim hapur, logjikisht nuk ka dyshim se ajo i përket Shqipërisë, por Rusia këmbëngul së tepërmi që ajo (Shkodra) t'i jepet Malit të Zi dhe ne duhet ta mbështesim në këtë pikë. Si-pas mendimit tim për këtë çështje, po të shprehem me egoizëm, për ne do të jetë më mire të rrimë indiferent për çështjen se kush do të jetë zo-të-rues i Shkodrës, por ajo është e një rendësie të madhe, kështu që ne du-het të mbajmë një qëndrim që në as-një mënyrë të mos dobësojë apo të pri-shë mirëkuptimin tonë me Rusinë (Vickers 1979: 83).

Përfundimi

Më 22 mars 1913, Konferenca e Amba-sadorëve në Londër përfundoi di-skutimet dhe mori vendim mbi vijën e kufirit verior dhe verilindor të Shqi-pë-ri-së. Në kundërshtim me parimin e kombësisë dhe pa marrë parasysh vu-ll-netin e popullsisë shqiptare, nga te-rr-i-tori shtetëror shqiptar nuk u shkë-put ve-tëm Gjakova, por krahina të tëra si Kosova, Rrafshi i Dukagjinit, dhe toka shqiptare e pjesës perë-n-di-mo-re të Maqedonisë. Këto vise ka-lo-nin nga sundimi osman në atë serb e malazez.

Tetë vjet më vonë, në korrik të vitit 1921, anëtari i Këshillit Kombëtar, pa-trioti Luigj Gurakuqi do t'u shprehej me dhimbje kolegëve të tij: "Na kanë marrë qytetet dhe na kanë lënë Ma-lë-si-në, kanë marrë Dibrenë e kanë lënë ma-lësinë, na kanë marrë Prizrenin dhe na kanë lënë malësinë, na kanë ma-rrë Gjakovën e na kanë lënë Ma-lë-si-në, e kështu që shëmbëllejmë me një trup pa kokë. Shteti shqiptar që mbeti pas vendimeve të marsit dhe të gushtit 1913 ishte 28 mijë km² me një po-pullsi rreth 740 mijë banorë. Një shtet i dobët që ndër vite do të për-ba-llej me pamjaftushmërinë e burimeve mbi-tokësore e nëntokësore për të plo--tësuar nevojat e shtetasve të vet.

Bibliografia

Dokumente të publikuara

BRITISH documents on dhe origins of dhe war (1818-1914), vol, IX part II, d. nr. 403

RAPORTET e Mensdorff-it dt. 17. 12. 1912, OUA, përkatësisht nr. 4944.

EMILE Solai, Les documents secrets publies par les Bolsheviks.

SHATRI, Muhamet.[2012], Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Kon-fe-rencën e Ambasadorëve në Londër, Qendra e Studimeve Alba-nologjike, Instituti i Historisë-Tiranë.

Literaturë

BAJRAKTARI, Jusuf [1998], Gjakova me rrethinë në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX (1878-1912), Prishtinë.

CASTELAN, Georges [1991], Historia e Ballkanit, Çabej Tiranë.

CRAMTON, Richard [1979], The hollow Détente, Anglo-German Relations in the Balkans 1911-14, London.

DURHAM , Edit [1990], Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët, Tiranë.

HISTORIA e Popullit Shqiptar III [2007], Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

HISTORIA e Shqipërisë [1984], Tiranë.

KONTOS, Joan F. [1981], Red Cross Black Eagle, A Biografy of the Albanian-American School, New York.

NOSI, Lef [2007], Dokumentet historike 1912-1918, Instituti i Historisë i Tiranës, Tiranë.

PUTO, Arben [2008], Pavarësia e Shqipërisë në Tryezat e Diplomacisë, ËESO, Tiranë.

PUTO, Arben [1978], Pavarësia e Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914, Mihal Duri, Tiranë.

SCHEVILL, Milovan [2002], Ballkani-historia dhe qytetërimi, Uegen, Tiranë.

SEKULIQ, Milovan (1980), Kosovo od 1912-1918 godine. Tezë doktorate e mbrojtur në Fakultetin Filozofik në Prishtinë.

VICKERS, Miranda [1998], Histori e Shqipnis, Phoenix, Tiranë.

METAFORAT E GJUHËS SË FUTBOLLIT THE METAPHORS OF THE LANGUAGE OF FOOTBALL

LEONARD XHAMANI

Departamenti i Gjuhës Italiane, Universiteti i Tiranës
e-mail: leonardxhamani@gmail.com

Përmbledhje

Ndër gjuhët e specialitetit mund të rendisim edhe gjuhën e sportit. Ajo zotërohet nga një rreth i ngushtë njerëzish, të cilët e përdorin për të plotësuar nevojat komunikuese të sektorit të tyre të specializuar. Në gjuhën e sportit kemi disa nëngjuhë, ndër të cilat shumë e veçantë është ajo e futbollit, e cila qëndron mes gjuhës së specialitetit dhe zhargonit. Gjuha e futbollit është e përfshirë në disiplina të ndryshme, prandaj edhe studimi i saj do të kërkonte një qasje metodologjike heterogjene. Në pamundësi për të sjellë një studim kaq të gjerë, në këtë kumtesë do të ndalemi te një aspekt i veçantë i gjuhës së futbollit dhe pikërisht te metaforat. Do të marrim në analizë llojet e ndryshme të metaforave që përdoren në gjuhën e specializuar të futbollit dhe në zhargonin e futbollit, metaforat e kronikave sportive, metaforat e gjuhës së fansave, metaforat e gjuhës së përditshme etj.

Fjalët çelës: gjuhë specialiteti, gjuha e futbollit, metafora, zhargon.

Summary

In the group of specialty languages, we can also include the language of sport. It is possessed by a very small number of people, who use it to meet the communicative needs in their specialized department. The language of sport has some sub-languages, among which is that of football, a very peculiar one, which occupies a medial position between the specialty and slang language. The language of football is included in different disciplines, therefore, its study would require a heterogeneous methodological approach. Unable to bring such a wide study in this discourse we will focus on a special aspect of the language of football, precisely on metaphors. We will analyze different types of metaphors, which are used in the specialized language of football and the slang of football, the metaphors of sports chronicles, the metaphors of fans' language, the metaphors of everyday language etc.

Keywords: language of specialty, language of football, metaphor.

1. Hyrje

Ndër gjuhët e specialitetit mund të rendisim edhe gjuhën e sportit. Në gjuhën e sportit dallojmë disa nëngjuhë, ndër të cilat shumë e veçantë është ajo e futbollit, e cila qëndron mes gjuhës së specialitetit dhe zhargonit. Në këtë kumtesë do të ndalemi te një aspekt i veçantë i gjuhës së futbollit dhe pikërisht te metaforat. Metaforat janë thelbësore në këtë gjuhë, por edhe në atë të sportit në përgjithësi. Do të marrim në analizë llojet e ndryshme të metaforave që përdoren në gjuhën e specializuar të futbollit dhe në zhargonin e futbollit, metaforat e kronikave sportive, metaforat e gjuhës së fansave si dhe metaforat e

gjuhës së futbollit të cilat kanë hyrë në gjuhën e përditshme.

2. Gjuha e futbollit si gjuhë specialiteti

Me gjuhë specialiteti, duke u bazuar te përkufizimi i Cortelazzo-s (Cortelazzo 1994: 8), do të kuptojmë një variant funksional të një gjuhe natyrore, që varet nga një sektor njohurish apo nga një sferë e specializuar aktiviteti dhe që përdoret nga një grup folësish më i vogël në numër sesa tërësia e folësve të kësaj gjuhe, për të plotësuar nevojat komunikuese të atij sektori të specializuar. Gjuhët e specialitetit dallohen nga një leksik i veçantë dhe nga tipare të përcaktuara morfosintaksore dhe tekstuale, për të dhënë një

instrument shprehjeje dhe komunikimi sa më të efektshëm. Sipas Balboni-t (Balboni 2000: 20, 24), gjuhët e specialitetit, u japin shkencëtarëve apo profesionistëve përkatësinë e një grupi specialistësh.

Në kuadrin e gjuhëve të specialitetit grupi më i madh përfaqësohet nga gjuhët tekniko-shkencore, apo ato të disiplinave dhe praktikave të veçanta si: fizika, matematika, kimia, mjekësia, informatika. Janë gjuhë specialiteti edhe ato të disiplinave si e drejta, ekonomia, sociologjia, gjuhësia, apo aktivitete si sporti, gjuetia, peshkimi, lundrimi.

Gjuha e specialitetit ka një leksik të përbërë nga fjalë të zakonshme dhe terma. Termi është një fjalë e cila ka vetëm një kuptim të përcaktuar në gjuhën në të cilën përdoret. Dallohet, pra, nga një fjalë e gjuhës së zakonshme, e cila mund të ketë më shumë se një kuptim.

Në terminologjinë e gjuhës së futbollit vihen re strukturat terminologjike. Kështu kemi formimin e një skeme e cila bazohet në strukturën hierarkike të termave që krijon një si lloj vazhdimësie apo strukturën e pemës së degëzuar ku një koncept shpjegon një tjetër.

p.sh. Skuadra

	lojtari	
mbrojtës	mesfushor	sulmues
	portier	

Në formimin e terminologjisë së futbollit padyshim që një rol të rëndësishëm luan edhe terminologjizimi i termave të gjuhës së zakonshme. Kështu p.sh termi *portier* në futboll ka hyrë padyshim nga gjuha e zakonshme ku portier ka kuptimin e përgjithshëm: *ai që rri si rojë te porta e një ndërmarreje etj.* (FGJSH). Në gjuhën e sportit është *lojtari që në lojën e futbollit, të hokeit etj. mbron portën e skuadrës së vet* (FGJSH). Një rol të rëndësishëm në terminologjinë e futbollit luajnë edhe huazimet. Futbollit është një lojë shumë e lashtë e praktikuar në një version loje të përafërt që në mijëvjeçarin e dytë para Krishtit në Kinë. Padyshim që në Shqipëri erdhi si një lojë e importuar, prandaj është e natyrshme që edhe shumë terma të jenë huazuar. Të tilla si: penallti, gol, korner, arbitër, dopietë, derby etj. Por ajo që bie në sy në gjuhën

e futbollit është përdorimi i metaforave për të cilat do të flasim më poshtë.

3. Metaforat në gjuhën e futbollit

Kush flet për futbollin herë e vonë do t'i drejtohet përdorimit të metaforave. Ai që dëgjon një bisedë futbollit duhet të kuptojë metaforat nëse dëshiron të marrë pjesë në diskutim dhe natyrisht që shumica dëshiron të marrë pjesë, sepse futbollit është i pranishëm në jetën e përditshme (Bogdal 2010: 26). Mund të themi se edhe ata që nuk e pëlqejnë futbollin nuk mund të shpëtojnë nga ndikimi i tij. Metaforat janë të pranishme në disa kategori tekstuale që janë të lidhura mes tyre. Duke qenë se bëhet fjalë për një gjuhë specialiteti duhet thënë se trasmetuesit e kronikave, tifozët, spektatorët nuk kanë shumë diferenca në nivelin e të kuptuarit dhe kjo lehtëson përdorimin e metaforave.

Zhargoni i futbollit ka situatat e veta dhe karakteristikat e veta në nivel komunikues dhe metaforik dhe shfaqet para së gjithash përmes gjuhës së folur. Kur sportistët komunikojnë mes tyre nuk përdorin gjithnjë një nomenklaturë të fiksuar, por shpikën shprehje të reja, ndonjëherë të stilit bisedor dhe të diktua nga emocioni dhe që shfaqen në rrethana të veçanta.

3.1 Metaforat në gjuhën speciale të futbollit

Në botë gjuha e futbollit u formua gjatë njëzetvjeçarit që parapriu luftën e parë botërore. Ngjarja sportive identifikohet, me ecurinë e një beteje në kamp. Kemi analogji të ndryshme mes lojës dhe luftës, prandaj shumë nga termat janë marrë nga fusha semantike e luftës. Shprehjet luftarake rezultojnë, pra, si një karakteristikë e gjuhës së sportit. Në fakt në futboll **kundërshtarët ndeshen** në një **betejë**. Në fushë **sulmojnë** apo **mbrojnë** me qëllimin që të **rrahin** apo të **mundin armikun**. **Mbrojtja** dhe **sulmi** formojnë **radhë** dhe shpesh **sulmohesh** dhe ekzistojnë **strategji** dhe **skema** të ndryshme pak a shumë si në luftë. Ka një **prapavijë**, skuadra mund të kalojë në **mësymje** me forca të shumta. Topi mund të lëshohet si një **silur** apo si një **predhë** etj. Nëse merret në konsideratë leksiku që përmban një libër mbi futbollin, ose një bisedë

mes kronistësh sportivë, mund të vihen re qindra shprehje që të kujtojnë botën ushtarake apo një buletin lufte. Pas konceptit të skemës ushtarake, pak a shumë tradicionale dhe antike që i referohet luftës, dhe më saktë luftës së pozicioneve dhe luftës në dy fronte (Kuster, Rainer).

Megjithatë duhet thënë se në gjuhën e futbollit ka edhe një sërë shprehjesh metaforike të cilat nuk i referohen domosdoshmërisht fushës semantike të luftës. Një analizë më e thelluar nxjerr në pah se metaforat në këtë gjuhë specialiteti kanë të bëjnë me një kuadër më të madh kategorish metaforike dhe, në disa raste, flitet për *katakrezën*, një figurë retorike që përdoret për të treguar diçka për të cilën gjuha nuk ofron një term të përcaktuar (<http://it.wikipedia/wiki/Catacresi>).

Janë gjithashtu të përhapura edhe metafora të cilat lidhen me konceptin e formuluar nga Lakoff dhe Johnson të "futbollit si teatër". Në fakt futbollistët quhen shpeshherë **aktorë** kur simulojnë në fushë. Arrigo Sacchi trajneri i kombëtares italiane thoshte: "*futbolli është një teatër ku ndonjëherë vihen në skenë drama të mëdha dhe ndonjëherë komedi të shkruara keq*". Në mesfushë është një **regjizor** i cili është përgjegjës për harmonizimin e lojës. Për faullet në kufi të zonës së rreptësisë arbitri jep goditje dënimi dhe mund të nxjerrë kartonin **e verdhë** apo **të kuq** i cili merr shtysë nga përdorimi i semaforit. Kemi gjithashtu edhe **solist**, lojtar që i vetëm drejton skuadrën. Gjejmë padyshim edhe metafora që i referohen zhargonit teknik si **fren emergjence** apo **motori i mesfushës**, apo fushës së muzikës si **dirigjenti**.

Ndonëse përgjithësisht termat e përdorur kanë një shpjegim të pranueshëm ka raste kur kemi edhe disa metafora të cilat nuk janë lehtësisht të shpjgueshme. Ata që përdorin këto shprehje në jetën e përditshme (sportistët, trajnerët etj.) nuk mbreti i Lindjes për Andri Shevçenkon; "Pinturichio" (Pikturor i famshëm italian) për Aleks del Pieron; "Cuore de Drago" (Zemërdragoi) për Paolo Maldinin; e deri tek "Il pulga" (Pleshti) për Lionel Mesin. Nofkat e sportistëve janë të shumta dhe intriguese, madje të paimagjinueshme për

që funksionon si një model për diferencimin e një leksiku të ndërlikuar futbollistik, gjendet një ide

e vënë re se po përdorin metafora. Nga ana tjetër ka persona të cilët nuk e njohin mirë këtë sport, ose i dëgjojnë këto metafora për herë të parë sepse po mësojnë të njohin gjuhën e futbollit.

Duhet thënë se pavarësisht larmisë së metaforave në gjuhën e futbollit ato që preferohen më shumë janë ato të lidhura me luftën apo ato që lidhen me botën e kafshëve. Kjo është e kuptueshme, sepse vetë struktura e kësaj loje të kujton një ndeshje lufte me linjat mbrojtëse dhe sulmuese.

3.2 Llojet e ndryshme të metaforave në zhargonin e futbollit (Nofkat)

Në ndryshim nga gjuhët e specialitetit, ajo e futbollit paraqet shprehje të zhargonit që nuk përfaqësojnë një gjuhë specialiteti në kuptimin e ngushtë të fjalës. Gjithashtu shumë terma nuk fokusohen në saktësinë terminologjike në përshkrimin e objekteve apo të situatave të veçanta, por në aspekte specifike të një grupi. Konotacionet në zhargon karakterizohen nga elementë emocionalë që mund të favorizojnë unitetin e një grupi, dhe terma të tillë bisedimorë shërbejnë edhe për të përjashtuar disa persona nga rrethi i brendshëm i këtij grupi. Prania e metaforave që lidhen me nofkat është shumë e përhapur. Duke filluar (Karaj 2008) që nga Pele e Maradona, tifozeria e marrosur pas numrave të tyre mundahej vazhdimisht të futej në karakterin e tyre duke i përshtatur nofken. Ca kjo për t'i ngritur sa më lart vlerat sportistit në fjalë, ca edhe për të thjeshtëzuar sa më shumë emrat e tyre. E ndërsa në vitet 60-70 nofkat zgjidheshin në përvijim të lojës dhe famës së këtyre sportistëve, në dekadën e fundit të shekullit 20-t tifozët zhbiruan edhe në jetën private duke nxjerr nga repertori nofka si "Zar d'orient" (Cari, nga fantazia me të cilën ata janë pagëzuar. Pseudonime të vendosura edhe rastësisht, por që kanë mbetur përjetësisht përkrah emrave të tyre të vërtetë. Lista e këtyre nofkave është e gjatë dhe në to ka emra kafshësh e insektesh, epitete të ndryshme që kanë të bëjnë me karakterin e

sportistit dhe cilësitë e tij. Ndër nofkat më karakteristike nuk ka se si të lëmë mënjanë “Duracell”. Në fakt ky është emri baterive të njohura të prodhuara nga kompania më të njëjtën emër me qendër në Nju Jork, por në botën e futbollit ai përbën “nofkën” e futbollistit çek Pavel Nedved. “Duracell” njihen si bateritë jetëgjata dhe krahasimi që i bëhet Nedved, një punëtori të palodhur të mesfushës dhe me një aftësi të jashtëzakonshme goditëse me të dy këmbët është shumë kuptimplotë. “O Rei” (Mbreti) është emri i Peles, futbollistit më të madh të botës, por dhe Pele është një nofkë, pasi emri i vërtetë i tri herë Kampionit të Botës është Edson Arantes do Nascimento. Me pseudonimin “Kaiser” (Perandori) njihet gjermani Franc Bekenbauer, kampion bote si futbollist dhe trajner.

Heroi i filmave të animuar “Batman” i atribuohet në botën e futbollit sulmuesit serb, ish-lojtarit të Partizanit të Beogradit, PSV Eindhoven dhe Çelsit, Mateja Kezhman. Sa herë që Kezhman shënonte në “Philips Stadion” për Eindhovenin një kolonë zanore nga filmi i animuar buçiste në mikrofonat e stadiumit që shoqërohej me thirrjet e tifozëve “Kezhman, Batman”, që rimonte edhe për shkak të mbaresës –“man”. Pseudonimi “The Animal” (Kafsha) është “pronësuar” nga futbollisti brazilian Edmundo Alves de Souza Neto (luajti për Brazilin në Kupën e Botës 1998), i njohur për temperamentin e tij krenar dhe të ashpër njëkohësisht, ku si pasojë ish-futbollisti i Palmeriars për shkak të ndërhyrjeve të tij ishte ndëshkuar më një numër të jashtëzakonshëm të kartonëve të kuq. Nofka “Doctor” (Doktor) i përket futbollistit brazilian Sokrates, i cili ishte edhe me profesion mjek (i diplomuar në fakultetin e mjekësisë Riberiaio Preto), por dhe kishte marrë gradën e doktorit në filozofi. Sokrates, një prej futbollistëve më të mirë mesfushor në historinë e futbollit, dallohej për inteligjencën e tij në fushën e lojës, por dhe të gjatësisë (192 cm), njihet për mjekrën e tij dhe në jetën e përditshme si një pirës i “rëndë” pijesh dhe duhani.

“God” (Zoti) është nofka e Alan Shirerit, futbollistit të njohur anglez të Njukasëllit, tashmë një prej

ekspertëve të futbollit të BBC-së. Futbollisti nga Kili, Ivan Zamorano, njihet në ambientet e ngushta dhe në gjirin e tifozëve me pseudonimin “The Helicopter” (Helikopteri). Zamorano njihet për festimet e tij kur vraponte në fushë duke tundur krahët në formën e një helikopteri. Johan Kruijff, futbollisti i madh holandez ka disa nofka dhe për ta dalluar nga Johan Neskens, një tjetër futbollist i shquar, thirrej “Johani I”. Ylli i Ajaksit njihet edhe me pseudonimin “El Salvador” (Shpëtimtari). “The Snake” (Gjarpri) i përket futbollistit të njohur francez Juri Xhorkaef, i cili kishte një aftësi të jashtëzakonshme të rrëshqiste midis lojtarëve kundërshtarë.

Kurrsesi nuk mund të shpëtonin as futbollistët shqiptarë pa nofka të tilla (Gazeta investigim 10 janar 2011). Bejzade kishte nofkën *Tigri*, Fortuzi i Tiranës thirrej nga tifozët *Zogu*, portieri legjendar Qemal Vogli mbiqhej *Macja e Zezë*. Lorik Cana thirret nga tifozët dhe media franceze si “Le Guerier” (Luftëtari); Altin Lala ka nofkën “xhuxhi luftarak”; Erjon Bogdani quhet ndryshe dhe “Princi i Epirit”; Florjan Myrtaj, për shkak të mënyrës së veçantë të festimit të golave, duke lëvizur flamurin e këndit sikur vozit një varkë, quhet “skafisti”; Hamdi Salihi ka marrë epitetin “Gerd Myleri shqiptar”; ndërsa Edvin Murati “Maradona i Ballkanit”. “Princi i Epirit” ju vendos Erjon Bogdanit në kohën kur ai luante me Veronën në Serinë B. Bogu shënoi 17 gola atë sezon dhe si shqiptar i vendosën këtë nofkë.

3.3 Metaforat në kronikat sportive

Planet e ndryshme të realitetit të gjuhës së futbollit dhe të metaforave përzihen me njëra-tjetrën. Kjo vlen sidomos nëse konsideron trasmetimin e asaj që ndodh në fushë për ata që dëgjojnë. Në këtë nivel komunikues përzihen komentet, bilancet dhe prodhimi i kësaj përzierje ndodh si njëkohësisht me ngjarjet sportive ashtu edhe me njëfarë shkëputje në retrospektivë (pas zhvillimit të ndeshjes). Vështirësia e kronikës së një ndeshje sporti qëndron pa dyshim në trasmetimin e ngjarjeve duke përdorur njëfarë stili.

Si në trasmetimet direkte ashtu edhe në kronikën shkruar (më shumë në këtë të fundit) gjuha e

futbollit karakterizohet nga prania e madhe e metaforave. Lakoff dhe Johnson mendojnë se metaforat nuk janë vetëm pjesë e shprehjeve tona gjuhësore, por mendime tonat në jetën e përditshme.

Të shohim disa shembuj nga kronika të ndryshme:

1. Superliga shqiptare *ka ngritur siparin* (Erjon Halili, Sporti shqiptar, 23 gusht 2014) në kuptimin ka filluar.
2. *“Ujqërit e dëborës”* duke iu referuar lojtarëve të Skënderbeut (Erjon Halili, Sporti shqiptar, 23 gusht 2014)
3. Shtubina ... *“hajmalia”* e Vllaznisë – (Gentjan Alinani & Nga Olsi Tujani, Në kërkim të bomberit, Sporti Shqiptar, 8 gusht 2014)
4. Kukësi *zhyt Vllazninë* dhe *“pushton” Shkodrën*. Pejiç sërish *“vrasës”* për kuqeblutë. (Panorama Sport, 25 gusht 2014)

3.4 Metaforat në gjuhën e fansave

Një tjetër nivel i botës së ndërlukuar të gjuhës së futbollit paraqitet në shprehjet dhe tekstet e metaforizuara të tifozave dhe spektatorëve. Në veçanti, gjatë zhvillimit të ndeshjes, nga ana e tifozerive kundërshtarë, shvillohet një praktikë komunikuese paralele me ndeshjen, por e ndryshme, e identifikueshme me një ndeshje verbale (Bogdal 2010: 32).

Sot flitet për fansa që në fushën e ndeshjes por edhe në stadione (në shtëpi dhe në trasfertë) identifikohen me skuadrën e tyre për ta çuar drejt suksesit, për të festuar fitoret, për ta ngushëlluar në rast humbesh dhe ndonjëherë për të fyer jo vetëm metaforikisht. Sharjet mund të shërbejnë për të diskredituar kundërshtarin, apo për ta bërë qesharak dhe ky debat verbal, në mijëvjeçarën e ri, natyrisht që nuk kufizohet vetëm në diskutimet në gazeta nga ana e lexuesve, por është zgjeruar falë teknologjisë. Në fakt në ditaret on-line, por edhe blogje, ngjarjet sportive komentohen ashtu si edhe në trasmetimet sportive direkte. Si të thuash shumë nga betejat sot zhvillohen përpara ekranit. Gjithsesi, kur të njëjtat fjalë tingëllojnë në një stadium, provokojnë një efekt të ndryshëm sepse janë më direkte, më të qarta dhe të forta. Ndash-

jet mes tifozerive, sidomos nëse bëhet fjalë për derby bëhet e ashpër si fizikisht ashtu edhe verbalisht.

Ja çfarë mund të lexosh në profilet e tifozave në rrjetet sociale:

@SUPERLIGA SHQIPTARE (Facebook) koment 24 gusht 2014

- Duke qene se e ndoqa ndeshjen nga Stadiumi, e ndjej si detyrim te sqaroj Opinion Publik se te shara ose ofendime ne kore kundrejt Tifozeve Fierak nuk ka pasur, pervecse nje etiketim ne KOR e siper... Tirona, Tirona, Fito per Ne, Tirona mbyti Lalucat... Kaq dhe vetem kaq.

Ishalla si shqiptare qe jemi u Shafshim vetem me etiketime te tilla... *Minj, Morra, Gocat e Bulevardit, Lab, Malok, Leshterik, Laluc* etj...

Mos kalofshim ne Moter e Nene e Babe ... SE JEMI VLEZER TE GJITH SHQIPTAR...

➤ Une personalisht isha ne tribune dhe i kam degjuar mjaft mire ofendimet. Ndoshta jo aq banale por ishin provokime te medha. Kenga e *vish fustanin me toka* apo ajo *mbyti lalucet* ne drejtim per ekipin tone dhe disa sharje te vogla per lojtaret.

@Ultras Tirona (Facebook status 16 qershor 2014)

- Java 1 - TIRONA vs Apollonia Nderkohe..

Java 6 - TIRONA vs *Morri*

Java 7 - Skenderbeu vs TIRONA

(Status 21 mars 2014)

- Te Shtunen nisena te gjithë bashke ne oren 17:00 nga bar Old School te shkolla kuqe. Te gjithë bashke kundra te gjithëve. Te gjithë bashke per te shtyp morrat e kuq. Nuk duhet me mungu njeri!

Vihen re fare mirë pra, metaforat fyese që përdorin tifozeritë kundër njëra-tjetrës të cilat arrijnë deri në dhunë verbale, e cila e shoqëruar me dhunë fizike është një fenomen shqetësues në stadiumet tona.

Kështu mund të shikojmë se thirren: *Morra* – lojtarët e Partizanit; *Minjtë* (Minjtë-gjizakë) – lojtarët e Tiranës; *Gocat e Bulevardit* – lojtarët e Dinamos; *Leshterikët* – lojtarët e Teutës së Durrësit; *Lalucët* – lojtarët e Apolonisë së Fierit etj.

3.5 Metaforat e futbollit në gjuhën e përditshme

Ashtu siç janë të lidhur nivelet e ndryshme të gjuhës së futbollit mes tyre, ato kanë hyrë edhe në terminologjinë e përditshme. Futbollit, si në nivel profesional apo në nive amatorial, rezulton të jetë pjesë përbërëse e jetës dhe komunikimit tonë (Bogdal 2010: 35). Kështu që s'ka asgjë për t'u çuditur që metaforat e futbollit kanë hyrë në gjuhën e zakonshme dhe shpesh këto shprehje janë shndërruar në fikse dhe të standardizuara. Një shembull është për shembull shprehja: *të bësh autogol* që do të thotë të shkatërrosh me duart e tua. *U bë si top futbollit*, tjetër shprehje nga gjuha e futbollit që do të thotë kaloi dorë më dorë, u bë si leckë etj.

Përfundime

Ndër gjuhët e specialitetit mund të rendisim edhe gjuhën e sportit. Në gjuhën e sportit kemi disa nëngjuhë, ndër të cilat shumë e veçantë është ajo e futbollit, e cila qëndron mes gjuhës së specialitetit dhe zhargonit. Në këtë kumtesë u ndalëm te një aspekt i veçantë i gjuhës së futbollit dhe pikërisht te metaforat, sepse kush flet për futbollin herë a vonë do të përdorë metaforat. Meqenëse bëhet fjalë për një gjuhë specialiteti duhet thënë se trasmetuesit e kronikave, tifozët, spektatorët nuk kanë shumë diferenca në nivelin e të kuptuarit dhe kjo lehtëson përdorimin e metaforave. Metaforat janë të pranishme në disa kategori tekstuale që janë të lidhura mes tyre.

Ngjarja sportive identifikohet, me ecurinë e një beteje në kamp. Kemi analogji të ndryshme mes lojës dhe luftës, prandaj shumë nga termat janë marrë nga fusha semantike e luftës. Shprehjet luftarake rezultojnë, pra, si një karakteristikë e gjuhës së sportit. Megjithatë duhet thënë se në gjuhën e futbollit ka edhe një sërë shprehjesh metaforike të cilat nuk i referohen domosdoshmërisht fushës semantike të luftës. Kështu kemi metafora të cilat vijnë nga fusha e teatrit, që i përkasin zhargonit teknik apo fushës së muzikës etj.

Në ndryshim nga gjuhët e specialitetit, ajo e futbollit paraqet shprehje të zhargonit që nuk

përfaqësojnë një gjuhë specialiteti në kuptimin e ngushtë të fjalës. Gjithashtu shumë terma nuk fokusohen në saktësinë terminologjike në përshkrimin e objekteve apo të situatave të veçanta, por në aspekte specifike të një grupi. Prania e metaforave që lidhen me nofkat është shumë e përhapur. Tifozeria e marrosur pas numrave të futbollistëve është munduar vazhdimisht të futet në karakterin e tyre duke i përshtatur nofkën. Ca kjo për t'i ngritur sa më lart vlerat sportistit në fjalë, ca edhe për të thjeshtëzuar sa më shumë emrat e tyre. Nofkat e sportistëve janë të shumta dhe intriguese, madje të paimagjinueshme për nga fantazia me të cilën ata janë pagëzuar. Lista e këtyre nofkave është e gjatë dhe në to ka emra kafshësh e insektesh, epitete të ndryshme që kanë të bëjnë me karakterin e sportistit dhe cilësitë e tij.

Planet e ndryshme të realitetit të gjuhës së futbollit dhe të metaforave preken duke u përzier me njëra-tjetrën. Kjo vlen sidomos nëse konsideron trasmetimin e asaj që ndodh në fushë për ata që dëgjojnë. Metaforat në gjuhën e fansave mund të shkojnë deri në disfemizma dhe sharje të rënda. Dhe së fundmi duhet thënë që disa nga metaforat e gjuhës së futbollit kanë hyrë në gjuhën e zakonshme dhe shpesh janë shndërruar në shprehje fikse dhe të standartizuara

Bibliografia

- ALTIERI Biagi, MARIA Luisa, 1990, *L'avventura della mente. Studi sulla lingua scientifica*, Napoli, Morano Editore.
- BALBONI P. E., 2000, *Le microlingue scientifico-professionali*, UTET, Torino.
- BOGDAL Klaus Michael, Neuland Eva, Pfeiffer Joachim, Schlobinski Peter (2010), *Futball und Sprache in Der Beutschununterricht*, III/Berlin, Friedrich Verlag.
- CORNU Yvan (2009), *Les arbitres*, Belgjikë.
- CORTELAZZO M. A., 1990, *Lingue speciali*, Padova, Unipress.
- CORTELAZZO M. A., 1994, *Lingue speciali. La dimensione verticale*, Unipress, Padova.
- CORTELAZZO M. A., 2000, *Italiano d'oggi*, Esedra, Padova.

DARDANO M., 1994, «I linguaggi scientifici», në Storia della lingua italiana, vëllimi II, Scritto e parlato, nën kujdesin e L. Serianni e P. Trifone, Torino, Einaudi, f. 497-551.

LAKOFF George, JOHNSON Mark (2004), Metafora e vita quotidiana, Milano, Bompiani.

Maurizio DARDANO e Pietro TRIFONE, La nuova grammatica della lingua italiana, Zanichelli, Bologna, 1997

SCARPA F., 2008, La traduzione specializzata, Hoepli, Milano.

SOBRERO A. A., 1993, «Lingue speciali» në Introduzione all'italiano contemporaneo, vëllimi II, La variazione e gli usi, nën kujdesin e A. A. Sobrero, Bari, Laterza f. 237-277.

THOMAI Jani, 2002, Leksikologjia e gjuhës shqipe, shulu, Tiranë.

Sitografia

<http://www.sportishqiptar.com.al>

<http://www.panorama-sport.com/>

SOME ISSUES OF THE *SUBJECT* IN ALBANIAN LANGUAGE DISA ÇËSHTJE TË KRYEFJALËS NË GJUHËN SHQIPE

MATILDA PARLLAKU

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Histori Filologjisë, Tiranë, Shqipëri
Email: collakumatilda@yahoo.fr

PËRMBLEDHJE

Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i disa çështjeve sintaksore që lidhen me kryefjalën si gjymtyrë fjalie dhe marrëdhëniet e saj me gjymtyrët e tjera të fjalisë. Do të sjellim këndvështrimin tonë në lidhje me trajtimin e disa çështjeve si: *Kryefjala si gjymtyrë kryesore; Format e shprehjes së kryefjalës; Kryefjala dhe marrëdhënia me gjymtyrët e tjera të fjalisë; Pozicioni i kryefjalës në fjali*. Këto çështje do të sqarohen nëpërmjet: (a) krahasimit të mendimeve të ndryshme të gjuhëtarëve për pozicionin e kryefjalës sipas klasifikimit të gjymtyrëve në fjali; (b) shembujve e analizave të formave të ndryshme të shprehjes së saj dhe disa kufizime në shprehjen e kësaj gjymtyre me disa pjesë ligjërata si emri në trajtën e pashquar apo disa lloje përemrash. Rastet konkrete të marrëdhënies mes kryefjalës dhe dallimit të saj nga gjymtyrët e tjera të fjalisë, si edhe shembujt për pozicionin që ajo zë në fjali do të shërbejnë për të identifikuar edhe raste që nuk janë trajtuar teorikisht.

Fjalë çelës: Kryefjala, gjymtyrë fjalie, marrëdhënie, rendi në fjali.

SUMMARY

The aim of this paper is to treat some syntactic issues related to the subject as a part of the sentence and its relations to the other parts of the sentence. We will try to develop our ideas concerning the treatment of some issues such as: *The subject as a main part of the sentence; Expression forms of the subject; the subject and its relation to the other parts of the sentence; Position of the subject in a sentence or clause*. These issues are going to be explained through: (a) comparing different ideas and opinions of linguists on the subject's position according to the classification of the parts of the sentence; (b) the examples and the analysis of the expression forms of the subject and some restrictions on the expression of it, such as the noun in the indefinite form, or some pronouns. The concrete cases of the specific relations of the subject and its identification from the other parts of the sentence, and also the examples of its position in the sentence are going to identify cases which are not theoretically explained.

Key-words: Subject, parts of sentences, relations, topics.

Hyrje

Kryefjala si kategori sintaksore nuk është bërë objekt i ndonjë studimi të veçantë. Ajo është trajtuar nëpër gramatika të ndryshme nga A. Xhuvani, I. D. Sheperi, K. Cipo, M. Domi, S. Prifti, A. J. Rrota, Th. Dhima, T. Topalli dhe në Gramatikën e Akademisë. Për informacion kemi konsultuar edhe trajtimin që i është bërë kësaj gjymtyre në studime të ndryshme të mbështetura në gramatikën gjenerative, por pa i përzier këndvështrimet dhe as terminologjinë.

Kryefjala në këtë trajtesë do të vështrohet e shqyrtohet me terma të sintaksës tradicionale, siç është parë edhe nga gjuhëtarët në gramatikat e deritanishme tradicionale, sikurse edhe në gramatikën normative të Akademisë.

1. Kryefjala, gjymtyrë kryesore

Për sa i përket vendit që zë kryefjala në klasifikimin e gjymtyrëve të fjalisë, sipas rëndësisë, mendimi kryesor është ai që gjejmë në gramatikat, të cilat e klasifikojnë atë së bashku me kallëzuesin si gjymtyrë kryesore. *"Gjymtyrët kryesore të fjalisë"*

janë kryefjala dhe kallëzuesi. Ato janë baza e fjalisë dykryegjymtyrëshe dhe nuk mund të kuptohen pa njëra-tjetrën. Kryefjalë është gjymtyra kryesore emërore a përemërore e fjalisë dykryegjymtyrëshe që hyn në marrëdhënie e lidhje kallëzuesore (predikative) me kallëzuesin.” Por ka një mendim tjetër që si gjymtyrë kryesore klasifikon foljen kallëzues dhe e konsideron atë bërthamë të fjalisë.

Një nga përkrahësit e mendimit që i cakton vendin dhe rolin kryesor foljes kallëzues në frazë është M. Totoni, i cili thekson: *“Nga pikëpamja e organizimit të fjalisë, rolin kryesor e lot gjymtyra foljore-kallëzuesi. Ajo ruan një nga tiparet themelore të fjalisë, kallëzuesinë (modalitetin, kohën dhe vetën). Gjymtyra emërore, kryefjala nuk e ka këtë aftësi e pikërisht për këtë arsye në gjuhën shqipe ka edhe tipa fjalish pa gjymtyrë kryesore emërore.”*

Ky mendim mbështetet në argumentin që, në shumicën e rasteve, vetë folja është e mjaftueshme për të shprehur subjektin e veprimit nëpërmjet mbaresave vetore të saj, me përjashtim të rasteve kur ka kundërvënie dhe theksim.

Megjithatë ai e pranon, në njëfarë mënyre, që, pavarësisht këtij dallimi në aspektin e organizimit të fjalisë, në fjalinë me dy gjymtyrë kryesore dallohen kryefjala, gjymtyra emërore dhe kallëzuesi, gjymtyra foljore, që bashkohen me lidhjen kallëzuesore. *“Kryefjala e kallëzuesi qëndrojnë në kundërvënie me njëri-tjetrin, prandaj jashtë kësaj kundërvënieje nuk kemi as kryefjalë, as kallëzues, po thjesht gjymtyrë kryesore.”*

Edhe M. Çeliku e konsideron kallëzuesin si më të rëndësishëm në një fjali, duke e emërtuar (në terma të raportit të varësisë të fjalëve në togfjalësh) atë si gjymtyrë përcaktuese kundrejt kryefjalës (gjymtyrë e përcaktuar) dhe duke tërhequr vëmendjen për të mos e ngatërruar predikativitetin me kallëzuesinë, sepse i pari është nocion më i gjerë që e përfshin edhe të dytën.

Trajtimi i kësaj gjymtyre, si kategori sintaksore, ka ardhur duke u plotësuar nga një gramatikë në tjetrën, si për sa i përket përkufizimit, ashtu edhe në lidhje me format dhe mjetet e shprehjes së saj, duke u trajtuar më gjerë e me më shumë

shpjegime në sintaksën e S. Priftit dhe në atë të Akademisë. Krahasuar me përkufizimin e dhënë nga Sintaksa e Akademisë ai i S. Priftit vjen me këtë ndryshim në formulim, por jo në thelb: *“Kryefjala, siç e tregon vetë termi është fjala kryesore, gramatikisht e pavarur e cila tregon objektin kryesor mbi të cilin është përqendruar mendimi ynë dhe për të cilin ne flasim në fjali. Kryefjala shërben vetëm për ta emërtuar objektin për të cilin flasim dhe jo për ta karakterizuar atë (këtë e bën kallëzuesi).”*

Pavarësisht nga mendimet e ndryshme të sjella më sipër, në lidhje me trajtimin e kryefjalës si gjymtyrë kryesore, ne mendojmë se, larmia e mjeteve të shprehjes së saj, me gjithë kufizimet strukturore dhe kuptimore përkatëse, për secilën nga pjesët e ligjëratës, me të cilat shprehet, dëshmon që ajo është një gjymtyrë me peshë në fjalinë dykryegjymtyrëshe dhe roli i saj, në raport me gjymtyrët e tjera të fjalisë, sidomos ato që varen prej saj, si përcaktorët e të gjitha llojeve dhe jo vetëm, është mjaft i rëndësishëm dhe asaj duhet t'i jepet vendi që i takon si gjymtyrë kryesore.

2. Format e shprehjes së kryefjalës

Nisur nga fakti që rasa emërore është forma tipike e shprehjes së kryefjalës, sikurse është trajtuar në të gjitha gramatikat e deritashme, e gjejmë me vend të sjellim këtu interpretimin e kësaj çështjeje nga ana e S. Rizës: *“Kur jipen kuptimet e ndryshëm të rasavet të ndryshme, është e vërtetë gjithashtu se si kuptim kryesor i rasës emërore jipet shërbimi i saj sintaktik për të çfaqur kryefjalën.”* duke dhënë gjithashtu edhe një opinion rreth rolit kryesor të kryefjalës në raport me kallëzuesin: *“Por raporti ekzistues midis kryefjalës dhe kallëzuesit pikënisjen e vet e ka jo tek kryefjala, por tek kallëzuesi; kështuqë nuk është kryefjala ajo që gjindet në raport me kallëzuesin, por, anasjelltas është kallëzuesi ai që gjindet në raport me kryefjalën; e kështuqë shfaqja e këtij raporti i takon formës jo të emrit kryefjalë por të foljes kallëzues.”* (Riza 2009: 256).

2.1 Kryefjalë e shprehur me emër:

2.1.1 Shprehja e kryefjalës me emër në trajtën e shquar:

Në qoftë se Akili është arma sekrete, thembra është përkohshmëria e sekretit. (I. Kadare);

Flamur me ngrehë n`veti, e Gjergj Kastriotin e t`parët, a thua kështu do t`korisë nipnia? (Gj. Fishta);

Zgjohej me radhë hetuesit, hetuesit e fshehtë, përqjesit e hetuesve, dyshuesit e përgjuesve e, fill pas tyre kallëzuesit, kallëzuesit epileptikë, kallëzuesit që iu besohej një herë në një mijë vjet, vëzhguesit e kotsëkotshëm, kinse vëzhguesit e verbër të atyre që kishin shpallur se do të vrisnin veten, /.../ përqjesit deledashë, kumtzbërthyesit e të vdekurve, nuhatësit, yjkuptuesit, hë-nëmarrokët, ndryshkaheqësit e pranqave etj. (I. Kadare);

2.1.2 Shprehja e kryefjalës me emër në trajtën e pashquar

2.1.2.1 Në fjali me kallëzues në formën joveprore, në diatezën pësore, vetvetore a mesore dhe folje jokalimtare:

Vdekje më e lehtë dhe më e ëmbël s`ish parë kurrrë. (M. Kuteli)

Por një fushë ma e blertë nuk shtrohet/ Por një mal ma bukur s`rri/ Ma i kulluet një lumë s`dikohet (rrjedh)/ Moj Shqipni si i ke tj. (Gj. Fishta).

2.1.2.2 Në fjali mohore dhe pyetëse (kryefjala emërton sende të numërueshme ose të pandashme):

Përqijajja jonë ishte e shkurtër dhe e prerë: as shkaba, as kryqi s`do të shqimëshin kurrë nga qielli ynë. (I. Kadare);

Po ra shi në korrik, matet misri me shinik. (Fjalë të urta, Jug).

2.1.2.3 Në fjali dëftore a pyetëse (kryefjala është në numrin shumës):

Do të gjëmojnë rrotat dhe flatrat e kocive qiellore, klithma, sokëllima, lutje, fjalime, valle, vet-martirizime, ca si shfaqje teatrale, ku, siç e morëm vesh më pas, koka të prera flisnin në jerm, ushtarë që shkërbenin qyqet, malkime, namatisje, kërcënime e prapë bori e tam-tame, të

gjitha këto ngriheshin që poshtë si avull i sëmurë. (I. Kadare);

Do t`i shkonin më miq në shtëpi tani që e njohën kush është në të vërtetë?

Përpara tij ranë frone e ranë therore/U rroposën mbretni e u shkimen fise. / E as bar ma s`mbiu andej ka i shkeli kamba. (Gj. Fishta);

Për ta (burra që me gjak praruan lavdinë e kombit) nuk gdhendet as gur, as nuk ndizet qiri. (Gj. Fishta).

2.2 Kryefjalë e shprehur me përemër:

2.2.1 vector

Me këtë pjesë ligjërata në vetën I dhe II, kryefjala shprehet, kryesisht kur mbi të bie theksi logjik ose kur vihet në dukje me anë të kundërvënies:

Ti duhet të më ndihmosh që unë ta shoh veten ku jam. (B. Mustafaj);

Po lëvizi ajo, gjithçka do të shembet. (I. Kadare).

2.2.2 dëftor

Kjo vazhdoi për një kohë të gjatë. I. Kadare.

2.2.3 pyetës

Cili ishte shkaku i dënimit prej gjyqit partizan? (I. Kadare);

Po në kjoftë se s`e din ti, kush mund e dijë atëherë? (At Zef Pllumi).

2.2.4 lidhor

a) të caktuar (që, i/e cili/cila)

Rrotulla e cila mbante gurin u bë fre i argjëndë. M. Kuteli;

Këto tri dhi s`ka zot e rob në botë që t`i shtjerë në dorë, se janë këmbëshpejta. (M. Kuteli).

b) të pacaktuar (ç, kush)

Çndodhi atje brenda, askush nuk mund ta thotë. (I. Kadare);

Ajo që na panë sytë natën përpara mësymjes ishte më e frikshme se çdo luftë e vrasit. (I. Kadare).

2.2.5 të pacaktuar

Ty s`të dëgjon njeri. (I. Kadare);

Po të kishin aq xheloz, do të vriteshin të gjithë. (D. Agolli).

2.3 Kryefjalë e shprehur me numëror

2.3.1 themelor

Dy-tre veta deshën të vraponin pas Ullug beut, por befas, oficeri i jeniçerëve që gjer atëherë kishte qëndruar si mumje, nxori shpatën dhe thirri. (I. Kadare);

A e kupton se tre çerekët e këtij populli, po të gjejshin një vrimë miut në gardhin e çeliktë ... do t'ikshin nga kjo shtypje e randë? (At Zef Pllumi).

2.3.2 me kuptim përmbledhës

Pastaj u nisëm të dy, unë dhe i panjohuri drejt qytetit. (I. Kadare);

Duhet trimnia e ukut e mendtë e dhelpnës; po nuk i pate të dyja këto, nuk mund të jetosh kaçak. (At Zef Pllumi).

2.4 Pjesë ligjërate të emëruara:

Mbiemra, përemra, pjesë të pandryshueshme të ligjëratës të emëruara:

I sikterisuri, po të dojë le të grindet, unë s'kam ndërmend të grindem. (F. Kongoli);

Sipas ligjit të atëhershëm, në qoftë se i burgosuri vdiste gjatë shlyerjes së dënimit, trupi i tij duhet të vazhdojë burgimin, gjersa të plotësohet afati. (I. Kadare);

(Manaferrat nuk i shijonte, kur mendonte se rri-teshin në anë të rrugës, por këto ishin mbledhur në bahçe.) Të tillat nuk i refuzonte asnjëherë. Imja nuk do të bëhej kurrë aq e zonja, sepse nuk kishte vullnet. I ati, përveç që i pushkatuar, ishte prift. I ungj, në burg. (I. Kadare);

A-ja është shkronja e parë në të gjitha alfabetet. Dyshi është nënfish i katrës, tetës, dymbëdhjetës etj.

Që-ja është përemër lidhor ose lidhës nënrenditëse ftilluese ose qëllimore.

Pranë, poshtë, afër, para përdoren si ndajfolje vendi, kur vendosen pas foljeve dhe si parafjalë, kur vendosen para emrave.

"Lamtumirë" ishte e vetmja gjë që shqiptoi, para se të largohej përgjithmonë.

2.5 Kryefjalë e shprehur me togfjalësh / grup emëror:

Që sa t'ndrisë e diellit rrota / kanë me qenë nderi i trimnive. (Gj. Fishta);

Oh, po!. Mos t'vlonte ai gjaku juej për Atdhe / e gjyq mos t'lypte ai para fronit t'qiejve. / Po se këto bjeshkë e këto malet tona, / Shqipni ma s'ishin quejtë. / as shqip s'ishte lutë ma i Madhi i jetës. (Gj. Fishta);

Atëherë lotmadhi i turqve pendohet që i ra kurrë n'mend t'mësyjë Shqipninë mizore. Gj. Fishta).

(a) Me togfjalëshat e qëndrueshëm që emërtojnë një vepër letrare, shkencore, institucion, vend, ngjarje historike, person.:

"Mësuesi" ka qenë gazetë e revistë e përmuajshme, organ i Ministrisë së Arsimiti;

Mark Malaj e Kapiten Pal Thani me të gjithë ushtrinë ilegale të tyre do të dorzoheshin me qyshke që mos të dënohej asnjë me vdekje dhe malësorët të lireshin të lirë. (At Zef Pllumi).

(b) Emërtime vendesh, përrenjsh e shtigjesh shembeshin prorre:

Kodra e Qyqes, Prita te Tri Pusët, Kurthi i Zekës, Gropa, Korbi, Rrëzana e keqe. (I. Kadare).

2.6 Kryefjalë e shprehur me emër në rasën gjinore

Një rast i rrallë i shprehjes së kryefjalës është ai me emër në rasën gjinore, i cili në të vërtetë është fjalë e varur e grupit emëror të përbërë nga një emër tjetër dhe emri në gjinore. Me shkëputjen nga ky grup emëror emri në fjalë i prirë më parë nga nyja **e**, kur del në funksionin e kryefjalës, e ndërron këtë nyjë në **të** dhe qëndron si gjymtyrë më vete.

(Sixhadet e Shqipërisë dikur përgatiteshin në bazë të porosive nga vendet e ndryshme të botës.) Të Korçës ishin gjithnjë më të bukura e më cilësore.

Raste të tilla janë shpjeguar nga F. Agalliu si "Shfaqje të substantivimit kontekstual të rasës gjinore, e cila, si për funksionin e saj, edhe më shumë për formën e saj (me nyjë të përparme identike me atë të mbiemrit) afrohet me mbiemrin, saqë mund të quhet rasë gati e adjektivuar. Në ndonjë rast gjinorja përdoret në funksione të ndryshme, ndër të cilët në atë të kryefjalës, edhe e substantivuar përfundimisht pa thonjëza."

Një mendim thuajse të njëjtë ka shprehur para tij edhe I. D. Sheperi kur ka folur për rasën gjinore:

“Rasa gjëndore ka përgjithësisht kuptim pronësie dhe shërben në fjali si edhe gjithë mbiemrat d.m.th. si kryefjalë, kur nënkuptohet emëri. Erdhi e Lames (= e shoqja).” Mundësia e përdorimit të rasës gjinore në funksionin e kryefjalës është shprehur edhe në vëll. I të Gramatikës së gjuhës shqipe (Morfologjia).

2.7 Kryefjalë e shprehur me mbiemra të bashkuar me lidhëzën e të barazvlefshëm me kuptimin e një përemri të pacaktuar:

Në e ditka i madh e i vogël, (të gjithë) pa m'i tregoni edhe mua se, helbete jam plak e ndofta i kam harruar (M. Kuteli).

2.8 Shprehja e kryefjalës me emra prejfoljorë asnjane:

Këndohet teksti i telegrafës që kërkohet të hjekunit e Nënprefektit (Bis. Parl. 1920). *Mbas propozimit të nënkryetarit vendohet të zqjedhunit e një komisioni pesë vetësh për rregulloren e përmendshme* (Bis. Parl. 1920; *Merret në gojë të thirrunit e Qeverrijës për spjegime* (Bis. Parl. 1920); *Të hyemit e privatvet brenda asht i ndaluem.* (Bisedime parl. 1926/4).

Kjo dukuri është e kufizuar dhe kryefjala në këtë formë shprehjeje vendos lidhje me disa folje kallëzues të kufizuara dhe në formën joveprore si: *kërkohet, vendoset, diskutohet* etj. *Këto ndërtime, me kalimin e kohës, kanë filluar të zëvendësohen nga emrat e prejardhur të formuar me anë të prapashtesave –im dhe –je (zëvendësimi i emrave asnjane të hjekunit, të zqjedhunit, të thirrunit dhe të hyemit me ata prejfoljorë heqja; zqjedhja; thirrja; hyrja) duke u çintegruar nga gjinia asnjane dhe duke u integruar në gjininë femërore, si rrjedhin i prirjes së përgjithshme të shqipes së re (dhe jo vetëm të shqipes) për të parapëlqyer, në fushën e emërave, derivacionin sintetik përkundrejt fjalëformimit analitik.*

Konkluzione

Nga sa u shpjegua më sipër mund të themi që, mënyra e trajtimit të kryefjalës në gramatika të ndryshme, sikurse edhe mjetet dhe format me të cilat ajo shprehet, janë të përafërta, duke evoluar kryesisht në numrin e mjeteve të shprehjes. Por, e veçanta që u konstatua duke i krahasuar trajtimet e mëparshme dhe shembujt e sjellë për konkretizimin e rregullave me ata që kemi mbledhur gjatë vjeljes së veprave është pikërisht fakti që, në rastet kur kryefjala shprehet me pjesët e pandryshueshme të ligjëratës që emërohen, struktura e fjalive është e kufizuar më tepër në lidhjen me kallëzuesin emëror, për pasojë ajo vendos lidhje me foljen këpuj *jam* (ose, rrallë me ndonjë folje tjetër si *mbetet*) dhe gjithashtu ajo renditet para kësaj të fundit. Ndërkohë që në të gjitha rastet e tjera, rendi nuk është i kufizuar dhe gjithashtu as tipat e foljeve kallëzues me të cilët vendos lidhje. Një ndër risitë e sjella nëpërmjet kësaj trajtuese është edhe vënia në dukje dhe konkretizimi me më shumë shembuj i kufizimeve në shprehjen e kryefjalës me emër në trajtën e pashquar, çështje kjo e trajtuar veçanërisht në gramatikën e Akademisë. Një rast i veçantë, i konstatuar gjatë vjeljes së shembujve ishte edhe shprehja e kryefjalës me emra të gjinisë asnjane. Shembujt janë mjaft të rrallë dhe janë gjetur në libra të viteve `20-`30, kur gjinia asnjane ende nuk ishte “çintegruar” për t`u integruar në një nga dy gjinitë: mashkullore apo femërore.

Për shkak të hapësirës së kufizuar të një kumtese, ne nuk i kemi trajtuar disa çështje si: rastet e mospërdorimit të kryefjalës kur shprehet me përemra vetorë të vetës së parë e të dytë (duke specifikuar rastet kur ka kundërvënie dhe theksim); kur në fjali ka folje pavetore; kur lidhet me folje në mënyrën urdhërore; kur në fjali ka forma të pashtjelluara foljore; në rastin kur kemi të bëjmë me fjali eliptike me mungesë të kryefjalës, apo rastet kur kryefjala është gjymtyrë krahasimi, ndajshim i veçuar etj., të cilat (dhe të tjera si këto) mund të bëhen objekt i një studimi tjetër nga ana jonë.

FOLKLORI DIGJITAL I ADOLESHENTËVE DIGITAL ADOLESCENT FOLKLORE

ZURIJETA SALIU

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, MAQEDONI
Email: zurijeta_saliu@live.com

Përmbledhje

Adoleshentët janë pjesa kryesore e popullit nga të cilët varet e tashmja dhe e ardhmja. Çdo gjë që krijohet dhe ndryshohet vjen pikërisht nga kjo pjesë e popullit, kështu ndodhë edhe me folklorin elektronik, të cilin e krijojnë dhe e ndryshojnë adoleshentët. Folklori digjital është i pranishëm kudo. Me zhvillimin e teknologjive bashkëkohore zhvillohet edhe folklori, por bartësit e këtij zhvillimi janë pikërisht të rinjtë, për arsye se ata komunikojnë pa ndërprerë nëpërmjet rrjeteve të ndryshme sociale. Edhe në këtë punim janë mesazhet e ndryshme që përdoren në komunikime digjitale. Të dhëna janë mbledhur nga një grup i të rinjve që i kemi përmendur më poshtë. Mesazhet më të shpeshta që përdoren janë: mesazhe urimi (ditëlindje, festa fetare e kombëtare), mesazhe dashurie, mesazhe për shkollën, mesazhe tallëse, mesazhe për shoqërinë.

Fjalët çelës: folklori, interneti, adoleshentët, komunikimi dhe mesazhe.

Abstract

Teenagers are the main part of the people who depend on the present and future. Everything created and changed precisely come from this part of the people, so also occur with digital folklore where teenagers are the ones who create this change and folklore. Digital folklore is everywhere and with the development on modern technologies developed folklore, but the holder of this development are the very young, because they communicate without interrupting through various social networks. Even in this paper are those teens who find different messages used in electronic communications and data were collected from a group of young people who have mentioned below. Messages most commonly used are: congratulatory messages (birthday, eid etc.), love messages, messages for school, mocking the posts, messages the society etc. In further research is used and survey methods and the Internet is the main element of this paper. The study of this phenomenon brings folk assistance in the field of ethnology, especially lifestyle, operation and transformation of different kinds of popular rhetoric depending on general social developments.

Key word: Folklore, internet, teenagers, communication and messages

Hyrje

Adoleshentën janë ata të cilët më së shumti i përdorin rrjetet e ndryshme sociale, nëpërmjet internetit dhe telefonave celularë që komunikojnë në forma të ndryshme digjitale.

Shumë vite më parë të rinjtë dhe të rejtat ndjenjat e tyre i kanë shkruajtur nëpër fletore dhe letra të ndryshme duke i zbkuruar ato me shenja dhe simbole, ndërsa tash më kjo mënyrë e komunikimit gati është zhdukur dhe kemi mënyrë shumë më të lehtë të komunikimit se sa në kohët e mëparshme.

Më tepër letra kanë shkruar vajzat, se sa djemtë dhe ato i kanë ruajtur nëpër fletore të tyre private duke i fshehur nga prindërit. Fletoret kanë përmbajtur tekste dashurie dhe ndjenjat e tyre të fshehta.

Është e rëndësishme për të kuptuar, se vajzat në shumicën e rasteve kanë ndryshuar tekstat që i kanë kopjuar prej të tjerëve, duke ndryshuar emrat, kohën dhe vendin, duke futur ndjenjat e tyre, duke zëvendësuar fjalë të çuditshme nga ato më të njohura. Pra, çdo vajzë, duke shkruar materialin e ri në fletoren e saj, fjalë për fjalë

përvetëson atë dhe bëhet autori i saj, duke e çuar në thekset e saj krijuese (Vainshtein octomber, 1996).

Tash më këto shkrime gati se janë zhdukur dhe kemi shkrime të reja të cilat i gjejmë kudo në rrjeta të ndryshme sociale, forume të ndryshme dhe gjithkund në internet. Mënyra e të shkruarit dhe e të komunikuarit krejtësisht ka ndryshuar dhe shumë komunikime bëhen në mënyrë digjitale. Kjo mënyrë e komunikimit jo vetëm që ka ndryshuar gjuhën, por edhe e ka pasuaruar atë, duke e mbushur me tekste të bukura. Kështu kemi tekste të ndryshme që me një fjalë mund t'i quajmë tekste folklorike.

Kjo ka ardhur nga zhvillimi i teknologjive moderne të informacionit dhe të komunikimit që mundësojnë krijimin e një vizioni të ri të komunikimit popullor, specifik në krahasim me folklorin gojor dhe me shkrim, si dhe folklorin që transmetohet përmes mediave "tradicionale" digjitale. (Cvijetićanin 2006: 114).

Vlerat e krijuara nga një popull janë pasuria kulturore dhe artistike e atij populli që e quajmë folklor.

Karakteristikë e folklorit shqiptar është se ai është shumë i gjallë, i pasur dhe i larmishëm. (Hamiti etj. 2010: 191).

Sa i përket folklorit në kohët e lashta është ruajtur gojarisht brez pas brezi, ndërsa më vonë filloi të ruhet edhe nëpërmjet shkrimeve nëpër letra të ndryshme, kurse tash folklor mund të ruhet edhe nëpërmjet pajisjeve të ndryshme digjitale vetëm duke shtypur butonat e pajisjeve teknike.

Folklori digjital ka fituar përmasa të mëdha në vitet e fundit, duke filluar të përdoret në mesazhe të shkruara, pastaj edhe në internet, ku hyjnë një numër i madh i rrjeteve sociale, programeve të ndryshme që instalohen nëpër telefonat celularë, që shërbejnë për të komunikuar, ku gjithçka është e lidhur me internetin dhe zhvillimet e teknologjive moderne.

Folklori i të rinjëve më tepër përmban tekste dashurie, ku bëhet këmbimi i teksteve të ndryshme, tekste që i'a kushtojnë të dashurës, apo të dashurit, urime (urime ditëlindjeje, urime

festash etj.), po ashtu në folklorin e të rinjve gjejmë edhe tekste për shoqërinë, për prindërit, për më të dashurit, për shkollën e të tjera.

Këto mund t'i quajmë edhe si tregime të shkurtëra të cilat kanë përmbajtje të ndryshme ku shprehin dashuri, kënaqësi, dëshirë për diçka të bukur, tallje, shaka etj.

Në pika të shkurtëra do të bëjmë ndarjen e disa teksteve që janë përdorur në komunikime digjitale.

Mesazhe dashurie

Të rinjtë dhe të rejat, me të madhe përdorin komunikimet digjitale duke filluar nga mesazhet, programet e instaluar në telefona celularë që punojnë me anë të internetit, rrjeta të ndryshme sociale, programe të instaluar në kompjuterë personalë etj., ku në mes bisedave të lira gjejmë edhe një numër të madh të teksteve me përmbajtje dashurie, që ndryshe mund ta quajmë edhe si folklor digjital i të rinjëve.

Disa mesazhe që janë hasur nëpër telefona celularë dhe kompjuterë personalë janë:

1. *Te te pyes sa me do... eshte nje pyetje retorike dhe pse eshte pyetje e tille me pelqen te mar pergjigje.*
2. *Nese dashuria te duket plumb ruaje nje per vete se te duhet per ne fund. Nese je penduar mos mallko fatin se zoti eshte i madh e ta fal mekatin.*
3. *Syte e mi aspirin goja ime ampicilin, duar e mia andoll, zeri im sirup per koll,*
4. *Le te flasin njerezit le te meren me fjal por ti nga zemra ime kur nuk ke me dale.*
5. *Me pare pa pare du ni vajz shqiptare, se paret i kam vet, me shqiptare jam mbret.*
- 6.

Mesazhe të ndryshme: ceremonishë festive

Në kohën e sotme gati të gjitha festat urohen nëpërmjet mesazheve. Mesazhet janë me përmbajtje të bukur dhe e pasurojnë gjuhën me tekste të shkurtëra folklorike.

a) Urime ditëlindje

1. *Sot ne mengjes heret u zgjova, a thua dicka me zgjoi, mu kujtua ditelindja jote dhe te thira te ta uroj.*

2. *U cova dhe ne kalendar veshetrova, e pash se ke ditelindjen dhe nje leter te cova, ditelindjen ta urova.*

3. *Ne deg te molles ne deg te pemes, ta uroj ditelindjen nga thellesia e zemres.*

4. *Shoqja ime e dashur cdo here te kujtoj dhe sot ditelindjen ta uroj.*

5. *Ju ftoj te gjithve te festojme dhe Tines ditelindjen tja urojm.*

b) Urime bajrami

6. *Deshiroj qe Zoti te ju jep shendet dhe te mira ne jete, personat qe i dua dhe i kujtoj festen e Bajramit ua uroj.*

7. *Vlera e nje feste eshte ne kremtim kujdesi ndaj nje personi vleresohet me urim, me kujdes te madh keto fjale po i shkruaj me fat Bajramin ty dhe familjes tuaj.*

8. *Mengjes i bukur, dite e shenjte, me fat Bajramin per shum vjet.*

9. *Festen e Bajramit te gjithëve ua uroj vellezerve e motrave, selam ju dergoj, ne rruge te delire Allahu na udhezofte, xheneti stacioni i fundit per ne qofte.*

10. *Nje yll ne qiell shume bukur shendrit, Kjo Hena e zbehte po na fal pak drit, Ky qyelli blu dicka po tregon, Dikush qe te don Bajramin ta uron.*

Mesazhe lidhur me shkollën dhe dashurinë:

1. *Në oren e muzikës vec për ty këndoj dhe profesorim kur më dëgjoj, njëshin ma përfundoi.*

2. *Kirurgji moj kirurgji, asnje titull nuk ta di, si kam mend te profesori po i kam te dashnori.*

3. *Ne matematik vec plus e minus e prap imi dibidus.*

4. *Gjuhë shqipe kur e msojshim, kit shkrimtaret pi vori i trazojsim, en profin e mendojsim vec pyetje i parashtrojsim.*

5. *Matematik moj matematike, ne oren tende kam shume frike, sikur me shpohet zemra me thike.*

Mesazhe kushtuar shokut apo shoqes më të mirë

1. *Nuk e di tash se ku gjendesh, shoqja ime e perjetshme, ne zemren time do te mbetesh, e paharruar dhe e pavdekshme.*

2. *Kur je e merzitur dhe asgje nuk te shkon, tregoi shoqes tende dhe ajo te ndihmon.*

3. *Nje yll ne qiell sa bukur shendrit, kjo hene e zbehte po na fal pak drite, qielli i kalter dicka po tregon, se ke nje shoqe qe gjithmon te kujtojn.*

4. *O pellumb, o pellumb kartolinene mos e humb e kam mbushur me urime dhe ja coj shoqes sime.*

5. *Shoqja ime e dashur gjithmone te kujtoj dhe kur vij ne shkoll, menxi pres te te takoj.*

Mesazhe me përmbajtje talljeje

Të rinjtë dhe të rejtat shpesh gjatë komunikimeve shkruajnë edhe mesazhe në formë të shakave dhe tallen ndërmjet veti. Ja disa të tilla:

1. *Të takova ty në bahce, të pashë një pucër në faqe, sa u gëzova me rob shpie thash është pucër dashurie, si gjithmon mi preve këmbët, pucrën e kiske pse të dhimbshin dhëmbët.*

2. *Bajrami qe shkoj beqare na la, bajrami qe erdh beqare na xhet, ishalla bajramin qeter na del ni kismet.*

3. *Un si tul, ti si tullac, dashuria jonë pallat 15 kat*

4. *Baba ma ka lan mu ni amanet, me e xhet burin ne internet.*

5. *Bije bora fjolla-fjlolla ishalla neser dixhet shkolla.*

Nga tekstet që i shohim më sipër, përveç pasurisë së gjuhës, kemi edhe shumë gabime gjuhësore, të cilat na paraqiten edhe te shembujt e mësipërm. Gabimet më të dukshme janë:

- Mungesa e shkronjës **ë** dhe zëvendësimi i saj me shkronjën **e**;

- Mungesa e shkronjës **ç** dhe zëvendësimi i saj me shkronjën **c**;

- Mungesa e shkronjës **ë** në fund të fjalës;

- Zëvendësimi i shkronjës **ç** me shkronjën **q**, p.sh. *çikat – çikat*;

Fjalët e shkruara gabimisht, p.sh. *mar – marr*;

- Mungesa e apostrofit, p.sh. *sme – s'më, tja – t'ja*;
- Përsëritja pa nevojë e shkronjave të njëjta, p.sh. *dyy – dy, neveee – neve, muu – mua* etj.;
- Përdorimi i shkronjave të mëdha në vende jo të duhura;
- Përdorimi i fjalëve dialektore;
- Përdorimi i fjalëve të huaja, p.sh. *amanet, blu; etj.*

Të gjithë këto tekste të mesazheve që e pasurojnë folklorin digjital të gjuhës shqipe janë mbledhur nga 50 persona, 28 meshkuj dhe 22 femra, të moshës prej 15-22 vjet, nxënës të shkollave të mesme dhe studentë.

Gjithsej prej 50 të rinjëve janë mbledhur 284 mesazhe. Prej tyre 15% janë mesazhe që lidhen me shkollën dhe dashurinë, 17 % mesazhe me përmbajtje tallëse, 25 % mesazhe urimi dhe 43 % mesazhe me përmbajtje dashurie.

Tabela nr. 1 Mbledhja e mesazheve nga të rinjtë

Mesazhe dashurie	122
Mesazhe urimi	72
Mesazhe lidhur me shkollën dhe dashurinë	42
Mesazhe tallëse	48




Fig. 1. Mbledhja e mesazheve nga të rinjtë

Literatura

HAMITI, Sabri, SHALA, Kujtim, IDRIZI, Xhemaludin, ALIU, Ali & METANI, Idriz (2009). Gjuha shqipe dhe letërsia 1. (Për gjimnazet e reformuara). Alban. Tiranë - Prishtinë – Tetovë.

IBRAHIMI, Mustafa & BEHXHETI, V. & XHAFERI, H. & KADRIU, Z. (2008). Studime etnolinguistike, folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni. UEJL. Tetovë.

IBRAHIMI, Mustafa (2012). Tema socilinguistike dhe etnolinguistike. Interlingua. Shkup.

VAINSHTEIN, Olga (1996). Contemporary notebooks of love: girls' subculture in Russia. Paper given at the conference „Private life in Russia“, University of Michigan, Ann Arbor, October.

ЦВЈЕТИЋАНИН, Тијана (2006). Електронски фолклор тинејџера: SMS поруке. Гласник Етнографског института САНУ LIV, br. 54, str. 113-125. Београд

KONGLOMERATI GLOBAL DHE DIVERZITETI SOCIO-LINGUISTIK GLOBAL CONGLOMERATE SOCIO-LINGUISTIC DIVERSITY

MIRLINDA SHEHU

Administratë, Prishtinë, Kosovë

Email: mirlindashehu2@yahoo.com

Përmbledhje

Sipas Varfit "Gjuha si mjet komunikimi është jo vetëm një medium kulturor, por edhe një element thelbësor i vetë komunikimit". Prandaj, duke qenë pra, vetë gjuha një sistem i pasur simbolesh përmes të cilave njerëz të nacionaliteteve, kulturave dhe të traditave të ndryshme komunikojnë me ose pa vështirësi gjatë të mësuarit jetësor dhe atij skollistik megjithatë, ata në të njëjtën kohë ndeshen me diverzitetet të konsiderueshme sociale, ndër-gjuhësore dhe kulturore. Çështja e komunikimit ndër-gjuhësor ngërthen faktorët të rëndësishëm si socio-kulturor, regjional, kohor dhe stilistik të cilët pasurojnë dhe plotësojnë njëri-tjetrin. Kompetenca inter-kulturore dhe komunikimi ndër-gjuhësor në epokën e globalizimit paraqesin një proces të shkëmbimeve të ndërsjellta, që në prespektivën ndër-gjuhësore kompetencat e tilla mbështeten në kapacitetin e lokutorëve që bartin mesazhin dhe transmetojnë atë. Prandaj, në këtë punim do të trajtojm aspektin socio-kulturor duke i dhënë prioritet thelbësor aspektit kulturor, komunikativ, edukativ dhe duke analizuar dhe shpjeguar fenomenin e shkëmbimeve inter-kulturore dhe gjuhësore.

Fjalët çelës: konglomerat, diverzitet, kompetencë, globalizim, social.

Abstract

According to Varf "Language as a means of communication is not only a cultural medium, but also an essential element of communication itself. Therefore, since then the languages itself is a rich system of symbols through which people from different nationalities, cultures and different traditions communicate with or without learning difficulties during the life and scholastic learning. However, at the same time they face considerable social diversity, inter-linguistic and cultural. The inter-linguistic issue also, involves important factors such as, socio-cultural, regional, time frame and stylistic who enriches and complement each other. The inter-cultural competence and inter-linguistic communication in the era of globalization represents an mutual exchange process, such competences on the inter-linguistic perspective are based on the capacity of locators to carry the messages and to transmit it. Therefore, in this abstarct we will treat the socio-cultural by prioritizing essential cultural aspect, communicative, educational and by analyzing and explaining the inter-linguistic and cultural phenomenon of exchanges.

Key words: conglomerate, diversity, competence, globalization, social.

Hyrje

Në këtë punim do të trajtojm aspektin socio-kulturor duke i dhënë prioritet thelbësor aspektit kulturor, komunikativ, edukativ, duke analizuar dhe shpjeguar fenomenin e shkëmbimeve inter-kulturore dhe gjuhësore. Analiza strukturore e paraqitur në aspektin historik është e një rëndësie të veçant dhe mundëson një çasje historike dhe kronologjike të ndikimeve shumë të hershme, gjatë periudhave të ndryshme historike e deri në ditët e sotme, mendojm se ky

punim është një rëndësie të veçant se në mënyrë sistematike paraqet ndikimet dhe realizimin e të drejtës së përdorimit të gjuhës dhe të trajtimit të barabartë me të drejta të plota sipas normave ndërkombëtare që në ditët e sotme lansohen nga Bashkimi Evropian.

Metoda dhe Materialet

Literatura është studjuar në gjuhë të huaj angleze si dhe në gjuhën shqipe dhe të dhënat e nevojshme për përgaditjen e këtij punimi janë

siguruar nga literatura e cituar në bibliografi si dhe nga të dhënat e marrura përmes internetit.

Konglomerati global dhe diverziteti socio-linguistik

Në studimet e bëra socio-linguistike në aspektin kronologjik edhe në atë historik, konvergencat linguistike zënë një vend shumë të rëndësishëm në proceset e vazhdueshme të studimit të gjuhëve të huaja, ku vrehen dallimet, ngajshmëritë, ndikimet, përshtatjet etj. Ndryshimet, transformimet, prurjet paraqesin, një diverzitet gjuhësor.

Zona e njohur me emrin Sprachbund, sipas Sarah Thomson 458" në të vërtetë është zona apo regjioni gjeografik që paraqet tri ose më shumë gjuhë që shpërndajnë ose kanë në vetvete disa karakteristika më shumë si rezultat i kontaktit, se sa si rezultat aksidental ose si rezultat thjesht i trashëguar.

“Shembull është Zvicra me gjuhët e pranishme në territorin e saj si gjermanishten, frangjishten, italishten si dhe nëngjuhët tjera si flamanishten. Shembull tjetër tipik është Kosova me praninë shkullore të gjuhëve dhe kulturave të ndryshme si gjuhën shqipe, gjuhën serbe, turke dhe rome etj. pra, gjuhë të Ballkanit që kanë shkëmbyer mes veti, dhe kanë bashkëvepruar dhe në të njëjtën kohë kanë pasur një ndikim të vazhdueshëm tek njëra-tjera ndoshta edhe pa u vënë re”.

Megjithatë sa i përket lirisë së të folurit, shprehurit “Linguisti i njohur Noam Chomsky thekson në veprën e tij “Language and Freedom” ose «Gjuha dhe Lirija»; se “Gjuha, në tiparet e saja esenciale dhe në mënyrën e përdorimit të saj, jep kriterin themelor për të përcaktuar atë se një organizëm tjetër është një qenie me mendje njerëzore dhe me kapacitet njerëzor për mendim të lirë dhe për shprehje të vetvetes, si dhe me nevojë themelore njerëzore për liri nga kufizimet e jashtme të autoritetit represiv” (Chomsky, 1970: 145). Në të vërtetë nëse i analizojmë ndikimet e jashtme gjuhësore duhet të theksojmë se huazimet e ndërsjellta kanë ndodhur qysh në periudhat më të hershme historike, pra qysh nga periudha e pushtimit të hershëm Romak.

Sipas Çabejit “në pikëpamje kohore ndikimi intenziv romak ka zgjatur në gjuhën shqipe pa ndërprerje, për një periudhë kohore prej më se shtat shekujve, duke nisur vonë jo me vonë se me fillimin e luftrave Ilire duke vazhduar gjerë në mbarim të Perandorisë, edhe, gjerë në kohën kur latinishtja u zëvendësua me italishten dhe dialektet e saja”.

Ende sipas Çabejit ndikimi i turqishtes konsideron me të drejtë se “është jo më i gjërë në leksik dhe vihet re jo vetëm në formimin e fjalëve me sufikse, por është më i madh në fraziologji “duke e cituar edhe më tej Çabejin sa i përket sllavishtes dhe gjuhëve që hyjnë në këtë grup ai thekson, duke e cituar vet Çabeji Mayerin”.

Që kur Gustav Meyeri në punimin e tij më 1883 hodhi tej të menduarit e vjetër një lidhjeje afrie të veçantë e fort të ngushtë të gjuhës shqipe me greqishtën dhe me kostatimin e një afrimi më të ngushtë të shqipes me grupet e gjuhëve të Evropës veriore u hapi rrugën studimeve gjuhësore shqiptare shtigje të reja. Nje varg dietaresh ndërmorën trajtimin e përkimeve të shqipes me ato gjuhë, sidomos me ato Ballkanike dhe sllave”. Sa i përket turqishtes, mund të thuhet se statusi i saj juridik është degraduar në krahasim me statusin që e kishte në kohën kur Kosova ishte Krahinë Autonome në kuadër të ish-RSFJ-së. Në kushtetutën e atëhershme turqishtja, p.sh. përcaktohej si gjuhë zyrtare, bashkë me shqipen dhe serbishten (Kushtetuta e KSA të Kosovës, 1974). Por, në dokumentet kushtetuese të pas vitit 1999, turqishtja nuk e ka më statusin e plotë zyrtar, sikurse shqipja dhe serbishtja.⁵ për shkak të ndryshimit të rrethanave, historike dhe atyre politike e që megjithatë, gëzojnë të drejtën e plotë të përdorimit të gjuhës dhe simboleve duke u bazuar në të gjitha konventat ndërkombetare për përdorimin e gjuhës, lirisë së të shprehurit dhe të drejtat e njeriut.

Ndërkaq sa i përket termit ose nocionit konglomerat mund të themi se ai ndërthet në vete disa kuptime pothuajse të njëjta në shumë gjuhë të botës psh në gjuhën frënge është shumë e përafërt me fjalën frënge rassablement, d.m.th. grumbulloj, mbledh prap; dhe nën 2. –association d.m.th. shoqëroj, po të njëjtin kuptim e ka

edhe në atë të gjuhës angleze p.sh. conglomerate bashkime të ndryshme, të elementeve të ndër-lidhura mes veti etj.

Pra, bashkimi i elementeve të ndryshme gjuhësore përdorimi i terminologjise së huaj pastaj, përdorimi i kalkeve, formave, stuktura-ve të ndryshme gramatikore krijojnë shpeshherë polemika në mesin e gjuhëtarëve .

Megjithatë sipas Kalve-së në librin e tij: Lufta midis gjuhëve "Njerëzit gjithnjë kanë qenë të prirur të komunikojnë edhe pse shpeshherë ka qenë element dominat i mospajtimeve, luftrave të ndryshme lokale, rajonale dhe botërore".

Pra mund të themi se gjuha përbën konglomeratin e elementeve ose njësive frazologjike që lidhin ose ndajnë popuj të tërë qoftë në aspektin lingustik qoftë në atë socio- kulturor.

Duhet theksuar se me çështje socio –linguistike janë marrë shumë linguist të njohur si : Janet, L. Byron, Heiny Kloss, Joashua Fishmain etj., të cilët kanë pasur këndvështrime të ndryshme sa i përket çështjeve të origjinës, ndikimit prurjeve të shumta lingustike etj. Gjithashtu me çështje lingustike të tilla është marrur edhe gjuhëtari i njohur shqiptar Bahri Beci 2000, i cili në një mënyrë të vçant paraqet çështjet që kanë të bëjnë me këtë tematikë dhe që zbërthejnë kontradiktat në mes të tyre.

Konkluzion

Ndaj mund të themi se termi si i tillë mungon në kuptimin e mirëfilltë në shumë fjalorë socio-linguistikë në formën dhe mënyrën në të cilën ne do të përpiqemi ta shqyrtojmë e që natyrisht lidhet me multikulturalizmin, term shumë aktual në politikat kulturore dhe globale në shumë shtete bashkohore që kanë për qëllim ruajtjen, kultivimin e traditave, kulturave të ndryshme ose edhe mbijetesën e një gjuhe apo kulture në një territor të caktuar. Duke e konsideruar gjuhën si një bazament dhe shtyllë të një shoqërie atëherë do të kemi parasysh tolerancën e

kulturave nacionale dhe atyre gjuhësore që paraqesin një pluralizëm kulturor, që në fakt, nuk është aspak tendecioze ose e rrezikshme kur dallimet ndërkulturore dhe gjuhësore janë të mëdha dhe nuk kanë pikëprerje të theksuara me njëra tjetrën. Është shumë e rëndësishme të bëhen shkëmbimet kulturore përmes studimit të gjuhëve të huaja, traditës.

Me binjakëzimin e komunave, qyteteve, shkollave hapen prespektiva të reja, sidomos për gjeneratat e ardhshme.

Bibliografia

Çabej Ekrem Studime gjuhësore IV Nga historia e gjuhës,"Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes së gjuhëve ballkanike" ",Rilindja, redaksia e punimeve",Rilindja, , Prishtinë,1977 ,fq340

Çabej. Eqrem, Studime gjuhësore IV , Nga historia e gjuhës, " Iberoromanishtja dhe shqipja, izoglosat e tyre",Rilindja, redaksia e punimeve, Prishtinë,1977 ,fq .401.

Dictionaire HACHETTE encyclopédique Paris , fq.416

Munishi Skumbin" Barazia e gjuhëve në Kosove dhe prespektiva Evropiane" Uluksararasi Balkanlanda Tarih ve Kultur Kongresi, Bildirler Kitabı,Kongresi i parë Ndërkombëtar Ballkanik 10/16 Mays, 2009, Kosova ,Pristinë inrenet <http://www.linguasocio.blog.spat.com>

OBOD – Cetinje Beograd,2000fq.66The new standard dictionary English-Serbian Serbian - English

Chomsky, Noam (1970). Language and Freedom. The Chomsky reader, January 8-9, 1970,published in Abraxas, vol. 1, no. 1 (1970), in Tri Quarterly, nos. 23-24 (1972). Internet program P2P Emule 1970: 145

Thomson Sarah: Linguistic Areas and Language and History" .Gibers.Nerbonne, Schaeken,Languages in Contact (Amsterdam: Radopi,2000). Pg .311,327

